

THOMA KACORRI

854-31

K13.




Bijtë
shtrëngatës

R o m a n

824-51

K13

Thoma
Kacorri



Bijtë
e
shtrëngatës

roman

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

REDAKTOR
DHIMITËR XHUVANI

Piktor
IBRAHIM ÇEZMA

RECENSUES:
FATMIR GJATA
RAZI BRAHIMI

I

Qysh prej asaj dite, kur kishte ardhur dhe e kishte qortuar i ati, rruga e Sotirit ishte nga Liceu në dhomën e tij, dhe nga dhoma e tij në Lice. Kishte vendosur të mos vinte më as nga dyqani i Koci Bakos ku mblidheshin shokët dhe bisedonin, as nga Kristali, ku kthehej ngandonjëherë për të ngrënë ndonjë pastë të mirë. Studionte, shkruante detyrat, lexonte. Librat politikë dhe broshurat i kishte lënë mënjanë, bile ngandonjëherë, kur i dilte ndonjë rastësisht përpara, duke kërkuar gjësendi tjetër, e shtynte ose e mbyllte për të mos e parë.

Herë pas here mendja i hidhej në fshat Kujtonte Talinë dhe pastaj të gjitha ngjarjet i kalonin përpara syve. Shikonte Llambin, fytyrën e tij të qeshur e të dëlirë, Markon hijerëndë dhe më në fund prapë Talinë, në atë mëngjesin e kthimit të tij për në Korçë dhe përshëndetjen e saj te çezma e fshatit. Atëherë një buzëqeshje e ëmbël i çelte fytyrën.

Vaska, fqinji i tij i dhomës ku banonin me qira, e kishte kërkuar disa herë, sidomos mbrëmjeve, kur kthehej nga puna dhe e ftonte, por Sotiri gjithnjë gjente shkak për të mos vajtur.

Një mbrëmje Vaska nguli këmbë dhe i tha hapur:

— Sotir, më vjen shumë keq, që nuk ma hap zemrën.

— Nuk kam ndonjë gjë me rëndësi, Vaskë. Ti e pe babanë kur erdhi nga fshati.

— E pashë dhe m'u duk burrë i matur!
— e ndërpreu ai.

— E babai, para se të nisej, më tha të studioj dhe të mos e humb kohën me punë të tjera gjersa të mbaroj liceun.

— Shumë mirë të ka thënë, ti duhet të bësh punën që ke përpara, të studiosh. Por a mund t'i mbyllësh sytë përpara padrejtësive që na rrethojnë si ty në shkollë, si mua në punë, si babanë tënd në fshat?

— E di, e di, për këto kemi folur shumë herë!

— E po për të arritur atë që kemi folur duhet të bëjmë luftë të madhe, si në shpirtat tona, ashtu edhe kundër afendikonjve dhe bejlerëve tanë, që na pinë gjakun si shushunja.

Sotiri i dëgjonte fjalët e shokut të tij punëtor dhe i jepte të drejtë, por edhe babai i tij kishte hak. Ai robohej ditë dhe natë për ta mbajtur në shkollë.

— Mirë, mirë, — nuk e zgjati më Vaska, — bëj si të tha babai, po do të vijë dita që dhe ti të mendosh si unë.

Sotiri zuri t'i thoshte se ai edhe tani mendonte ashtu, por Vaska i tha natën e mirë dhe u tërhoq në dhomën e tij.

Të nesërmen në mëngjes, pas bisedës që kishte bërë me Vaskën, Sotiri u ngrit shpejt dhe, si gjithnjë, me çantën nën sqetull, u nis për në Lice. Vaskën nuk e pa, se ai nisej që më gjashtë në punë, por mendjen prapë e kishte te fjalët e shokut të tij më të madh. Dhe ecte me kokën ulur dhe i menduar.

— Sotir, o Sotir, dale pak, — i thirri Tatoja, — ke ditë që nuk ke ardhur andej nga ëmbëltorja e Kocit. Ne pandehëm se mos je i sëmurë. Bile sot do të vija të të kërkoja në shtëpi. — Pastaj e uli zërin dhe pëshpëriti: — Sonte do të mbidhemi përsëri atje për të parë së bashku një broshurë të re frëngjisht që ka dalë tani shpejt. Më thanë se ishte shumë interesante.

Po Sotiri e ndërpreu.

— Sonte kam shumë për të studiuar dhe nuk do të vij dot.

— E kush nuk ka për të studiuar, të gjithë jemi gjer në grykë me mësim. Sidomos ne të tregtares kemi kontabilitetin që na e shkurtoi jetën fare.

— Dhe ne sivjet jemi shumë të ngarkuar. Nuk do të vij dot. — përsëriti Sotiri si për t'u justifikuar.

Dhe u ndanë. Tatoja mori drejt bulevardit, për nga shkolla tregtare, kurse Sotiri një kthesë përjetë për nga Liceu.

Sotirin në Lice edhe më parë e shikonin me sy të mirë, por tani që u ishte vënë vetëm e vetëm studimeve, të gjithë profesorët e tregonin me gisht si shembull për të tjerët. Dhe Sotirit i vinte mirë që po ua kalonte bashkënxënësve që ishin të parët në klasë dhe merrnin mësim private, si në matematikë ashtu edhe në frëngjisht e në lëndë të tjera. Bile edhe profesori i vizatimit, që i kishte vënë në trimestrin e dytë një pesë, sa për të kaluar; kur e pa se sa i kujdesshëm tregohej tani në vizatim, e përgëzoi një ditë:

— Sotir, megjithëqë vazoja nuk është fare e mbaruar, ja kjo gryka këtu, nuk e ka atë finesën e duhur dhe formën nuk e ka shumë elegante, prapëseprapë ti meriton një notë më të mirë për zellin që tregon për këtë lëndë.

— Zoti profesor, — ia ktheu Sotiri, — po mundohem ta bëj grykën ashtu si na keni thënë, por ja që s'arrij dot.

Profesori ndjeu një keqardhje nga këto fjalë për nxënësin e tij, e mori në dorë fletën e vizatimit, e pa me vërejtje dhe pastaj me lapsin e tij të trashë ia ndreqi grykën duke i hequr dy tri — vija poshtë e përpjetë.

Sotiri mbeti i habitur nga mjeshtëria e profesorit.

Atë muaj emri i Sotir Demirit figuronte në tabelën e nderit, midis emrave të nxënësve më të dalluar në Lice.

Atëherë ai u bëri një letër prindërve në fshat!

«Të dashur tete dhe baba!

Ju puth dorën e djathtë me nderim. Jam mirë me shëndet dhe mos u bëni merak fare për mua.

Dje doli tabela e nderit për këtë muaj dhe mbeta shumë i gëzuar kur pashë atje emrin tim. Jua shkruaj këto fjalë që të gëzoheni edhe ju. Edhe notën e vizatimit e kam ndrequr ashtu si të kisha premtuar.

I dashur baba, këshillat e tua të fundit i kam gjithnjë parasysh dhe jam i lumtur që kam një baba të tillë.

Teten e falënderoj gjithashtu edhe për lakrorin që më kishte dërguar javën e fundit. Ishte aq i shijshëm, sa ia hëngra ko-

kën menjëherë. Po të ketë murdësi dhe nuk i vjen rëndë, nuk do t'ia refuzoj po të më dërgojë përsëri edhe një lakror si ai.

Ju përqafoj edhe një herë, biri juaj me bindje,

Sotiri»

E mbylli letrën dhe bëri për nga hani i Sherafit, se ishte e premtë, dita e pazarit e mund të gjente ndonjë fshatar e t'ia dërgonte të atit në fshat.

II

Sotiri u kthye në fund të vitit në shtëpi si fitimtar i ndonjë beteje të madhe. Kishte mbaruar klasën me nota të shkëlqyera dhe priste vitin e fundit ta mbaronte edhe më mirë me shpresë që të fitonte bursë për të vazhduar ndonjë shkollë jashtë shtetit.

E ëma e priti si gjithnjë krahëhapur, e përqafoi, e puthi në të dy faqet, pastaj, duke e shikuar në sy, shtoi:

— Sa më je prishur, të keqen tetja. Po

tani që më erdhi në shtëpi e di vetë se ç'duhet të bëj! Vetëm lakrorë me vezë do të të gatuaj.

Sotiri buzëqeshi.

E ëma e kuptoi buzëqeshjen e të birit dhe vazhdoi:

— Vërtetë që nëpër akçihanet e Korçës ka shumë gjëra të mira, por ne aq dimë, aq bëjmë.

— Për mua, tete, s'ka gjellë më të mira se ato që gatuan ti; — ia këtheu Sotiri.

Atëherë në fytyrën e Zikes shkëlqeu një buzëqeshje, sa e dëlirë, aq edhe e kënaqur.

I ati si gjithnjë që i përmbajtur. Priti sa mbaruan fjalën nënë e bir, pastaj e pyeti:

— Po si e mbarove klasën, mor bir?

— E kalova me nota të shkëlqyera, baba. Ja, shiko dëftesën, — dhe nga çanta që mbante në dorë, nxori një copë kartë të mbështjellë me kujdes në një libër dhe ia dha të atit.

Xeli e mori në dorë, e shpalosi me një lloj krenarie dhe u hodhi një sy notave. Që të gjitha qenë nga nëntë e lart. Por në fund kishte edhe disa shënime në frëngjisht, të cilat ai nuk i kuptonte.

— Po këtu ç'shkruan, mor bir? — pyeti Sotirin.

— Këtu shkruan që nxënësi Sotir Demiri ka treguar zell të madh gjatë vitit në studime, si dhe sjellje shembullore dhe për këtë shkak është vënë dy herë në tabelën e nderit.

Xeli u mallëngjye nga këto fjalë, sytë iu njomën dhe tha me zë të tronditur:

— Ja, kështu të dua, djalë i babait.

Xeli dorste t'i thoshte edhe që, ja, shiko tani që s'merresh me gjëra të tjera se si i ke të gjitha notat të shkëlqyera, por s'deshi t'ia prishte qejfin të birit.

Pasdreke erdhën ta shikonin Sotirin si gjithnjë edhe shokët e tij të fshatit, Minai i Cingos, Vangjeli i Nastës dhe Ndreçi i Pëpos. Ata qenë të gëzuar që shoku i tyre qe kthyer më në fund në fshat dhe jo vetëm për pesëmbëdhjetë ditë, siç kthehej në pushimet e dimrit por disa muaj me radhë. Kushedi se sa libra të rinj dhe broshura do t'u kishte sjellë. Dhe si folën një copë herë për qytetin dhe për fshatin, për lajmet që ishin më interesante për ta, për skuadrën e futbollit, që posa kishin formuar, për djemtë që kishin vajtur çirakë balte në Delvinë dhe për ata që kishin shkuar ushtarë, përsëri ra fjala për librat dhe për broshurat që u sillte gjithnjë kur kthehej nga Korça.

Por këtë radhë ai u përgjigj ftohtë:

— Sivjet kam sjellë vetëm librat e mi. Dhe ata frëngjisht. Këtë vit e kam të fundit dhe duhet të përgatitem.

Dhe shokët e tij dolën nga shtëpia e Demirëve jo si tjetër herë të qeshur e të kënaqur, por kokulur e të brengosur.

Kur doli Sotiri nga ahuri dhe qëndroi përpara dyqanit të Markos, u prit me buzën në gaz.

— Mirë se erdhe, Sotir. Dëgjuam se sivjet ke dalë i shkëlqyer me studimet, bravo!

— Sivjet, vërtet që i kam notat më të mira se kurdoherë tjetër. Faleminderit!

— Përpiqu kështu edhe vitin që vjen, se atyre që dalin të parët u japin bursa edhe për jashtë shtetit. Dhe po të të dalë bursë, të vesh në Athinë. Të bëhesh doktor. E di sa doktorë të mirë që ka në Athinë! Për këtë më pyet mua që kam vajtur. Dhe para marrin shumë, por i kanë hak. Të shpëtojnë jetën. Ja, mua më çau një doktor atje nga stomaku dhe tani, shqyrr, pesë vjet dhe asnjë dhembkë nuk ndiej.

— Po të më dalë bursa, — e ndërpreu Sotiri, — do të kërkoj të vete në Paris.

Markoja po e shikonte djalë e Xelit në sy. Dhe sesi iu duk tani më i rritur, më i pjekur. Edhe fjalët i dukeshin më të urta. Dhe kishte të drejtë. Mustaqet Sotirit posa i kishin dërsirë. Edhe flokët i kishte krehur prapa dhe i kishte ndarë për anës. Dhe padashur i shkoi ndër mend e bija. Sikur të kishte fat e të martohej me të birin e Xelit. Edhe sikur të mos i dilte bursë, ai do t'i jepte para dhe do ta nxirrte doktor.

Pas pak Markoja u përmend nga ëndërrimet e tij dhe tha:

— Të të dalë, pa shko ku të duash, tani ti je i mençur vetë dhe di më shumë se ne.

Të gjithë fshatarët që po e dëgjonin me vëmendje bisedën e tyre ndienin, edhe ata

një lloj krenarie. Më në fund edhe nga fshati i tyre do të dilte një djalë i mësuar.

Nga fjalët e ëmbla të Markos dhe nga shikimet e fshatarëve Sotiri e ndjeu veten të kënaqur. Për herë të parë ai ndjeu një lloj krenarie përpara fshatarëve të tij.

Ishte nga mesi i qershorit. Të lashtat akoma gjelbëronin. Bari kishte mbuluar fusha dhe male. Që nga pllajat e Gramozit dhe gjer në rripat e Radomit dhe të Malit të Zi vendi jeshilonte. Poshtë Thikësi ziente nga puna. Kush kosiste livadhet, kush vadiste misrat, kush mbante apo kthente barin e kositur. Tërë vendi kundërmonte me erën e trëndelinës, të mendrës apo të shtogut. Kjo erë e ëmbël sikur i dehte e i ngazëllonte të gjitha qeniet. Zogjtë cicëronin nëpër degët e pemëve, anës gardheve dhe krojeve. Kecërit dhe shqerrat kërcenin nëpër kodrat e Shëngjergjit si mëza të harlisur. Të gjitha kafshët ishin të kënaqura nga bollëku i natyrës dhe qimja u ndriste si qelibar. Qielli, edhe ai, sikur i gëzohej poshtë Tokës me atë kaltërsinë e tij pa fund që e mbulonte vazhdimisht, si ditën, ashtu edhe natën.

Edhe Xeli me Sotirin i qenë përveshur punës si gjithë fshatarët e tjerë. Sot ata po kositnin Luadhet e Gjetë dhe kishin ardhur aty qëmenatë që të mos i zinte vapa. Një djersë e hollë u kishte mbuluar fytyrat dhe

herë pas here ata qëndronin dhe fshihe-
shin me shamitë që kishin hedhur në qafë.
Me këmishë, me llërët përveshur, shquhe-
shin që larg në atë copën e kositur, e cila
dukej si ndonjë ishull i vogël, që kishin
akoma më këmbë rreth e rrotull tyre.

Kur arritën në fund të postatit, Xeli
qëndroi, ngriti kryet dhe iu lut të birit:

— Nëm një çikë ujë, Sotir!

Djali rendi për nga shelgu që kishin pra-
në, mori bucelën që kishin lënë nën hije,
por ajo qe e zbrazur.

— Baba, — i thirri ai që andej, — bucela
nuk ka ujë. Ja, tani do të vete ta mbush
sipër te burimi.

— Mirë, shko, se na u tha goja! — për-
sëriti Xeli.

Sotiri hodhi bucelën në krahë dhe bëri
përpjetë. Humbi në një shteg përmes hitrave,
anës vijës së ujit, që rridhte me një gurgu-
llimë të pandërprerë.

Edhe Xeli e la punën dhe vajti nën hije
të kaliste kosat. Pas pak u dëgjua një xën-
-xën-xën, e cila përzihej me këngën e cin-
xërrave dhe tërë luginat sikur këndonte.

Sotiri me të arritur te burimi, vuri buzët
te lyfyti i drunjtë nga xhurronte ujët e fto-
htë e të kulluar si argjend, pastaj hodhi sy-
të rreth e qark dhe e la shikimin t'i flutu-
ronte nga një vend në një vend tjetër. Pa
poshtë: Malet e Zez që nxinin kundrejt tij.
Radomin bile edhe Nemërçkën tutje Ersekës.

lumenjtë që shkisin si të argjendtë dhe rrinte i gozhduar në vend si në ndonjë ëndërr nanuritëse. E kishte harruar tanimë bucelën që ishte mbushur dhe po çurronte me një këngë monotore, por të këndshme.

Çape të lehta që po afroheshin për nga burimi e shtynë djalin të kthente kryet. Dhe ç'të shihte. Për të mbushur ujë po vinte Talia me një ibrik të bardhë në dorë.

Sotiri kërcëu nga vendi.

Të dy të rinjtë u shikuan sy ndër sy dhe s'dinin ç'të bënin.

Talia e para përshëndeti.

— Mirëdita, Sotir. Ç'bën aty?

— Po mbush bucelën. Sot po kositim me babanë Luadhet e Gjetë! — u përgjigj i tronditur ai.

— Ne po kositim sipër në Luadhet e Turqve dhe të pashë që andej, — tha Talia. — Argatët kërkuan ujë dhe unë u derdha gjer këtu.

Sotiri atëherë u përmerd dhe hoqi bucelën e tij.

— Vër ibrikun, — i tha ai.

Por për të luajtur nuk luajti nga vendi!

Prisnin si të shastisur karshi njëri-tjetrit, aq sa nuk dëgjonin as zhurmën e burimit, as cicërimën e zogjve.

Atëherë Sotiri e zuri për dore, e tërhoqi nga vetja e tij dhe të dy të rinjtë aq afër njëri-tjetrit u puthën. Dhe u harruan kështu për një hop. Pastaj e para u përmerd Talia

dhe si fajtoe u shkëput nga krahët e Sotirit. Rrëmbeu ibrikun që mbushur dhe bëri përtpjetë.

Sotiri e kapi prapë për dore!

— Dale dhe pak!

— Mōs, Sotir. Do të na shohin! — dhe u largua me çap të shpejtë nga Luadhet e Turqve.

Sotiri mbeti më këmbë vetëm si i trullorur. Ëndërr apo zhgëndërr që gjithë ç'i ndodhi? Jo, që të gjitha ishin të vërteta. Ajo që vetë Talia e Markos. Menjëherë i erdhi diçka ndër mend «Si s'u kujtova t'i thosha të takohemi prapë? Si m'u tha goja dhe s'nxora dot dy fjalë për të qenë? Sa budalla që qenkam» — tha me vete duke tundur kryet, rrëmbeu bucelën dhe u nis. Koka i buçiste sikur ishte i pirë, tërë trupin e ndiente si të tendosur dhe një e nxehtë i kishte zaptuar tërë qenien. Rrugën nuk e pa se si e bëri.

Kur e pa i ati në krye të luadhit, i tha:

— Ç'u bëre? Shumë u vonove, more djalë.

Atëherë Sotiri e mori vetën dhe u përgjigj:

— Kishte dhe njerëz të tjerë, baba, dhe prita radhën.

— Nëma këtu, se m'u dogj shpirti për një çikë ujë të ftohtë. Dhe hajde ta mbarojmë dhe këtë postat, pa në zënë vapa!

Dhe Xeli e ngriti bucelën përtpjetë dhe uji, këndoi një copë herë nëpër gurmazin e tij.

III

Jeta e qetë e fshatit, kujdesi i tepruar i nënës dhe më në fund ajo puthje te burimi, e bënë Sotirin si të dehur. Kudo që vinte dhe kudo që ishte mendonte vetëm e vetëm për Talinë. Sikur u shkëput nga bota që e rrethonte dhe rronte me ëndërrimet e tij. Vajza më e bukur e fshatit, qe e dashura e tij. Nesër ajo do të bëhej gruaja dhe nëna e fëmijëve të tij. Bënte ç'bënte dhe dilte nga shtëpia e Broqeve. Ngandonjëherë rastiste edhe ta takonte. Ajo atëherë e përshëndeste duke i hedhur një shikim të druajtur, që të mos e kuptonin të tjerët. Por për Sotirin edhe kaq qe mjaft se e dinte tarimë që edhe ajo e

52251

donte, siç e donte edhe ai vetë. Dhe nuk kishte më nevojë as për letra, as për shpjegime të tjera.

Kështu i kalonin ditët. Sa ishte në punë, mendonte për të. Pastaj, me t'u kthyer në fshat, u jepte ujë kafshëve në çezmë, ose dilte nga dyqani i Markos. Por edhe atëherë me një qëllim të vetëm, të takonte apo të shikonte një çikë Talinë. Sotiri rronte në një botë të tijën dhe sikur që veçuar nga hallet e shtëpisë dhe të fshatarëve.

Po një të shtunë mbrëma roja e fshatit, Pandoja, doli derë më derë dhe i lajmëroi fshatarët se në Thikës kishte ardhur taksidari. Ky lajm hyri shtëpi më shtëpi si hija e vdekjes dhe e ndërpreu gazin e jetës që i kishte zaptuar fshatarët nga vrulli i punës.

Me të dëgjuar lajmin e ardhjes së taksidarit, Xeli u ngrit nga shtrati ku që shtrirë për t'u çlodhur. Vuri shapkën në kokë dhe i menduar doli nga shtëpia.

Zikja e kuptoi shqetësimin e burrit dhe zuri të mallkonte në ashef taksidarin. As ajo, as Sotiri nuk e ndien kur hyri Llambi, i cili i dha një copë letër që ia dërgonte Talia.

Sotiri e hapi me nxitim dhe e lexoi menjëherë.

«Sonte ndër ne është rrëmujë. Kemi taksidarin dhe xhandarët. Po të duash dil nga plevicat të takohemi. Asnjëri nuk do të na vërë re!»

Sotiri e puthi vogëlushin në faqe, u vesh, rrëmbeu kofinin dhe, para se të dilte jashtë, i thirri së ëmës.

— Tete, do të hidhem gjer nga plevica t'u marr ca bar hajvanëve!

— Mirë, mirë, — u dëgjua zëri i Zikes që nga ashefi.

Ishte një natë me hënë. Yjet ishin ulur aq poshtë, sa Sotirit i dukej se, po të ngrinte përpjetë dorën, mund edhe t'i kapte. Frynte një fllad i lehtë, siç fryn zakonisht në mbrëmje pas perëndimit të diellit. Fshati ziente akoma nga zërat dhe nga të thirrurat. Kush rregullonte hajvanët, kush mbledhte bagëtinë. Aty-këtu filluan të ndritnin edhe dritaret e shtëpive.

Sotiri arriti shpejt te plevica e tyre dhe e mbushi kofinin me bar të njomë, që e kishin nderë të thahej nëpër lëmë. Një aromë e ëmbël i ra në hundë. Nga pahu i barit dhe nga era e tij teshtiu dy-tri herë. Pastaj ngriti sytë dhe i hodhi për nga plevica e Broqeve. Por andej nuk dukej asgjë. U tulat prapa gardhit që ndante lëmin e tyre nga ai i Markos dhe mbeti për një hop pa marrë as frymë. Iu duk sikur kishte orë të tëra që po priste. Sekondat, minutat, bile edhe orët tani i duke-shin sikur rrinin në një vend.

Në rrugë u duk një hije, pastaj dhe një tjetër, po më e vogël.

— Do të ketë marrë me vete edhe qenin.

Ndofta ka frikë të vijë vetëm në errësirë, —
pëshpëriti ai.

Por hijet, sa më shumë afroheshin, shtoheshin dhe bëheshin më të qarta dhe ai njohu Talinë dhe pas saj të motrën e vogël, Mitron.

Sotiri u zemërua dhe doli nga pusia që kishte zënë.

— Mirëmbërmani! — i përshëndeti.

— Uh, sa na trembe! — thirri Mitroja.

Po Talia u përgjigj:

— Mirëmbërma, Sotir!

Ecnin afër njëri-tjetrit. Përshëndetja e saj Sotirit i tingëlloi në vesh sikur i kërkone falje për mosardhjen vetëm në plevicë.

— Hajde, më shpejt, tate, se babai kështu na tha, të nxitojmë e të kthehemi menjëherë!

Talia donte s'donte i shpejtoi çapet.

Edhe kur u ndanë, Sotiri me Talinë s'këmbyen dot fjalë. Vetëm u përshëndetën prapë me një «Natën e mirë!» midis tyre si njerëz të zakonshëm.

Me t'u kthyer në shtëpi, Sotiri e la kofinin me bar në qilar dhe u derdh për nga dyqani i Markos. Nuk hyri brenda. Nga dritarja e hapur pa të atin që po fliste me Markon. Dhe zërat dëgjoheshin fare mirë.

— Do të më japësh dyzet franga borxh, Marko, të paguaj nesër xhelepin dhe vergjinë, pa t'i kthej pastaj o grurë, o para, si të mbledhim të lashtat.

Markoja nuk iu përgjigj menjëherë.

— Ç'mendohesh? — shotoi Xeli.

— Ti nuk je i vetmi që më ke kërkuar para sot. Dhe unë nuk jam bankë.

— Ore, ti vërtet, nuk je bankë, por edhe xhaba nuk ua jep paratë njerëzve. Për një dy e më tepër u merr! — e ndërpreu Xeli.

— Kur është ashtu, mos kërkon, ore. Njeriu hem ju bën të mirën, hem s'ia njihi. Dhe kjo nuk është e drejtë, ama.

— Do të më japësh, apo jo?

— Do të të jap, se ty të kam jo vetëm myshteri, por edhe mik të vjetër.

— Dhe çfarë i do kur të t'i kthej, grurë apo lekë? — e ndërpreu ai.

— Grurë.

— Dhe sa do ta zësh?

— Si të gjithëve, një gjysmë leku.

— Si, ore, një gjysmë leku! Në pazar gruri shkon një lek e më tepër.

— Shkon tani, po kur vjen lëmi edhe kaq nuk shkon!

Xeli u mendua dhe iu përgjigj Markos:

— Mirë. Nëm paratë!

Markoja hapi sitrtarin dhe i dha tetë dollarë.

Sotirit i pikoi në zemër. I ati po përulej përpara dyqanxhiut të fshatit si ndonjë lypës. Nuk duroi dot dhe u kthye në shtëpi shumë i mërzhitur/.

Të nesërmen në mëngjes tërë burrat e fshatit u mbloodhën përpara dyqanit të Mar-

kos. Ishte shpejt dhe u ulën nëpër muret e prishura rreth e rrotull dyqanit. Vinin ngadalë dhe të menduar. Thoshin nga një «Mirëmëngjesi, burra!» dhe rrinin pranë atyre që u hahej muhabeti apo sipas farefisit.

Erdhën Kacorrët, me në krye plakun e tyre, xha Noxin, Robot, Kocaqet me Xhekon përpara, tërë fshati.

Në sofatet përpara dyqanit kishin nderjur xhandarët me dyfeqet ndër duar. Ata ishin të kuq e të bardhë, me fytyra të çelura. Flisnin e qeshnin midis tyre.

Xeli nuk ishte vetëm. Me të kishte ardhur dhe Sotiri e kishin zënë vend pranë Kacorrëve.

Xha Noxi i tha djalit:

— E shikoni, mor bir, ja këto të ka fukarallëku, të mbledhin si bagëtinë në shtrungë për të të mjelë.

— Do të na mjelin, do të na mjelin, pastaj të tëra do t'i vjellin! — ia ktheu Sotiri.

— Këshu ka qenë dhe kështu do të jetë! — shtoi plaku.

Dhe nuk vazhdoi dot më tutje, se nga shtëpia e Broqeve doli taksidari me një bërrucë të zezë hedhur supeve. Nga një anë e ndiqte Ligor Broqja si kryeplak dhe nga ana tjetër kapteri.

Fehmi beu, se kështu e quanin taksidarin, e hodhi bërrucën përmbi karrige, gogësiu një herë, se posa ishin ngritur nga

mëngjesi dhe pastaj hapi defterin përpara tij.

— Po vijnë nga Bezhani, — tha ai. — E kemi zënë me radhë tërë rrethin dhe gjysmat e fshatrave i mbaruam. Bezhanllinjtë dolën njerëz me erz, që të gjithë i paguan taksat, pa e sjellë punën vërdallë. E di që në Thikës nuk kemi gjetur kurrë pengesa por jua them këtë fjalë që ta dini, se tek unë s'ka kam, s'kam. Paguani atë që ju përket dhe njeri as me borzilok, si i thonë, nuk do t'ju prekë.

Kjo hyrje e mërzitshme dhe fyese i inatosi edhe më tepër fshatarët. U dukej se me këto fjalë taksidari donte t'i trembte dhe t'i poshtëronte.

— Hë, kush do të vijë i pari të paguajë, apo t'ju thërres një nga një me emër! — vazhdoi ai.

Ligor Broqja, që i rrinte më të djathtë, u ul për nga ai dhe i pëshpëriti në vesh.

— Më mirë kush i ka gati paratë të vijë t'i paguajë menjëherë.

Dhe taksidari me zë thirri:

— Ata që i kanë paratë gati le të vijnë për të paguar.

Xhandarët u ngritën më këmbë dhe u radhitën prapa taksidarit.

Marko Broqja rendi atëherë i pari që nga dyqani dhe iu lut Fehmi beut.

— Le të paguaj unë sefte se s'kam vakt.

Të mos e mbyll dyqanin se vjen donjë myshteri dhe s'më gjen!

Taksidari iu përgjigj me një buzëqeshje:

— Ore, ti kurdoherë i paguan. E dimë ne këtë. Por hajde mos të ta prishim qejfir.

Dhe e hapi defterin në faqen e Broqeve.

— Ju, Broqet, keni për të paguar për vergjinë, për xhelepin dhe për udhën, gjithsej njëzet franga.

— Shumë, more. Vjet gjithsej — gjithsej na mbliðheshin rja shtatëmbëdhjetë franga e gjysmë! — ia ktheu Markoja.

— Nuk janë shumë. Jeta u shtrenjtua. Mall s'ka bollëk si më parë, prandaj dhe taksat do të ngrihen, një me pazarin! — tha rëndë-rëndë Fehmi beu.

Këto fjalë i tronditën fshatarët. Domethënë taksat ishin ngritur. Ata që i kishin bërë gati paratë ranë në mendime.

Markoja i pagoi të njëzet frangat, mori dëftesat dhe u tërhoq në dyqan.

Pastaj një nga një filluan të paguanin dhe fshatarët e tjerë.

Kur u gjend Nox Kacorri përpara taksidarit, ai ngriti kryet dhe i tha:

— O, ti xha Noxi je!

Dhe e hapi defterin në faqen e tij.

— Gjashtëmbëdhjetë franga!

— Si, more, gjashtëmbëdhjetë franga! Dymbëdhjetë e kisha vjet. Ju s'keni shtuar as shumë, as pak, por një napolon flori të tërë.

— Paguaji, xha Noxi, ti kurrë s'ke bërë fjalë.

— Vërtet që s'kam bërë fjalë, por mos e mbushni kupën kështu, dinga, se derdhet. Ja, mirë unë e kam atë napolon, se tani shpejt më dërgoi djali para nga Amerika, po ata që s'kanë se ku t'i gjejnë?

— Mos u bëj merak për të tjerët, secili e ka bërë atë hesap! — tha me inat taksidari.

Dhe xha Noxi i dha të gjashtëmbëdhjetë frangat, si nxori nga qesja edhe pesë franga të tjera, të cilat nuk i kishte bërë gati.

Kur i erdhi radha Xel Demirit, Sotirit i ranë një palë djersë të ftohta në fytyrë. I ati kishte marrë borxh nga Markoja vetëm tetë franga. Tani kishin për t'u turpëruar.

Por edhe Xeli e kishte bërë këtë hesap. Megjithëqë i kundërshtoi taksidarit dhe i tha që ky ishte një veprim kundër ligjit, e pa të udhës që të paguante.

Sotiri sikur u shkarkua nga ndonjë barrë e rëndë.

Kështu kaluan edhe disa fshatarë të tjerë, me fjalë e me kundërshtime.

Kur i erdhi radhe Dhosi Maros, ai tha prerë:

— Pesë frangat i kam bërë gati, por ato dy që më thua përmbi to, zoti Fehmi, s'kam se ku t'i gjej.

Taksidari e shikoi me zemërim, por nuk foli. Kapteri i tha si me të qeshur.

— Zgjidhe qesen, Dhosi, dhe paguaji, siç i paguan gjithë të tjerët.

— Ore, ti ke perëndi, apo s'ke. S'kam të tjera po ju them!

— Po sikur të thonë të gjithë kështu, si thua ti, Dhosi, ne atëherë asnjë pesësh nuk mund të mbledhim. Të gjithë do të thonë, s'kemi, Fehmi bej, dhe ne do të shkojmë me torbat zbratur. Po shteti s'mbahet më këmbë pa para. Shtetit i duhen para. Paguaji dhe mos na detyro të sillemi keq.

— Po të doni pesë frangat, merrini, më tepër s'kemi, — përsëriti i vendosur Dhosi.

Kapteri shikoi për nga xhandarët, por Fehmi beu e zuri me dorë që të mos jepte ndonjë urdhër të nxituar dhe, duke u kthyer, shtoi:

— Shiko, Dhosi, shko i bëj dhe të dy frangat gati dhe eja i paguaj më vonë!

— Ore, ju me të vërtetë s'paskeni perëndi. Unë edhe këto s'i kam të miat, borxh i kam marrë dhe fëmijët i kam pa bukë. Kemi një javë që na është mbaruar mielli dhe me hua po rrojmë. Dhe kur ju them s'kam se ku të marr, s'kam. Asgjë tjetër s'më mbetet përveçse të vete e të mbytem në lumë.

Kapteri u inatos shumë nga fjalët e tij të fundit dhe thirri:

— Lidheni, qerratanë, ta shpiem në Ersekë, pastaj do të bëjë derman ai!

Xhandarët këtë sikur prisnin, morën prangat nga një hejbe atje pranë dhe ia hodhën ndër duar.

Dhosi as fliste më, as kundërshtonte. Po

rrinte më këmbë si ndonjë lis, që nuk e lozin dot as erërat, as shtrëngatat.

Fshatarët zunë të bisedonin të zemëruar. Xhel Demiri u shkëput nga radha dhe u tha.

— Ore, ç'bëni kështu, mos e turpëroni tjetrin në mes të burrave, se, po i more njëriut nderin, ç'i mbetet atëherë?!

Kapteri u ngrit nga verdi i inatosur nga këto fjalë dhe iu kanos.

— E dimë ne se nga vijnë këto kundërshtime, e dimë:

Po atëherë Ligor Broqja seç i tha mënjane kapterit dhe ai nuk vazhdoi më tutje.

Sotiri që ishte pranë të atit, tani e ndjeu veten krenar, dhe mendoi se, po të ngriheshin që të gjithë kështu, nuk do të mundnin xhandarët t'i hidhnin prangat ndërduar dhe ta mbyllnin atë natë në bodrum.

IV

Të nesërmen në mëngjes Dhosit e dërguan me një xhandar në Ersekë.

Nusja e Dhosit, qysh atë ditë, doli nëpër fshat për të mbledhur paratë. Kush i dha një lek, kush dy. Për një rast të tillë asnjë nuk u kursye.

Edhe Xel Demiri u tregua i gatshëm e i dha sa i kërkoi.

— Falemnderit, falemnderit shumë, zoti Xeli!

— Ç'janë këto llafe, kjo është detyra jonë, kush do të na ndihmojë ne, po s'i rrdihmuam

njëri-tjetrit. Po shko sa më parë në Ersekë, paguaj, që ta lëshojnë Dhosin, se jeni në zjarrin e punës dhe drithi s'pret! — e ndërpreu ai.

— Ashtu është, zoti Xeli, arën e Rotit e kemi lënë përgjysmë. Po shyqyr që ka në botë dhe njerëz të mirë! — e falënderoi përsëri ajo dhe doli.

Të nesërmen mbrëma Dhosi u kthye në fshat. Dhe hija e taksidarit në Thikës sikur u harrua.

Kishin filluar të korrat dhe fshatarët që nga mëngjesi herët dhe gjer vonë natën, ishin nëpër ara. Ca korrnin, ca mbledhnin duajt, ca bënin gati me bajga lëmenjtë. Që të gjithë nxitonin aq sa fshati të dukej si ndonjë fole milingonash të cilat kryejnë punën e tyre me ngulm, duke luftuar orë e çast me pengesat që u dalin përpara.

Edhe Xeli me Sotirin i qenë përveshur punës si të gjithë fshatarët e tjerë. Ngriheshin menatë nga rrobat, rrëmbenin drapërinjtë dhe rendnin të korrnin gjëkund. Zikja rrinte në shtëpi, bënte ç'bënte dhe pastaj sulej dhe ajo nga arat me torbën me bukë në krahë. Dhe si hanin drekë me uri të madhe arës ndonjë burimi, pushonin pak gjëkund nën hije, pastaj ngriheshin dhe vazhdonin përsëri të korrnin derisa perëndonte dielli.

Por edhe si errej për të nuk kishte prehje. Xeli fillonte të lidhte duajt. Zikja kthehej në shtëpi për të qeverisur, kurse Sotiri vente të

kulloste kalin e të korrte ndonjë vandak bar për qetë. Një orë e lirë nuk i mbetej për të lexuar, apo për të dalë nga dyqani i Markos, apo për të kërkuar Talinë.

Kur piqeshin rastësisht ngardonjëherë, kur ktheheshin nga arat apo në çezmë, ata përshëndeteshin si njerëz të zakonshëm, megjithëqë e shikonin njëri-tjetrin me ashk.

Prapëseprapë dashuria e tyre në fshat nuk mbeti e fshehtë. Djemtë flisnin hapur midis tyre, kurse vajzat, kur i shikonin të përshëndetnin njëri-tjetrin, hidhnin romuze e buzëqeshnin nën buzë.

Këto fjalë i vajtën në vesh edhe Markovicës. I dëgjoi vjedhurazi përpara sofatit të portës kur mbledheshin gratë mbrëmave dhe bënë muhabet. U trondit shumë, por nuk besoi. Markovica e hiqte veten të rëndë dhe nuk donte të bënte krushqi me Demirët, se nuk qenë kushedi se çfarë, ndonëse kishin dërguar djalin në shkollë të madhe.

Në mbrëmje ajo e hoqi të bijën mënjanë e inatosur:

— Po ti, moj, ç'janë ato fjalë që fliten poshtë e lart për ty në fshat?!

Talia rrinte kokulur.

— Unë të flas, nëna që të ka bërë kokën, ç'janë ato fjalë, ja më thuaj!

Talia pëshpëriti:

— Kush mund t'ua zërë gojën fshatit, le të flasin ç'të duan!

— Si, moj, le të flasin ç'të duan. Ti mos

je ndonjë çupë e mbetur? Ti je bija e Marko Broqes, që e mban në gojë jovetëm Thikësi, por tërë rrethi, dhe ca më tutje.

— E di, tete, — ia ktheu e qetë çupa.

— Atëherë, kur e di, thuamë a janë të vërteta, apo jo?

— Po unë të thashë, tete, që fshatit s'ia zë dot gojën, sot flasin për një, nesër për tjetër. Ata atë punë kanë të eglendisen me llafe.

— Nuk më zë qederi se ç'flasin bota për të tjerët, por s'i dëgjoj dot fjalët për ty. Po mori vesh yt atë, moj e zezë, do të të presë kokën si të ndonjë zogu!

Këto fjalët e fundit e trembën Talinë dhe, për ta qetësuar të ëmën, iu përgjigj:

— Akoma s'më ka ardhur vakti për t'u martuar mua, tete. Po të kishte gjësendi, unë vetë do t'jua thosha.

— Hë, ashtu, çupë e tetes. Po të kesh gjësendi ti, t'i thuash tetes sate! — dhe i përkëdheli gërshetat.

Markovica, e cila kishte ndër mend t'i thoshte edhe Markos, u qetësua nga përgjigjja e së bijës dhe nuk i përmendi asgjë të shoqit.

Por që të gjitha këto dolën në shesh fare papandehur nga vetë Sotiri dhe Talia.

Më njëzet e tetë të gushtit Thikësi kremtonte ditën e shën Marisë. Fshatarët i kishin kryer punët e rënda. Ata pak grurë dhe thekër i kishin mbledhur. Misrat i kishin vjelë. U mbeteshin vetëm drutë të sillnin nga mali.

Por për to kishte kohë dhe mund të pushonin e të dëfrenin dy-tri ditë.

Në këtë ditë të shenuar thikësit kudo që të ishin mblihdeshin në fshat. Dhe ja vetëm ata, por ftonin dhe miq nga fshatrat e tjera, nga Erseka e Korça. Në këtë ditë pllakosnin në fshat dhe pramatarë të ndryshëm, të cilët sillnin xhingla për vajza dhe për nuse, lodra për fëmijë, hallvaxhinj me lloj-lloj hallvash, të cilat treteshin në gojë. Në fund vinin dhe sazexhinjtë.

Thikësi ziente nga mysafirët. Në çdo shtëpi kishte nga katër-pesë deri në dhjetë vota. Nga çdo shtëpi dëgjoheshin dollira dhe zëra të gëzuar. Por gazi më i madh pritej të bëhej të nesërmen, kur që të gjithë, me fshatarë e me mysafirë, do të mblihdeshin në mes të fshatit dhe do të fillonin vallet dhe këngët. Këtë çast e prisnin me ankth sidomos të rinjtë.

Edhe Xel Demiri kishte plot miq. Një i kushëriri i tij nga Bezhari bashkë me të shoqen dhe të bijën, baxhanaku nga Vodica, bashkë me Sofinë, të motrën e Zikes dhe me të dy djemtë, vërsnikë të Sotirit, Fetihu nga Xhufika, i cili qe muhamedan, por qenë bërë vëllamë me Xelin dhe verin e vinin. Tërë natën e kaluan me muhabet e me këngë.

Të nesërmen që në mënges sheshi në mes të fshatit u mbush plot me njerëz. Pramatarët dhe hallvaxhinjtë e kishin gdhirë aty dhe zërat e tyre i jepnin gjallëri dhe më të madhe

sheshit. Të rinjtë vërtiteshin rreth pramatarëve dhe shikonin me kureshtje gjërat e bukura, që i kishin radhitur nëpër kapakët e sëndukëve. E çfarë nuk kishte atje: thikë, zinxhirë, breza, rruaza, unaza të ndryshme, e çfarë jo.

Disa blinin dhurata dhe i këmbenin midis tyre. Që të gjithë qenë veshur me rrobat më të mira që kishin. Djemtë me setra të reja e me kravata si qytetarë, vajzat me fustanë allafrënga dhe me shami në kokë.

Pak nga pak sheshi në mes të fshatit u mbush dinga me njerëz. Në karrige kishte bërë vend edhe Marko Broqja me miqtë e tij përpara dyqanit.

Edhe Xel Demiri erdhi aty me mysafirët e tij. Sotiri bashkë me djemtë e tjerë kishin ardhur që më parë dhe po lozin rripin në një kënd mënjanë.

Në këtë kohë u dëgjua një zë:

— Sazet! Sazet!

Të rinjtë i lanë lodrat menjëherë e u derdhën e u dolën përpara.

Sazexhinjtë qenë pesë veta. Alikoja në krye të tyre. Ai ishte i njohur në fshat se vinte vit për vit. Dhe jo vetëm kaq, por edhe për dasmat atë thërrisnin. Alikoja i binte gërnëtës. Pas tij vinin dy burra pak të zeshkët, me buzukë ndër duar dhe një gjataman me violinë. I fundit kishte një daulle më krahë.

Sazet zunë vend në ca rrogözë që u kishin shtruar mënjanë dhe menjëherë filluan të kurdisnin veglat e tyre.

Të rinjtë të mbledhur rreth e rrotull po i shikonin me një lloj habie. Ky zanat u dukej i mahnitshëm, sikur kishte diçka magjike.

Alikoja ia mori një kabaje kolonjarçe.

Zëri i gërnetës u përhap si ndorjë vaj i ngashëruar, i cili sa ngrihej përpjetë e më përpjetë; me aq dhembje e mallëngjim, sikur qante me të vërtetë.

Veglat e tjera e shoqëronin me ngadalë. Ato i mbanin iso vajit të gërnetës, sikur ligjëronin edhe ato bashkë me të.

Fshatarët po e dëgjonin Alikon si të shastisur dhe u dukej sikur ai u qante hallet dhe i nanuriste në një ëndërr sa të bukur, aq edhe të dhimbshme. Ata s'guxonin të merrnin edhe frymë, për të mos prishur qetësinë që kishte pllakour tërë sheshin e fshatit.

Më në fund gërneteta e uli aq poshtë zërin, sa u këput fare, sikur vdiq në një të gërritur të ngjirur.

Atëherë Markoja u ngrit nga vendi dhe i thirri Alekos:

— Mos vdeksh kurrë, o Aliko! Dhe t'u gëzofitë zemra!

Pastaj i vajti pranë dhe i ngjiti në ballë një pesëfrangëshe.

— Hajde, tani jepi një çamçe! — e urdhëroi ai.

Alikoja atë sikur priste. Dhe kabaja më të qarë kolonjarçe u kthye në një çamçe të gëzuar.

Burrat e kapën për dore njëri pas tjetrit. Rrethi u mbush plot me njerëz. Në krye të valles ishte Markoja, pas tij vinte Xeli e me radhë fshatarë e mysafirë.

Markoja e drejtoi trupin, ngriti kryet për-pjetë, pastaj u vërtit një herë në një vend, kërcëu në erë dhe u var në duart e Xelit, por menjëherë u shkëput prej tij, u vërtit rreth e rrotull dhe ra me njërin gju përmbi tokë.

Të gjithë, burra e gra i kishin ngulur sytë tek ai dhe e shikonin me një lloj zillie. Por edhe Xeli, ama, mirë ia mbante. Herë pas here ai i thërriste: «Hajde, hajde!» dhe Markoja sikur e kuptonte se ç'donte t'i thoshte ai dhe herë vërtitej më të majtë, herë më të djathtë, herë kërcënte me njërin këmbë, herë ulej në gjunjë.

Kur mbaroi vallja, burrat e përshëndetën:

— T'u gëzoftë zemra, o Marko, se na kënaqe me këtë çamçe!

Menjëherë pastaj u zunë në valle të rinjtë, vajza dhe djem dhe jo si njëherë që loznin veç e veç, por bashkë. Midis tyre shquheshin edhe Sotiri me Talinë. Dhe jo larg njëri-tjetrit, por zënë dorë për dore.

Markovicës iu zhduk ajo buzëqeshje që i zbukuronte fytyrën, kur hidhte vallën i shoqi. Menjëherë u bë pikë e vrer. Domethënë e bija e kishte gënjyer. Herë pas here shikon-te me druajtje për nga Markoja për të kuptuar se çfarë mendonte ai, por i shoqi llafo-sej dhe qeshte me mysafirët sikur s'po rdo-dhte gjë.

Nga ana tjetër Zikja po i gëzohej të birit:
«Kur u rrit djali, kur u bë për t'u martuar,
s'e pamë fare.»

Talia me Sotirin u zunë dorë për dore
edhe në vallen e dytë, edhe në të tretën.

Kjo u bëri përshtypje, jo vetëm Marko-
vicës dhe Zikes, që i ndiqnin me sy fëmijët
e tyre, por që të gjitha grave dhe vajzave
të fshatit që gojosnin çupat dhe djemurinë.

Markovica s'duroi dot më, u kthye nga i
shoqi dhe i tha me ngadalë në vesh, që të
mos e dëgjonin mysafirët që ishin pranë:

— Po kjo bushtra jonë, ç'po bën kështu,
s'i ndahet djalit të Xel Demirit, sikur janë
të fejuar!

Dhe priste që Markoja të ngrihej i zemë-
ruar nga vendi e ta hiqte çupën nga vallja.

Po Markoja ia ktheu i qetë:

— Ama dhe ti, grua, si ndonjë çilimi po
bëhesh, sikur s'ke qenë e re. Të rinj janë
ata, le të lozin si të duan.

Markovica mbeti me gisht në gojë. Dome-
thënë Markoja i dinte të tëra dhe bënte ve-
shin e shurdhër. Me një fjalë atij i pëlqente që
Talia e tyre të lidhte jetën me Sotirin e Xel
Demirit. Dhe tha me vete: «Po dhe unë mos
po bëhem e marrë? Ku do të gjejë çupa djalë
më të mirë?»

Gazi dhe hareja vazhduan në Thikës gjer
në mbrëmje. Pastaj u kthye përsëri nëpër
shtëpitë dhe reksi aty nga mesi i natës.

Ditën e tretë fshatarët i përcollën mysafirët e tyre deri te Sheshi i Dhëndurëve. Thikësi mbeti si i shkretë. Tërë zhurma e atyre dy ditëve kishte reksur, edhe pramatarët, edhe hallvaxhinjtë, bile edhe gazet kishin ikur.

Vetëm dashuria e Sotirit dhe e Talisë kishte mbetur në gojë të njerëzve, bile me mendje ata edhe i kishin martuar.

V

Jeta dhe puna e rëndë gjatë pushimeve në fshat e kishin bërë Sotirin më të fortë e më të shëndoshë. Ai qe rritur atë vit më shumë edhe nga trupi, ishte bërë më i madh bile edhe nga i ati. Xeli e shikonte këtë me një lloj shqetësimi dhe herë pas here thoshte me vete: «Po ky djali im ku po vete me këtë gjatësinë e tij?! Në sojin tonë nuk kemi pasur njeri të tillë!», kurse Zikja i gëzohej të birit dhe i thoshte hapur:

— Djali i tetes, sivjet hodhe aq bojë sa e arrive dhe e kalove tët atë!

Edhe fytyra i qe ndryshuar. Ajo i kishte marrë një ngjyrë gruri të errët nga dielli dhe nga era. Kishte filluar të rruhej dhe faqet i kishte gjithnjë të lëmuara si të rdo-një vajze. Por duart i qenë trashur nga puna e përditshme nëpër arat dhe nuk i ngjisnin si duar shkollari.

Aq kishte ndryshuar Sotiri atë vit, sa që as teto Sofika, as shokët e tij të klasës nuk e njohën dot menjëherë kur u kthye në Korçë.

Kur e pa te dera, teto Sofika e pyeti:

— Sotirin kërkon, mor djalë? Po ai akoma nuk ka ardhur.

— Po unë jam Sotiri, dora vetë, — e ndërpreu ai.

— M'u thaftë goja m'u thaftë, po s'të njoha dot, mor djali i teto Sofikës! Ti je bërë si thirijo!

Po shpejt u mësuan që të gjithë me të dhe si ngaherë filloi jeta e zakonshme e shkollës.

Sotiri mbaronte atë vit Liceun dhe sipas zakonit i vuri kasketës një shirit të bardhë përpara, i cili rdyshonte nga ai i klasave të tjera që qe i kuq.

Ëndrra e të atit dhe e atij vetë, ëndrra e të gjithë brezave të familjes së tyre, po afrohej. Sivjet i jepte fund shkollës dhe shiriti i bardhë e tregonte fare qartë këtë, jo vetëm në Lice. Edhe qytetarëve, edhe fshatarëve kur i shikonin liceistët me

shirit të bardhë në kasketë u bëhej zemra mal, ndienin një lloj krenarie dhe ata se nesër do të kishin më tepër doktorë e dentistë, inxhinierë e profesorë. Ja, këta djem me shiritat e bardhë nesër do të ktheheshin doktorë e dentistë e profesorë e s'do të kishin nevojë për të huajt, por shqiptarë, siç qe midis tyre profesori i edukatës morale që e adhuronin gjithë studentët. Natyrisht edhe Sotiri nuk bënte përjashtim prej të tjerëve. Profesori ishte një djalë i ri. E quanin Petrit Shkëmbi. Petriti ndërronte nga të gjithë profesorët e tjerë. Vishej mirë, por jo ekstravagant. Por ajo që më shumë e bënte të ndryshonte krejtësisht nga profesorët e tjerë qe mënyra se si sillej me studentët, si rrinte e bisedonte me ta si shok. Për këtë e kishin thirrur njëherë edhe në drejtori dhe i kishin thënë se kështu siç vepronte ai do të humbte autoritetin përpara nxënësve. Por Petrit Shkëmbi e kishte mbrojtur aq mirë sjelljen e tij, sa më në fund drejtori i kishte thënë, bëj si të duash, por ta dish që ne të dolëm nga borxhi, po të të ngjasë gjëserdi.

Petrit Shkëmbi me sjelljen e tij e kishte bërë pas vetes gjithë nxënësit.

Filizati e rinj të Liceut, që i kishin zemrat të dëlira, prekeshin nga parimet që dëgjonin prej tij dhe qenë gati t'i vinin edhe në jetë. Por a mund t'i zbatonin ato, në atë kohë dhe në atë botë që ata rronin?

Mësimi i edukatës morale u bë për Sotirin

një nga orët më të dashura. Ai hynte i pari në klasë dhe dilte i fundit. Profesorin e shikonte në gojë kur fliste dhe nuk donte t'i shpëtonte asnjë fjalë nga mësimi i tij. Përveç kësaj merrte dhe shënime në një fletore.

Këtë e kishte vënë re edhe vetë Petrit Shkëmbi dhe një ditë i kishte thënë:

— Ti, Sotir, do të bëhesh njeri i mirë, se ke zemër të drejtë dhe të dhimbshme, por vetëm me dhembshuri nuk shkon dot shoqëria përpara.

Këto fjalë Sotirit nuk i dilnin nga mendja. Ai duhej të punonte, të mësonte sa më shumë, por edhe të përpicej, si për veten e tij, ashtu edhe për shoqërinë.

Më dhjetë tetor oborri i Liceut u mbush plot me studentë. Qe dita e Themistokli Gërmeniit dhe me këtë rast do të mbahej një miting përpara përmendores së tij, të cilën do ta hapte drejtori i shkollës, kurse fjalën e rastit do ta mbante Petrit Shkëmbi.

Studentët ishin të emocionuar e i thoshin njëri-tjetrit: «Asnjë të mos mungojë! Në miting do të flasë zoti Shkëmbi!»

Oborri i Liceut zhuzhinte si ndonjë koshere me bletë. Studentët e klasave të larta rrinin në një vend dhe diskutonin ngjarjet e ditës, kurse më të rinitë loznin duke rendur poshtë e përparë.

— Të gjithë studentët të radhiten sipas klasave, tre nga tre! — u dëgjua zëri i profesorit të edukatës fizike.

Atëherë një rrëmujë edhe më e madhe

u ndie në oborr. Por kjo mbaroi shpejt. Dhe atje pllakosi një heshtje e plotë.

Pas pak dolën jashtë edhe profesorët me të dy drejtorët, Pertef Pogonin, drejtorin shqiptar, dhe Dekurvilin, drejtorin francez. Ata bisedonin midis tyre, seriozë dhe të përqendruar, sikur edhe tani zgjidhnin çështje të rëndësishme.

Dalja e tyre bashkarisht u bëri përshtypje të madhe studentëve se rrallë i shikonin profesorët e Liceut kështu. Ata ose shëtisnin vetëm, ose me ndonjë shok që u hahej muhabeti. Ja, Bajiu, profesori francez i gjeografisë, ai shquhej përmbi të tjerët për trupin e tij të bëshëm e të gjatë. Pranë tij dukej Kri Kriu, i cili të binte në sy menjëherë, me atë fytyrën e tij thatime, por të gjallë dhe shprehëse.

Sotiri zbuloi pranë Kri Kriut profesorin e edukatës morale, i cili po fliste me të për diçka, qetë, pa lëvizje duarsh, pa shenja në fytyrë. Ai ia tregoi menjëherë Maqos, shokut të tij që kishte përbri, dhe që të dy u panë sy ndër sy me një lloj admirimi. S'patën kohë të këmbenin fjalë, se profesori i edukatës fizike dha urdhër:

— Para marsh!

Ishte akoma mëngjes dhe rrugët e qytetit u zgjuan nga kënga rilindëse.

Zunë të hapeshin edhe dritaret e shtëpive. Udhëtarë që kalonin rastësisht qëndronin dhe i ndiqnin me sy studentët e Liceut,

kurse fëmijët e vegjël i ndiqnin prapa duke rendur.

Kështu profesorët dhe studentët arritën pranë kopshtit të Themistokli Gërmenjit, ku ngrihej përmendorja e tij. Që lart monummenti i bronztë shikonte si me admirim, si i gjallë, sikur donte t'u thoshte diçka e s'u thoshte dot.

Profesorët zunë vend pranë piedestalit dhe vendosën një kurorë me lule të freskëta. Qëndruan një minutë në heshtje për nder të tij dhe pastaj u kthyen nga studentët.

Fjalën e mori Pertef Pogoni.

— Nxënës të dashur, sot ne përkujtojmë një nga pionierët e Rilindjes sonë, i cili si me pushkë, ashtu edhe me pendë, luftoi tërë jetën e tij për çlirimin e Shqipërisë. Dhe Shqipëria u çlirua. Por ditë më të zeza e pllakosën vendin tonë shumë shpejt. Dhe ai si ushtar i thjeshtë i kombit u hodh përsëri në luftë për të mbrojtur të drejtat e tij. Me sakrifica të mëdha, midis ujqish të pangopur, ai mundi të krijonte më një mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë Republikën e Korçës. Por për këtë do t'ju flasë sot zoti Petrit Shkëmbi.

Dhe, duke u kthyer nga ai, tha:

— Urdhëro, zoti profesor!

Me hap të zhdërvjellët profesor Petrit Shkëmbi u ngjit në shkallët e përmendores dhe u hodhi një sy që andej të gjithë nxënësve dhe popullit, që prisnin në heshtje fjalën e tij.

— Nxënës të dashur, gjëja më e shtrenjtë që ka njeriu është jeta. Por njeriu i vërtetë është ai që dhe përpara rrezikut që e kërcënon diçka të shenjtë e sakrifikon jetën.

Ca nga profesorët u panë sy ndër sy, sikur donin të thoshin. «Po ky, moral po na bën tani!» Por nxënësit dhe njerëzia përreth e dëgjonin me vëmendje të madhe.

— Kështu ka vepruar gjithmonë edhe Themistokli Gërmenji edhe atëherë kur luftonte me pushkë në dorë kundër halldupit edhe atëherë kur ngriti Republikën e Korçës.

Rrethkomandanti që kishte ardhur bashkë me një repart xhandarësh u hodhi një sy atyre që i kishte pranë, sikur donte t'u thoshte: «Me t'ju dhënë shenjë, hidhuni përpara!»

— Shtetet imperialiste, — vezhdoi Petrit Shkëmbi, — qenë kapur fyt për fyt midis tyre, për të ndarë botën, për të ndarë shtete dhe për të vepruar ashtu siç ua donte qejfi atyre.

Atëherë Shqipëria jonë e vogël u bë arenë lufte. Patriotët shqiptarë nuk mund ta duronin dot këtë gjë, se ai që vatani i tyre; vendi i gjyshërve dhe i stërgjyshërve, ndaj u ngritën më këmbë. Populli i ndoqi pas dhe i detyroi imperialistët të pranorin kërkesat e tyre. Dhe i detyruan jo me fjalë, por me pushkë. Kjo ishte një fitore e madhe e popullit heroik të krahinës së Korçës.

Nxënësit duartrokitnin.

— Rroftë Shqipëria!

Rrethkomandanti dha shenjë. Ca xhandarë deshën të çanin turmën dhe të kalonin përpara. Por radhët e fundit, që ishin studentët e klasave të larta, u ngjeshën me forcë pranë njëri-tjetrit dhe ata ngecën për një hop në vend.

Petrit Shkëmbi vazhdoi:

— Themistokli Gërmenjin e zgjodhën kryetar të Republikës. Dhe ai filloi menjëherë nga puna e rindërtimit. Së pari hapi shkollat, se e dinte që, po t'u hapte sytë njerëzve, ata kurrë nuk mund t'i nërshtonin, se dija është më e fortë nga padija, se drita është më e fortë nga errësira.

Së shpejti populli filloi ta merrte veten, zuri të zgjohej. Por kjo nuk ishte as në interes të shteteve imperialiste, as në dobi të shteteve fqinje. Ata nuk e shikonin me sy të mirë një Shqipëri të pavarur. Ata e kishin halë në sy dijen e shqiptarëve dhe donin t'i mbanin injorantë përgjithnjë që t'i kishin vegla të tyre.

Atëherë rrethkomandanti dha urdhër me zë.

— Ndaloni mitingun!

Xhandarët, që gjer atëherë përpiqeshin si me të mirë të kalonin përpara, zunë të shtyheshin me forcë.

Sotiri, i cili ishte në një radhë bashkë me nxënësit e filozofisë, u kapën dorë për

dorë dhe po u bënin ballë një tre a katër xhandarëve që ishin turrur nga ana e tyre.

Ata edhe kacafyteshin edhe dëgjonin fjalët e profesorit të tyre:

— Vepra e Themistokli Gërmenjit dhe kujtimi i tij do të rrojnë përjetë, si në zemrën e rinisë shqiptare dhe të gjithë popullit shqiptar, si pishtar i gjallë, që nuk mund ta shuajë asnjëri...

Sotiri po rrihej me një xhandar. Me një dorë kishte zënë kondakun, me dorën tjetër po mbrohej e po dëgjonte qartë fjalët e fundit të profesorit:

— ... Themistokli Gërmenji s'përfilli asgjë për të mirën e përgjithshme, as interesin personal, as atë që ka njeriu më të shtrenjtë, jetën e tij, dhe ra dëshmor përpara altarit të kombit!

Kopshti u bë rrëmuje. Xhandarët kishin depërtuar tanimë nëpër radhët e studentëve dhe po i shpërndanin.

Por edhe mitingu kishte mbaruar, ndonëse jo në mënyrë solemne. Profesorët bashkë me drejtorët u tërhoqën nga përmendorja dhe ashtu grumbull siç ishin u nisën për nga Liceu.

Sotiri kishte ngrënë një kondak në shpatulla dhe e ndiente tërë trupin t'i dhimbte. Krahun e majtë nuk mund ta lëvizte fare.

VI

Sotiri u kthye në shtëpi dhe menjëherë ra në shtrat. Shpatulla i dhimbte aq shumë, saqë nuk e lëvizte dot fare dorën e majtë. Mornica i kalonin nëpër trup dhe një e nxehtë e kishte pushtuar tërë qenien e tij. Në kllapi i dilnin përpara të gjitha ç'kishin ngjarë: Themistokli Gërmenji i madh, i lartë, siç qëndron në përmendoren e tij në mes të qytetit, profesori me atë fjalën e tij të zjarrtë, xhandari me të cilin qe kafytur.

Teto Sofika nuk kishte kuptuar asgjë ç'ki-

shte ngjarë, nuk kishte dëgjuar as zërat e studentëve, as thirrjet e xhandarëve, megjithëqë shtëpia e saj nuk ndodhej larg kopshtit të Themistokli Gërmenjit. Asaj i vajtj mendja se Sotiri do të kishte diçka derisa, me t'u kthyer, kishte rënë në rrobat. S'iu durua dhe u ngjiti sipër.

— Ç'ke, djalë i tetos? — e pyeti ajo kur e pa gjithë djersë.

— Se pse më dhemb dora, teto Sofika.

— Pa sebeb nuk të dhemb, do t'i kesh bërë gjëkafshë. Mos ke luajtur me ndonjë shok dhe e ke përdredhur.

— Jo, teto, — ia priti Sotiri dhe nuk vazhdoi dot më tutje.

— Pa dale të të shikojë teto Sofika se ku të dhemb.

— Ja, këtu! — mezi u përgjigj ai, duke i treguar me vështirësi shpatullën e maitë.

— Po ti e ke kurrizin pleh, mor bir. Po ta lësh kështu, do të të kalbet vendi dhe do të shkosh për dhiamë qeni. Po kush të ka rrahur kështu, që perëndia e rraftë! — zuri të mallkonte teto Sofika. — Prift këtu, — tha ajo dhe, pa pritur përgjigje, duke tundur kokën e duke nxituar, zbriti poshtë në ashef, mori disa kokë cepë, i qëroi shpejt e shpejt, i shtroi në një kupë të drunitë, u hodhi nërsipër dhe një dorë krinë, i përzieu përsëri dhe, duke rëndur, u ngjiti sipër.

Kur e pa Sotiri me atë shami të bardhë në dorë, e pyeti:

— Ç'e ke këtë, moj teto?

— Kjo ta merr si me dorë të shëmkosurrit.

Dhe teto Sofika ia pllakosi vendin e vrapë me shami dhe ia lidhi.

— Po për të ngrënë, a ke ngrënë gjëkafshë? — dhe menjëherë shtoi: — Uh, sa bu dallage që jam dhe unë! — dhe zbriti prapë në ashef, i bëri një çaj, i theku ca bukë, mori dhe ca djathë në një pjatë, i vuri pastaj në një dhisk dhe u ngjit shpejt sipër. — Të solla një çikë çaj se të bën mirë. Ha dhe një fetë bukë. se erdhi dreka. Po t'i lë këtë, — shtoi plaka dhe ia vuri në një karrige pranë shtratit.

Si iku teto Sofika, Sotiri psherëtiu si i lehtësuar.

Në mbrëmje u kthye në shtëpi edhe Vaska. E dinte që Sotiri kishte marrë pjesë në mitingun e Themistokli Gërmenjit dhe vajti drejt e në dhomën e tij.

— Sotir, ti qenke i sëmurë! U habit ai.

— Haide, haide! — e ndërpreu Sotiri.

Vaska mori një karrige dhe u ul.

— Ore, të të them të drejtën, unë erdha më tenër të mësoj ndonjë gjë më shumë prej teje nga mitingu i sotëm. Më ra në vesh diçka, por pak.

Sotiri u ngrit ndenjur në shtrat, ktheu dorën e majtë ngadalë përpara, nastai t'ha:

— Mbaiti fialë Petrit Shkëmbi, profesori i edukatës morale.

— Këtë e mora vesh!

— I tha të gjitha, aq sa xhandarët u xhindosën e u hodhën të shpërndanin mitingun, por më kot, se studentët e Liceut nuk i lanë dhe profesori e mbaroi fjalimin e tij gjer në fund.

— Po si e pësëve, mos more pjesë dhe ti me studentët e tjerë?

— Ama dhe ti si thua, po liheshin ata kodoshë t'i prisnin fjalën profesorit?

— Burrë i mësuar dhe i vendosur është!
— vazhdoi Vaska.

— Pse, e njeh ti?

— E kam dëgjuar dhe unë të flasë. Ai është i vetmi nga profesorët e Liceut, i cili shoqërohet edhe me ne punëtorët. Na foli një ditë në një ekskursion që bëmë në Çardhak. Por siç duket sot do të ketë thënë ndonjë gjë shumë më të fortë, që u hodhën xhandarët për të shpërndarë mitingun. Më vjen keq, Vaskë, që s'u ndodhe atje e të dëgjoje vetë. E di si e mbaroi fjalën? «Themistokli Gërmenji s'përfilli asgjë për të mirën e përgjithshme, as interesin personal, as atë që ka njeriu më të shtrenjtë, jetën e tij, dhe ra dëshmor përpara altarit të kombit!»

— Ashtu është, kur njeriu përpiqet për një ide të drejtë dhe që e ka përqaftuar me tërë kuptimin e fjalës, atij nuk i vjen keq edhe për jetën! — ia priti Vaska.

— Vërtet ashtu qenka. Ke të drejtë, Vaskë! — shtoi Sotiri.

— Po dhe ti e paske pësuar, — tha Vaska.

— Pak! — ia ktheu Sotiri sikur nuk kishte pësuar gjë.

Vaska u ngrit.

— Po rri dhe një çikë, o Vaskë, — iu lut Sotiri.

— Jo. Do të shkoj. Nesër mbrëma do të mblidhemi me ca shokë te shtëpia e Koci Bakos, po të duash, eja dhe ti.

Sotiri qeshi nën buzë.

— Do të vij! Dhe falemnderit që nuk më harron.

— Si të të harroj! Vepra jonë ka nevojë për të gjithë. Me pak njerëz ajo s'bëhet. Tërë populli duhet të marrë pjesë në të. Po t'i lemë këto tani. Hajde, natën e mirë!

— Natën e mirë, Vaskë!

Kur mbeti vetëm, Sotirit i vinin lloj-lloj mendimesh e ai nuk u jepte dot udhë.

VII

Mbrëmave rrugët e Korçës gjallëroheshin për njëfarë kohe. Punëtorët ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre ngadalë e të lodhur, kush me veglat në krahë e kush me torbë në dorë.

Llambat e rralla të qytetit llamburisnin aty-këtu, sidomos në rrugët kryesore, nga Shëngjergji e lart, kurse nëpër rrugicat ato mungonin fare, ose kishte vetëm nga ndonjë nëpër qoshet apo në hyrjet e tyre.

Rruga e Lagjes së Lumit, ku e kishte shtëpinë Koci Bakoja, qe fare e errët. Ajo kishte vetëm një llambë elektrike në të hyrë të saj, kurse më tutje ndriçohej nga dritat e shtëpive. Si ktheheshin burrat nga puna, rrallë e tek

do të takoje njeri udhës, përveç rojave që kalorin herë pas here dhe sikur e zgjonin nga gjumi lagjen e heshtur.

Atë natë Koci i kishte dërguar fëmijët tek e vjehrra, për të mos i shqetësuar shokët. E shoqja kishte ndenjur në shtëpi për t'u shërbyer mysafirëve dhe për t'i ndihmuar në ndonjë gjë të shoqit.

Koci kishte sjellë nga dyqani edhe radion, për t'i kënaqur shokët dhe akoma më tepër për të dëgjuar Radio Moskën. Ai nuk e kuptonte rasishten, por i vinte mirë kur dëgjonin sinjalin e saj dhe emrat e njohur të Leninit e të Stalinit.

Filluan të vinin edhe shokët. I pari erdhi Petroja. Ai qe një nga rrobaqepësit e dëgjuar të Korçës.

Koci, me ta parë, i dha dorën dhe me zërin e tij kumbues e përshëndeti:

— Hajde, Petro, mirë se na erdhe! Rri. Po të kishe ardhur dhe dy sekonda më parë, do të dëgjoje Tefta Tashkon. Ama ç'zë që ka, o Petro, si ndonjë bilbil këndon!

— Bukur këndon, vërtet, — tha Petroja duke u ulur në një karrige.

— Po të tjerët ku janë?

— Do të vijnë një nga një, që të mos biem në sy?

— Ore, s'kam durim gjersa t'ju shoh të gjithë këtu dhe të qetësohem.

Dhoma e miqve e Koci Bakos ishte përdhese dhe shikonte drejt e në oborr. Oborri qe i rrethuar me avulli të larta dhe kishte

një deriçkë, e cila të nxirrte në rrugën tjetër.

U hap dera dhe hynë brenda Vaskë Teli me Sotirin.

Koci kërceu nga vendi dhe u doli përpara!

— Urdhëroni, urdhëroni! — dhe u tregoi dy karrige për t'u ulur.

Vaska u kthye nga Petroja!

— Ja, ky është ai djali nga Thikësi, që studion në Lice, për të cilin të kam folur.

— E njoh, e njoh mirë Sotirin! — tha Koci duke e shikuar drejt e në sy.

— Qofsh shëndoshë, mor djalë! — e përshëndeti Petroja, që ishte më i madh nga të tjerët.

Erdhi edhe një që e quanin Niko, por Sotiri atë nuk e njohte. Pastaj erdhi shoku i tij i shkollës tregtare, Tatoja. Habia më e madhe për Sotirin që kur në dhomën për-dhese të Koci Bakos hyri profesori i edukatës morale, Petrit Shkëmbi dhe sesi u ndrydh në vetvete. Iu duk vetja i vogël, për të marrë pjesë në një mbledhje të tillë.

Koci, i cili rrinte në këmbë, si u ulën të tërë, tha:

— Tani që të gjithë jemi këtu, mund të fillojmë. Sonte kam sjellë nga dyqani radion dhe, meqë tani ora është tetë pa dy minuta, le të dëgjojmë për një çast orën e Kremlinit!

Që të gjithë i ngulën sytë nga kutia e aparatit dhe pas pak dëgjuan sinjalin e Mos-

kës. Të gjithë e dëgjonin me respekt dhe me një lloj dashurie të veçantë. Secili me mendjen e tij përfytyronte një botë, ku revulucioni tanimë kishte fituar dhe njerëzit kishin të drejta të barabarta.

Si mbaroi ora së rëni, hyri e shoqja e Kocit me një dhisk në dorë me shtatë filxharë kafe dhe me nga një gotë ujë.

— Mirëmbërmani dhe mirë se na erdhët, urdhëroni, urdhëroni!

Disa nga rrethi u përgjigjën:

— Po ç'e deshe këtë kafe tani, moj e Kocit.

— Urdhëroni, urdhëroni, s'është asgjë kjo! — tha Koci.

Kafenë e pinë shpejt e shpejt dhe pa muhabet. Nusja e Kocit, e cila rrinte më këmbë dhe shikonte se kush e mbaronte, e merrte filxhanin duke e uruar.

Si e pinë që të gjithë kafënë, nusja e Kocit i mblodhi filxhanët dhe u tërhoq në të ndarën tjetër, u ngjit sipër në tavan ku kishin një baxhë dhe u ul pranë saj, si gjithnjë, të bënte rojë derisa të mbaronin mbledhjen burrat.

I pari e mori fjalën Petroja!

— Shokë, — tha ai, — si morëm direktivat e kominternit për të formuar një front popullor dhe për të bashkuar në këtë mënyrë masat e gjera të popullit dhe intelektualët përparimtarë, puna po na shkon mirë. Tani kemi shokë nëpër të gjitha organizatat e shoqëritë e ndryshme.

Sotiri për herë të parë po i dëgjonte këto fjalë. Dhe i erdhi mirë që shokët e konsideronin atë të afërm, sa që të hapnin të fshehtat dhe përpara tij. Por në asnjë mënyrë nuk e ndiente veten se do të ishte në gjendje të merrte fjalën.

Pas Petros foli Nikoja, e pas tij profesori.

— Duhet të shfrytëzojmë dhe konditat e vendit, të cilat dita me ditë po arrihen për një revolucion të përgjithshëm.

Nikoja kundërshtoi:

— Revolucion të përgjithshëm në Shqipëri! Ku sundon akoma feudalizmi, ku borgjezia nuk ka filluar të zhvillohet?

— Vendi zien nga urrejtja kundër satrapit Zog, i cili ia shiti Shqipërinë Italisë fashiste me kreditet që ka marrë dhe me koncensionet që i ka dhënë. Në ushtri solli oficerë italianë, kurse vendet kyçe të administratës janë prapë në duart e tyre. Vetë Banka Kombëtare e Shqipërisë është pronë italiane. Ne ekzistojmë sot si shtet vetëm si emër. Po të vazhdojë kështu, edhe këtë do ta humbasim nesër e pasnesër. Prandaj duhet të ngrihemi që të gjithë, si një grusht i vetëm e ti shtypim si bejlerët, ashtu dhe afendikonjtë, bashkë me mbretin satrap, dhe të vendosim pushtetin e popullit, — tha profesori.

— Pa pasur një Parti komuniste, e cila t'i edukojë, drejtojë dhe t'i hedhë në luftë masat popullore! — qeshi Petroja.

— Në Korçë grupet komuniste punojnë

mirë. Duhet të kemi lidhje me grupet e tjera komuniste të vendit, për të cilat dimë se ekzistojnë në qytetet e tjera. Ne nuk njohim mirë as shokët e Tiranës, as ata të Shkodrës. Duhet të bashkohemi në të parët dhe pastaj të bashkojmë gjithë popullin! — vazhdoi profesori.

— Bashkimi bër. fuqinë! — thirri Koci Bakoja.

— Fjalë me vend. Ne duhet të futemi thellë në të gjitha shtresat e popullit, t'u shpjegojmë atyre gjendjen e tmerrshme dhe mënyrën se si mund të dalim prej saj.

Nga këto fjalë mori guxim edhe Sotiri.

— Në fshat gjendja është edhe më e keqe sesa në qytet. Fshatari s'ka asnjë të drejtë, Atë e shfrytëzon edhe beu, edhe afendikoi, edhe vetë qeveria. Me sytë e mi pashë sivjet në fshat se si e lidhën një fshatar të varfër me pranga, se nuk kishte të holla për të paguar taksat. Dhe si tha edhe zoti profesor, që duhet të futemi thellë në të gjitha shtresat popullore, nuk duhet të lëmë mënjanë edhe fshatën, ku ka shumë njerëz përparimtarë që janë gati të futen në radhët tona.

Profesori tundi kryet në shenjë pohimi, kurse Nikoja u përtyp.

— Mirë, xhanëm, të zgjohemi, por ama grupet tona duhet t'i mbajmë të fshehta, që të mos na zbulojë armiku dhe të mos na i presë lidhjet!

— Ore Niko, po të veprojmë kështu, duhet të presim të paktën edhe një mijë vjet

për të formuar Partinë Komuniste Shqiptare!
— e kundërshtoi Koci.

— E po të zbulohemi e të vritemi kot? —
ia ktheu Nikoja.

— Dasmë pa mish s'ka, Niko! Në qoftë se
populli do t'i bëjë këto sakrifica, në qoftë
se i ka përqafuar me të vërtetë idetë komuni-
ste, nuk duhet të të vijë keq as për veten
tënde. Vetëm kështu do të ecim përpara dhe
do të kemi pasues të tjerë, që do të na ndje-
kim prapa e do të thonë: «Komunistët vriten
për të mirën e popullit dhe jo për veten e
tyre!» — ia ktheu Petroja.

Në këtë kohë zbriti poshtë duke nxituar
e shoqja e Kocit dhe tha.

Dy roja po vërtiten rreth shtëpisë sonë.
Tani kanë qëndruar përpara portës. Po pinë
duhan dhe mbajnë vesh!

Atëherë Petroja e mbylli mbledhjen duke
thënë:

— Shokë, mos u shqetësoni. Për zgjedhjet
bashkiake u morëm vesh. Tani të dalim nga-
dalë nga deriçka. S'dihet se ç'mund t'u vijë
ndër mend atyre dhe mund të hyjnë edhe
brenda.

Burrat u ngritën.

Koci i udhëhoqi nëpër një korridor të
errët dhe, si i nxori përjashta bashkë me të
shoqen u zhveshën shpejt e shpejt dhe ranë
menjëherë në rrobat.

Nuk kaloi shumë kohë dhe te porta u
dëgjuan të trokitura.

Koci e bëri veshin të shurdhër.

Pas pak e trokitura u përsërit edhe më e fortë.

Atëherë Koci u ngrit nga shtrati, hapi dritaren dhe që andej thërriti:

— Kush është?

— Hape, hape derën, o Koci! — u dëgjua një zë.

— Ç'urdhëroni? — i pyeti ai kur doli përjashta.

— Kaluam këtej dhe thamë të të shikojmë një çikë!

— Po në këtë kohë? Ne kemi rënë në gjumë! — ua priti Koci.

— Ke rënë në gjumë, por nuk ke fjetur, — tha xhandari.

— Do të hyjmë një çikë brenda! — shtoi xhandari tjetër.

— Ore, urdhëroni, por në këtë kohë nuk është për miq! — ua ktheu Koci i shkujdesur.

Dhe ai përpara, xhandarët prapa, hynë në oborr dhe që andej ngjitën shkallët dhe u futën në dhomën e miqve.

Dhoma mbante akoma erë tym duhani. Por nusja e Kocit i kishte radhitur që të gjitha ashtu siç qenë, edhe karriget, edhe velenxat, bile edhe qilimin e kishte fshirë kur Koci po përcillte shokët dhe dukej sikur përmbi të nuk kishte shkelur njeri.

— Po kjo erë tym cigareje ç'është, o Koci? — pyeti një nga xhandarët.

E shoqja e Kocit, e cila rrinte më kë-

mbë, u përgjigj si me inat në vend të burrit:

— Ja, për këtë duhan të flamosur zihemi gjithnjë. Cigare pas cigareje pi, dhe para se të bjerë në shtrat. Ju burrat që të gjithë kështu jeni!

Këto fjalë sikur i qetësuan pak xhandarët, por njëri prej tyre, duke parë radion në tavolinë, pyeti:

— Po këtë drejç ç'e ke sjellë? Apo ke dy, një e mban në ëmbëltore dhe një këtu?

— Një kam, por ju e dini se unë i kam qejf këngët dhe ngandonjëherë e sjell në shtëpi për t'u eglendisur!

— E dimë, e dimë se me se eglendisesh ti, por ki mendjen. Sonte vumë vesh se mos dëgjoje Moskën, por nuk dëgjuam gjë. Dhe ja ku ta themi hapur, se për këtë hymë brenda.

— Ore, ju qenkeni të marrë, — ua ktheu si me të qeshur Koci. Ç'më lypset mua Moskë, unë as gjuhë di dhe asgjë s'kuptoj. Më mjafton Tirana!

— Mirë, mirë! — thanë ata që të dy dhe, duke tundur kryet, dolën përjashta.

Si mbylli portën dhe u kthye brenda, Koci i tha me të qeshur së shoqes.

— Shyqyr që i pe, se, po të na kishin zënë brenda, na mori drejçi, na mori! — dhe përqafoi të shoqen.

VIII

Klasa e Sotirit përbëhej në pjesën më të madhe nga djem bejlerësh, tregtarësh të veçjël e zejtarësh. Të paktë qenë ata të cilët prindërit i kishin në mërgim, në Amerikë ose Argjentinë. Dhe akoma më të paktë nga njerëzit e vendit, ndonjë korçar i varfër, që bënte çmos për të mbajtur të birin në Lice dhe aty-këtu ndonjë fshatar, siç ishte vetë Sotiri.

Vajzat qenë me numër, vetëm pesë, vajza nëpunësish të lartë dhe tregtarësh të mëdhenj.

Sotiri qe mirë me të gjithë, por shokë të ngushtë kishte vetëm dy, Maqon, djalin e një orëndreqësi, me prejardhje nga fshatrat e Kolonjës, si dhe Dalipin, të birin e një këpucari.

Këta të tre dalloheshin nga shokët e tyre, si nga rrobat e thjeshta e të fërkuara që mbanin, ashtu edhe nga të hollat që shpenzonin. Djemtë e tjerë visheshin sipas modës, bile disave ua blinin rrobat në Romë apo në Paris dhe harxhonin pa hesap. Përditë venin nga Kristali dhe nga Mazhestiku, hanin pasta e bënin muhabet për klubet dhe kabaretë e kryeqytetit të Francës, Sotiri me Maqon dhe me Dalipin nuk guxonin të hidhnin pragun e këtyre lokaleve, sepse e kishin xhepin trokë. Dhe në venin ngandonjëherë, venin duke i kursyer lekët nga kafshata e gojës. Ata shpesh dilnin nga Kodrat e Shëndëllisë dhe lexonin mësimet bashkë, apo përkthenin ndonjë broshurë nga frëngjishtja në shqip. Mbrëmjeve do t'i shihje nga ëmbëltorja e Koci Bakos, ku bënin bisedime të zjarrta dhe ëndërronin për një botë më të mirë.

Pas mbledhjes në shtëpinë e Koci Bakos, Sotiri u foli të dy shokëve të ngushtë për zgjedhjet që do të bëheshin së shpejti në Korçë dhe për rëndësinë e tyre. Që të dy i premtuan se do të flisnin me prindërit si dhe dhe me të afërmit.

Pastaj Sotiri foli edhe me nxënësit e tjerë të klasave më të ulëta, që i njihnte dhe që e dëgjonin, si më i madh që ishte.

Në revistën që nxirrte klasa e tyre dhe ku qe përgjegjës Maqoja, ai shkroi një artikull të gjatë për rëndësinë e zgjedhjeve bashkiake dhe se duhej që të gjithë të votonin për Frontin Popullor, sepse Fronti do t'u siguronte bukë dhe punë të gjithë qytetarëve.

Ky numër i revistës u shpërnda menjëherë nëpër klasat e tjera dhe bëri bujë saqë tërë Liceu foli disa ditë me radhë për artikullin e Sotir Demirit.

Disa profesorë e përshëndetën për parashtrimin e drejtë të çështjes që kishte shtruar në artikull si dhe për guximin që kishte treguar.

Profesorët e tjerë e shikonin me një lloj përcmimi këtë djalë të ri, i cili donte t'u jep-te mendje.

Në mbrëmje hyri me rrëmbim në dhomën e Sotirit Vaska dhe e përgëzoi duke e përqaftuar.

— Me atë artikullin që ke shkruar për zgjedhjet i ke luajtur fenë!

Atëherë Sotiri u përmend pse Vaska po e përqaftonte kështu.

— Po ti ku e more vesh?

— Kalova sonte nga ëmbëltorja e Kocit. Atje bisedonin për të. Ti e di që grupi interesohet për punën e studentëve në Lice.

Në këtë kohë u hap dera dhe në dhomë hyri teto Sofika.

— Ju dëgjova që po llafoseshit dhe thashë

së vij t'ju shikoj një çikë, se ka ditë që s'ju kam parë. Po ç'u bëtë, mor djema? Ku jeni?

— Ja ku na ke, moj teto! — ia priti Vaska.

— Mirë ti vete në punë dhe s'ke nge. Po tani as Sotiri nuk mblidhet si më parë në shtëpi. Ditë dhe natë përjashta e ke. Po ku mëson ti, mor bir? Ç't'i them tyt eti, ë?

Fjalët e fundit të plakës e tronditën Sotirin dhe e sollën disi në vete. Nga sukseset që kishte pasur këto ditët e fundit, që si i dehur. Me mësimë vërtet ventë mirë, por nuk që i shkëlqyer si vitin e kaluar.

— Me mësimë, me mësimë vete mirë, teto! — tha Sotiri për ta qetësuar plakën dhe vetveten.

— A doni t'ju bëj nga ndonjë çaj, djema?

— Unë për vete nuk dua! — u përgjigj Vaska.

— Edhe unë s'dua, teto! — shtoi Sotiri

— Atëherë, natën e mirë. Dhe mos më lini kështu vetëm në shtëpi! — u ankua dhe doli.

Pak pak shkoi edhe Vaska.

Sotiri mbeti vetëm në dhomën e tij. Nuk i flihej. Mendja i fluturoi tek i ati, te këshillat që i kishte dhënë. Dhe kjo ndjenjë e dyfishtë: kënaqësie dhe pendimi, luftoi një copë herë në qenien e tij. Kur kujtoi Talinë, ndjeu një krenari në vetvete. Sikur ta dinte ajo se sa bujë kishte bërë emri i

tij në Korçë, do ta donte edhe më shumë.
Me këto mendime e zuri gjumi.

Të nesërmen Sotiri u ngrit shpejt. U
la! U vesh. Dhe tërë duke tororisur një
këngë të re, që posa kishte dalë «O moj
korçare sa e bukur je».

Në mes të mësimit, u hap dera dhe në
klasë hyri xha Nisi, kryekujdestari për mba-
rëvajtjen e rregullit në Lice, dhe tha si me
inat.

— Zoti Bulka, zoti drejtor ju lutet të
lini Sotir Demirin të vejë në drejtori.

— Mirë! — tha ai dhe mblodhi buzët në
shenjë moskënaqësie.

Të gjithë studentët e tjerë e shikuan me
një lloj druajtjeje Sotirin, i cili u ngrit nga
banka i shqetësuar. Për herë të parë po
e thërrisnin në drejtori. Xha Nisi me hap të
ngadalshëm po e ndiqte prapa.

Rruga që nga kati i tretë, ku qe klasa e
tyre, dhe deri në katin e parë, ku ishte drej-
toria, iu duk e largët. Kur arriti përpara
derës së drejtorisë, qëndroi dhe trokiti lehtë.

Nga brenda u dëgjua një zë i zemëruar.

— Hyr!

Sotiri hapi derën dhe, si përshëndeti, u
ndal menjëherë. Drejtorja iu duk aq e madhe,
si ndonjë sallë koncertesh, dhe drejtori prapa
tavoline si ndonjë gjigant.

Me të parë Sotirin, ai kërceu nga karrigia
dhe me vizoren që kishte në dorë iu kanos:

— Ty, për të mësuar të kanë dërguar këtu, apo për politikë! — Sotiri nuk u përgjigj. Tani e kuptoi pse drejtori e kishte thirrur me kaq ngut. — Ç'janë këto që po bën ti këtu në Lice? Në vend që të shikosh mësimet sidomos tani që je në vit të fundit, po merresh me gjëra që s'të hyjnë fare në punë. Ç'të lypset ty politika?

— Zoti drejtor, unë me të vërtetë kam ardhur për të mësuar, dhe ju na mësuar aq sa të jemi në gjerdje të themi mendimin për një çështje që na përket të gjithëve dhe për të mirën e të gjithëve.

Drejtori, i cili deri atëherë vente poshtë e përpjetë, u ndal dhe iu kanos.

— Për të mirën e të gjithëve... Por ti nuk e di sa andralla më ke nxjerrë mua me atë artikull.

— Nuk e kam bërë me qëllim që t'ju sjell andralla, zoti drejtor, por si ju thashë, për të mirën e përgjithshme, që të ndreqim ndonjë padrejtësi, që të kenë që të gjithë bukë dhe punë...

Drejtori e ndërpreu:

— Ti nuk e ke bërë me qëllim, po gurët që hodhe ti, ranë përmbi kokën time. Një që jam përgjegjësi juaj dhe e dyta që në lejojmë në Lice një frymë të tillë. A e di ti se ç'do të thotë kjo për mua? Pushim! Pushim nga puna!

— Zoti drejtor, — filloi të thoshte Sotiri i trembur.

— Oh, për ty është lehtë të gjesh shpjegimin, por duhet të jesh në vendin tim. Të të vij në nga prefektura dhe të të kërkojnë një gjë që s'më lejon pozita. Ç'do të thonë pastaj profesorët e tjerë po të dëboj nga shkolla një nxënës të klasës së fundit? Pastaj, si të thuash, nuk ma lejon as ndërgjegjja që t'i prish të ardhmen një të riu, i cili ka arritur thujt në fund të qëllimit të tij. Jo, jo, këtë s'mund ta bëj.

Sotiri tani e kuptoi që drejtori kishte pasur kokëçarje të madhe me autoritetet e vendit për shkak të artikullit.

— Zoti drejtor, ju falënderoj shumë! — iu përgjigj ai.

Drejtori filloi prapë të vente poshtë e përpjetë, kurse Sotiri s'dinte se ç'të bënte, të ikte, apo të rrinte aty. Ndjenja të trazuara e kishin pushtuar tërë qenien e tij. Herë lëvdonte drejtorin për qëndrimin e tij të çuditshëm, herë hidhërohej që i kishte nxjerrë kaq kokëçarje.

— Tani ik, — tha pas pak drejtori, — por dua të më premtosh se tani e tutje do të merresh vetëm me mësimet dhe jo me politikë.

Sotiri u vrenjt menjëherë në fytyrë. Si mund t'i premtonte drejtorit një gjë të tillë? Ç'do të thoshin pastaj shokët e tij të grupit?

— Fol! — e nxiti drejtori.

Atëherë Sotirit iu kujtuan fjalët e profesorit të edukatës morale, që i kishte

thënë përpara përmerdores së Themistokli Gërmenjit.

— Po për të mirën e përgjithme, zoti drejtor, rilindësit tanë nuk kursyen edhe gjënë më të shtrenjtë, jetën e tyre, kurse ne...:

— Mjaft; mjaft, — e ndërpreu drejtori.
— Tani i kuptova të gjitha se nga vijnë dhe se cili është frymëzuesi yt. Nuk e ke fajin ti, e ka fajin ai që ju ka fryrë kokën me ide të tilla. Jashtë! Jashtë! — iu kanos drejtori.

— Zoti drejtor... — filloi t'i thoshte Sotiri.

— Jashtë! Jashtë! Këtë radhë shpëtove, por, po e përsërite edhe një herë, do të dalësh përjashta edhe nga Liceu!

Dhe Sotiri kokulur dhe i menduar e hapi derën edhe bëri për nga klasa e tij.

IX

Zgjedhjet bashkiake i fitoi Fronti Popullor. Asnjë nga përfaqësuesit e bejlerëve dhe të afendikonjve nuk u fut dot në listën e të zgjedhurve.

Megjithëse zgjedhjet kishin ditë që qenë shpallur, administrata e vjetër vazhdonte punën.

Zgjedhjet e Korçës i treguan qeverisë se atje punët nuk shkonin mirë. Ajo u trondit shumë prej kësaj dhe menjëherë mbajti një mbledhje të posaçme në Tiranë, ku u vendos të shqyrtohej gjendja në vend. Një komisi-

on i veçantë u nis me ngut për në Korçë dhe u shqetësua.

Të gjitha shoqëritë e punëtorëve dhe ajo e Rinisë Korçare, kishin rënë në duart e njerëzve përparimtarë. Duheshin marrë masa të rrepta dhe të menjëhershme. Dhe ata filluan nga Rinia Korçare. Me dhunë e me mashtrime ata u përpoqën të ndërronin udhëheqjen e saj. Por mbledhja e përgjithshme nuk pranoi një gjë të tillë. Përfaqësuesit e pushtetit, të inatosur nga qëndrimi burrëror i anëtarëve, u detyruan ta deklaronin shoqërinë të shpërndarë.

Në shenjë proteste, anëtarët e shoqërisë, bashkë me udhëheqjen e saj, u hodhën në demonstratë. Rrugët e qytetit u mbushën plot me njerëz. Buçitën këngë patriotike. Me ta u bashkuan edhe studentët e Liceut e të shkollave të tjera dhe turma u bë aq e madhe, sa që xhandarmëria nuk guxoi t'i shpërndante, për të mos ngjarë ndonjë gjë e papritur.

Por Fronti Popullor nuk erdhi dot në fuqi. Diçka tjetër edhe më e tmerrshme po e kërcënonte vendin. Në Korçë dalloheshin njerëz të huaj, civilë dhe ushtarakë, sidomos italianë, të cilët herë vinin si turistë, herë si tregtarë e specialistë dhe hanin e pinin nëpër restorantet më të mira të qytetit.

Të përditshmet nga ana e tyre jepnin lajme për përgatitjet që bëheshin për luftë. Italianët ëndërronin të krijonin perandorinë e vjetër romake. Kurse gjermanët çirre-

shin me sa zë që kishin për një marshim në Lindje. Dhe njerëzia binin e ngriheshin nga rrobat pa ditur se ç'mund të ngjiste të nesërmen.

Në mbrëmjen e katër prillit të njëmij-enëntëqindetridhjetenëntës në Korçë dolën fjalë se Italia kishte ndër mend të pushonte Shqipërinë. Ky lajm i kobshëm u përhap me anë të ajrit nga stacionet e shteteve të mëdha.

Korça u gdhi si në ethe.

Në mëngjes lajmi mori dhenë. Dhe asnjëri atë ditë nuk vajti në punë. Studentët gjithashtu e lanë shkollën. Rrugët e qytetit gumëzhinin si në manifestimet më të mëdha, në festat kombëtare apo në demonstratat.

Turmat u drejtuan për nga prefektura, për të mësuar të vërtetën. Të gjithë e hidhnin çapin të vendosur e të zemëruar. U qe prekur sedra kombëtare dhe asnjë nuk mendonte për veten e tij, po për rrezikun e për bashkët që po i kërcënonte.

Përpara prefekturës turma qëndroi. Disa nga radhët e para zunë të thërrisnin.

— Armë! Armë!

Këto fjalë elektrizuan të gjithë gjendjen dhe tërë sheshi, tërë Korça, sikur thërriste.

— Armë! Armë!

Prefekti dhe autoritetet e vendit s'dinin ç'të bënin. Nga të thirrurat e tyre u detyruan të dilnin në ballkon për t'i qetësuar.

Me zë të trishtuar dhe shumë i merakosur prefekti tha:

— Bashkatdhetarë, lajmi është sa i kobshëm aq dhe i rrezikshëm. Por mos u shqetësoni. Lartmadhëria e tij ka marrë të gjitha masat e duhura për çdo eventualitet. Ne duhet të bëjmë një gjë, të mbajmë moralin të lartë. Këto lajme janë përhapur nga stacionet dhe gazetat e huaja me qëllim për të prishur marrëdhëniet e mira që ekzistojnë midis Shqipërisë dhe Italisë. Nga qeveria shqiptare nuk ka asnjë konfirmim të këtyre lajmeve. Përkundrazi sot ato u përgënjeshtroan zyrtarisht.

— Mos gënjeni popullin, zoti prefekt, por jepini armë për të mbrojtur vendin! — u dëgjua një zë që poshtë.

— Armë! Armë! — filloi të thërriste përsëri turma.

Atëherë prefekti e mori përsëri fjalën.

— Bashkatdhetarë të dashur, tani shpërndahuni, pa; po të jetë e nevojshme, ne do t'ju thërresim vetë dhe do t'ju japim armë!

Këto fjalë u pritën mirë nga njerëzia. Dhe si u vërtitën në vend një copë herë, duke biseduar e duke folur me zë të lartë, u shpërndanë. Studentët e Liceut dhe të shkollave të tjera nuk u kthyen nëpër bankat e klasës por u sollën gjithë ditën e ditës dhe gjer në orë, e vona të natës nëpër rrugët e qytetit duke kënduar këngë patriotike.

Sotiri shquhej në krye të tyre me një flamur kombëtar në dorë, të cilin e kishin ma-

rrë bashkë me Maqon fshehurazi nga depoja e Liceut.

Kur u kthye në mbrëmje në shtëpi, teto Sofika e pyeti:

— Mor xhan i tetos, po ku humbe kështu tërë ditën? Ç'po ngjet, mor xhan i tetos, që tërë qyteti po buçet si nga tërmeti? Dhe ç'e ke këtë flamur në dorë si në kohën e komitëve?

— Duan të na pushtojnë breshkamanët, teto! Prandaj po zien gjithë Korça, dhe jo vetëm Korça por tërë Shqipëria. Nën hijen e këtij flamuri populli kërkon armë, që të luftojë për mbrojtjen e vendit!

— Si në kohën e komitëve. Dhe ata me këtë flamur luftonin kundër halldupit! — ia ktheu teto Sofika.

Pas pak u kthye edhe Vaska. Edhe ai, tërë ditën e ditës kishte marrë pjesë në demonstratë.

Zgjedhja dhe shpërndarja e shoqërisë «Rinia Korçare» u harruan.

Të nesërmen Korça u gdhi me të shtëna topash.

Njerëzia e morën këtë si shenjë kushtrimi dhe dolën përsëri nëpër rrugët e qytetit e u drejtuan për nga prefektura. Qenë të kënaqur se më në fund kërkesat e tyre për armë do të plotësoheshin.

Dhe me të vërtetë këtë radhë prefekti ruk i la të prisnin përjashta. Doli shpejt në ballkon me një të qeshur në buzë.

— Bashkaldhetarë, jam i autorizuar t'ju jap një sihariq të madh. Sonte duke u gdhirë e mërkurë, pesë prill, lartmadhëria e saj, Geraldina, lindi djalë. Trashëgimtarit të fronit i vunë emrin Leka i Dytë.

Atëhere nga grumbulli i njerëzisë u shkëput një burrë në moshë mesatare. Ishte Petro rrobaqepësi.

— Nuk e shikoni, o vëllezër, — thirri ai duke u kthyer nga turma, — se këta po tallen me ne? Dje na thanë të presim armë për sot. Sot po na lajmërojnë për lindjen e trashëgimtarit të fronit. Më një fjalë neve po po na digjet mjekra, ata po na japin shkrepëse të ndezim cigaren. Neve na duhet armë Armë për të mbrojtur atdheun. Hajdeni të vemi nga taboja t'i kërkojmë armë ushtrisë!

Dhe u nis i pari. Prapa e ndoqën punëtorët që i rrinin përreth. Pastaj me radhë, që të gjithë u drejtuan për nga kazermat, studentët e Liceut, nxënësit e shkollave të tjera, që të gjithë duke kënduar këngë pariotike.

Por edhe që andej i përcollën vetëm me fjalë. Prisin urdhër nga Tirana. Pa urdhrin e qeverisë nuk mund t'u jepnin armë.

Dhe turma lëkundej gjithë ditën herë këtej, herë andej si ndonjë vapor që e ka zënë shtrëngata në mes të detit dhe s'di se ç'të bëjë për të shpëtuar.

Sotiri me Vaskën gjatë këtyre ditëve shërbenin si ndërlihdje midis profesorit të edukatës morale dhe Petro rrobaqepësit. Dhe

herë hidheshin nga ëmbëltoja e Koci Bakos, herë nga prefektura për të mësuar lajmet e furdit që vinin nga Tirana.

Administrata atë ditë nuk punonte fare, pjesa më e madhe e dyqaneve ishin mbyllur, nxënësit i kishin lënë mësimet dhe as që venin në shkollë, silleshin nëpër rrugët e qytetit dhe prisnin me ankth se ç'do të bëhej.

Ditën e tretë, si e panë që nga qeveritarët e vendit nuk mund të prisnin më asnjë ndihmë, zgjodhën një Komitet Revolucionar për Shpëtimin e Atdheut. Profesori i edukatës morale u zgjodh me një zë si kryetar i tij.

Dhe ai iu përvesh menjëherë punës. Te sheshi përpara prefekturës vunë një tryezë dhe filluan të regjistronin vullnetarë. Ziente vendi nga të shtyrat dhe zërat e atyre, që donin të shkruheshin. Pjesa më e madhe e tyre qenë të rinj dhe nuk dinin të përdornin armë. Atëherë sollën disa dyfeqe dhe revole të vjetra dhe që të gjithë u nisën për nga Fusha e Skënderbeut për t'u stërvitur.

Gjatë kësaj kohe, me anë të radios, u shpërnda një proklamata shumë e rëndësishme. Mbreti i të gjithë shqiptarëve i bënte thirrje popullit të tij për t'u bërë gati kundër rrezikut që po kërcënonte vendin.

Më në fund do t'u jepnin armë dhe automjete për t'i dalë përpara armikut.

Por nuk kaloi as një ditë dhe u përhap

një lajm edhe më i kobshëm. Gjatë natës, mbreti bashkë me oborrin dhe tërë qeverinë me një karvan veturash dhe kamionësh kishin lënë Shqipërinë dhe nga ana e Bilishtit qenë futur në Greqi.

Të nesërmen në mëngjes, më shtatë prill, Italia fashiste bëri përpjekjen e parë për të zbarkuar në tri pika të tokës shqiptare. Qindra vapore luftarakë dhe anije zbarkuese u drejtuan për në Durrës, Sarandë dhe Shëngjin.

Atë ditë në Fushën e Skënderbeut u bë rrëmujë. Vullnetarët s'dinin se ç'të bënin.

Atëherë profesori, i mallëngjyer nga ç'shikonte përpara, u tha:

— Mos u dëshpëroni, djema. Shqipëria ka kaluar çaste edhe më të vështira se këto. Shqiptarët mundën t'u bënin ballë romakëve. Me Skënderbeun në krye ata mundën Turqinë, që qe tmerri i botës së atëhershme. Edhe tani nuk do ta lëmë atdheun në duart e të huajve. Por kjo gjë duhet bërë në mënyrë të organizuar, duhet të bashkojmë gjithë popullin, ta furnizojmë me armë, me ide të reja dhe atëherë që të gjithë do të ngrihemi si një grusht i vetëm, do t'i hidhemi përsipër armikut dhe do ta asgjësojmë, cilidoqoftë ai, dhe do ta çlirojmë Shqipërinë dhe popullin shqiptar një herë e përgjithmonë edhe nga

shtypja e jashtme, edhe nga ajo e afendikonjve dhe e bejlerëve tanë.

Këto fjalë sikur i qetësuan vullnetarët. Kokulur e të dëshpëruar në kulm ata një nga një u shpërndanë. E ardhmja e atdheut dukej shumë e zymtë dhe e pasigurt. S'kishte zemër shqiptari që të mos qante ato ditë.

X

Italianët e parë arritën në Korçë pas dy ditësh me motoçikleta dhe kamionë. Disa kishin shapka me pendë, këmishë të zeza dhe një ujk qëndisur në mëngët e rrobave të tyre. Ata rrinin si të ngrirë nëpër karrocëritë me pushkë në dorë dhe ngjisnin më tepër si ushtarë të hekurt.

Njerëzit qëndronin për pak anë rrugëve, sa u hidhnin një sy të zemëruar e me nofulla të kyçura.

Gjatë këtyre ditëve Sotiri sikur nuk ishte në vete. Qe aq i tronditur, saqë nuk i vente

mendja as për bukë, as për gjumë. Ai u hodh disa herë nga ëmbëltorja e Koci Bakos për të mësuar të rejtat apo për të dëgjuar radion. Por çfarë do të mësonte më tepër, italianët kishin ardhur tanimë në Korçë, kurse Fuqitë e Mëdha, prej të cilave prisnin tani shpëtimin, kishin bërë vetëm nga një deklaratë të thatë që nuk e njihnin hyrjen e Italisë në Shqipëri.

Çdo ditë jepeshin urdhra të njëpasnjëshëm për të filluar jetën e përditshme normale, sepse hyrja e italianëve në Shqipëri nuk ishte pushtim, por një bashkim midis të dy vendeve, ashtu si pati qenë në kohën e Perandorisë Romake.

Këto i trumbetonin tani pa ndërprerje me anë të radios, altoparlantëve, gazetave, të cilat kishin filluar të dilnin dhe i shpërndanin gratis.

Sotiri hynte e dilte nga shtëpia si i hutuar, pa rregull, pa orë të caktuar.

Teto Sofika, kur e shikonte që vinte në dhomën e tij, menjëherë ngjitej sipër.

— Mos u bëj merak, xhan i tetos, mos u bëj merak. Për këtë më pyet mua ti?! Në këtë tokë kanë ardhur edhe turq, edhe grekë, edhe serbë, por të gjithë, ashtu si kanë ardhur, edhe kanë shkuar, bile edhe më keq! Se kjo tokë është e shenjtë dhe s'i duron të huajt, xhan i tetos!

— Ndryshe, ndryshe ishte atëherë, — ia priste fjalën i dëshpëruar Sotiri, — ndryshe është tani, teto. Këta janë më të djallëzuar,

më dinakë dhe ja, që në fillim kanë zënë të na mashtrojnë, me bashkim dhe me gjëra të tjera. Ata thonë se do të na lënë të lirë, se tani do të ketë punë për të gjithë, se do të ndërtojnë vepra të mëdha, se do të zhvillohet tregtia, se do të hapin shkolla edhe më shumë dhe studentet do t'i dërgojnë të mbarojnë shkollat e larta në Itali... të gjitha këto ata në fillim do t'i bëjnë, sa të na vënë në gjumë.

— S'e di, s'e di! Po ti mos u bëj merak! A ke ngrënë gjëkafshë, mor bir?

— As më hahet, as më pihet. Më vjen të vras veten nga inati kur i shikoj se si krekosen nëpër rrugët e Korçës breshkamanët. Sikur janë në shtëpi të tyre. Dhe jo vetëm kaq, por kanë filluar të fishkëllejnë e të këndojnë, sikur kanë bërë ndonjë trimëri të madhe dhe s'duan t'ia dinë.

— Hë, kështu është kjo dynja, ka ditë të mira, ka edhe ditë të vështira. Por njeriu kurrë nuk duhet të dëshpërohet. Përkundrazi, xhan i tetos, njeriu duhet të jetë i fortë, që t'u bëjë ballë të gjithave, edhe të mirave, edhe të këqijave. Po ja më pyet mua, një grua plakë, me djalin dhe fëmijët në Amerikë, vetëm filli këtu, ç'më lypset jeta mua, më mirë të vdes, po unë rroj, se kam shpresë të shikoj edhe një herë Raqin tim, të shikoj fëmijët, pastaj të mbyll sytë e shikasur! — dhe rendte përposh për t'i bërë gjëkafshë djalit për të ngrënë.

Sotiri shtrihej në shtrat, mbulonte sytë

me të dy duart, sikur nuk donte të shikonte asgjë, të harrohej pak në vetvete, por edhe me sy mbyllur ai i shikonte italianët përpara përsëri, veshur me rroba elegante, sidomos oficerët, lyer flokët me brilantinë dhe kolonjë, duke ecur nëpër bulevardin kryesor të qytetit dhe duke biseduar me zë të lartë në gjuhën e tyre e duke qeshur me njëri-tjetrin me të madhe.

Dhe Sotiri zinte veshët, se ajo e qeshura e tyre sikur i shponte zemrën, sikur do ta marroste fare.

Ditën e tretë i erdhi që në mëngjes në shtëpi Maqoja e i tha se Liceu hapej përsëri dhe do të fillonin mësimet si më parë.

Sotiri iu përgjigj:

— Po me ç'sy e ç'faqe do të vemi tani në shkollë, o Maqo?

Shoku i tij rrinte kokulur dhe i menduar.

Sotiri vazhdoi:

— Apo s'ka gjë, dheu i Shqipërisë është prapë po ai dhe, edhe tani që e shkelën italianët!

Atëherë Maqoja ia ktheu:

— Ky dhe do t'ua hajë kokën, mos ki qeder!

— Ore, dheu asgjë s'mund t'u bëjë, ne në u përmendshim e bëfshim gjësendi! — tha Sotiri.

— Atë dua të them. Dhe këtë na bie barra ta kryejmë ne! — shtoi Maqoja.

Sotiri mori çantën dhe që të dy djemtë u nisën për në shkollë me ndjenja të trazuarra.

Liceu ishte po ai, nxënësit po ata që qenë edhe më parë, por tani sesi iu duk më i madh, më i ftohtë, kurse shokët e tij nuk guxonte t'i shikonte në sy, sikur kishte bërë ndonjë faj.

Një hije e zezë i kishte pllakosur tani që të gjitha sendet që i rrethonin. Më parë u dukej sikur qeshnin edhe gurët e oborrit, edhe kanatet e portës së madhe, edhe shkallët, që i ngjitnin nga dy-tri menjëherë, edhe bankat ku rrinin, kurse tani qenë të tjera, ndryshe.

Studentët hynin nëpër klasat e tyre pa zhurmë dhe uleshin nëpër bankat me një lloj frike, sikur do të binte ndonjë tërmet e do t'i zinte brenda.

Në orën e dytë të mësimit hyri në klasën e tyre vetë drejtori me tre veta të panjohur pas. Ata qëndruan prapa katedrës, por nuk u ulën, dukej që nxitonin shumë.

Drejtori ishte tepër serioz. Ai i vështroi një herë të gjithë nxënësit me kujdes, sikur donte të zbulonte se a ishin që të tërë aty, pastaj rëndë-rëndë tha:

— Po vijmë së pari te ju, se jeni klasa e fundit, dhe pastaj do të hyjmë edhe në klasat e tjera. Zotërinjtë janë përfaqësues të ministrisë dhe kanë ardhur nga Tirana. Dua t'ju lajmërojmë se mësimet do të vazhdojnë si më parë. Por ka mundësi që profesorët francezë të zëvendësohen së shpejti me profesorë italianë.

Atëherë disa nga studentët me një zë, midis të cilëve edhe Sotiri, thanë:

— Po të kishin pritur derisa të mbaronim të paktën ne! Edhe një semestër na mbetet!

Drejtori u vrenjt. Të dërguarit e ministrisë vetëm dëgjonin të heshtur.

— Këtë nuk e vendosëm ne, po qeveria, ministria, — dhe shikoi nga të dërguarit, — nga të cilat varemi dhe ato dinë se ç'bëjnë. Ju keni për detyrë vetëm të zbatoni ato që ju thonë dhe të mësoni lëndët që ju jepen. Që sot lëndët fillojnë rregullisht. Ju lutem tani nga ana ime të mbani qetësinë dhe rregullin që të mos i shkaktoni telashe shkollës dhe vetes suaj! Kaq kisha për të thënë! — dhe bëri të dilte, po se ç'iu kujtua dhe qëndroi, u kthye nga Sotiri dhe tha: — Ki kujdes sidomos ti, Demiri!

Pastaj që të katër dolën përjashta me nxitim, ashtu siç kishin ardhur.

Sotirit sytë i lëshuan xixa.

XI

Brenda një kohe të shkurtër Korça u mbush plot me ushtarë italianë. Ngado që të vërtitje sytë, do të shikoje karabinierë, këmishëzinj, bersalierë e çfarëdo përfaqësues ushtarakë që të doje. Pastaj civilë të ndryshëm, që qenë edhe më të rrezikshëm se të parët. Nëpër kafenetë, ëmbëltoret, restorantet do të takoje më shumë italianë ose më mirë vetëm ata dalloheshin se flisnin me zë të lartë dhe bënin aq zhurmë, saqë shqiptarët, të cilët flisnin me ngadalë, nuk shquheshin fare. Bile edhe nëpër kinematë nuk gjeje dot vend nga ushtarët italianë, të cilët radhiteshin dy nga

dy përpara sporteve dhe prisnin me orë të tëra.

Mbrëmjeve bulevardi i Korçës gjallërohej edhe më tepër. Ai mbushej dinga me italianë të pispillosur, të cilët shëtisnin poshtë e përpjetë duke ngacmuar njëri-tjetrin me fjalë.

Vajzat korçare zunë të mos dilnin bulevardit siç e kishin zakon më parë. Edhe djemtë e ndërruan vendin e shëtitjeve dhe të mbledhjeve të tyre.

Studentët e Liceut që qenë bukuria më e madhe e Korçës deri atëherë dhe dalloheshin ngado tani nuk shquheshin fare. Por edhe Liceu vetë sikur që rrëgjuar dhe s'kishte më atë rëndësinë e parë. Studentët venin e vinin në Lice të heshtur e të menduar.

Erdhën dhe profesorët italianë, të cilët do të zëvendësonin ata francezë.

Atëherë studentët u bënë pikë e vrer. Do të ndaheshin nga profesorët e tyre, të cilët i kishin mësuar dhe edukuar kaq vjet me radhë.

Ditën e fundit profesorët francezë kaluan klasë më klasë, para se të niseshin. Erdhi në klasën e filozofisë edhe Bajiu. Ai që tepër i tronditur, sytë i kishte të njomë, gati-gati për të qarë.

— Studentë të mi, pesë vjet kam që po jetoj në mes tuaj. Në fillim e kisha shumë vështirë dhe mezi u mësova në këtë ambient. Por më vonë mora vesh se ju këtu keni tradita dhe virtyte, për të cilat mund t'ju ketë zili çdo komb, që e heq veten të civilizuar.

Unë do t'ju them vetëm një gjë dhe këtë dua ta mbani mend, se fashizmi këtu do ta ketë jetën të shkurtër dhe lirinë ju prapë do ta filoni!

Studentët po e dëgjonin gojëhapur. Atyre u vinte të thërrisnin, ta zinin për dore e ta përgëzonin për ato fjalë të guximshme e shprehëdhënëse që po u thoshte.

Po ai prapë vazhdoi:

— Tani, djema, unë do t'ju lë shëndet dhe pa zhurmë e pa fjalë, që të mos shkaktojme ndonjë të papritur, sidomos për ju. Ju kam si djemtë e mi dhe nuk dua t'ju gjejë ndonjë e keqe.

Dhe doli nga klasa duke fshehur fytyrën nga sytë e nxënësve të tij.

Vendin e Bajiut në klasën e filozofisë e zuri menjëherë profesor Rikardoja, një italian i shkurtër e i ngjallmë, shumë llafazan. Ai, me të hyrë në dhomë, u tregoi studentëve biografinë e tij, sikur ai e kishte vendosur fashizmin në Itali.

— Unë jam njëri nga ata që marshuan me Duçen për në Romë. Pastaj kam luftuar në Afrikë dhe jo vetëm kundër afrikanëve, por me këto duar kam vrrarë dhe luanë!

Me ardhjen e profesorëve italianë ndryshoi dhe tërë rregulli i shkollës. Plotegeri, mësuesi i gjimnastikës, filloi menjëherë t'u mësonte nxënësve «il passo romano»¹). Ditë për ditë ai i nxirrte studentët në oborrin e

1. hapi roman

shkollës apo i shpinte në fushën e sportit për të mësuar hapin romak.

Plotegeri e kuptonte që ata talleshin me të dhe fillonte t'i qortonte:

— Dio mio, dove mi hanno portato! Ero meglia a Bengasi tra gli africani, essi purtroppo ci ascoltavano! — dhe me inat shtonte: — Cominciamo di nuovo!¹⁾

Studentët kështu ca e nga ca zunë t'u kundërshtonin urdhrave të italianëve. Sa qenë të mpirë në fillim dhe si të trullorur nga të gjitha ç'kishin ngjarë, aq më të vetëdijsëm e të vendosur bëheshin me kalimin e kohës.

Kështu filloi rezistenca e tyre në mënyrë spontane. por ajo binte në shpirtrat e tyre të njoma si në ndonjë tokë pjellore, zinte rrënjë, ngallonte, forcohej dhe hidhte bojë menjëherë.

Studentët e klasave më të larta, sidomos ata të filozofisë, e morën veten shpejt dhe filluan të vepronin edhe në mënyrë të organizuar, në vend që të ngriheshin në këmbë, në shenjë nderimi, rrinin ulur nëpër bankat dhe përplasin këmbët në dysheme.

Kjo mospërfillje i tërbonte profesorët italianë, por s'mundnin t'i ndëshkonin, se nuk e bënë këtë një e dy, por gjithë klasa.

Atëherë profesori dilte përjashta në shenjë proteste dhe kaq.

1. O zot, o perëndi, ku më kanë sjellë; Më mirë qeshë në Bengazi tek afrikanët, ata të paktën më dëgjonin! Fillojmë përsëri!

Rezistenca e studentëve arriti kulmin, kur italianët deshën të futnin në Lice «il saluto romano»¹).

Këtë detyrë të rëndësishme e mori përsipër profesor Rikardoja si fashist i vjetër që ishte. Hyri një ditë në klasën e filozofisë dhe që nga dera i përshëndeti nxënësit duke ngritur dorën përpjetë.

Pastaj që nga katedra, pa u ulur, u shpjegoi:

— Kjo është përshëndetja që futi në veprim Duçja ynë, një përshëndetje, sa e bukur, aq dhe fisnike. Se kjo përshëndetje tregon lindjen e diellit, domethënë lindjen e botës së re, të rendit të ri fashist, që krijoi me mençurinë e tij të rrallë dhe me guximin e paparë deri më sot prej ndonjë burri shteti, condotieri²) ynë i madh.

Studentët po e dëgjonin me një buzëqeshje tallëse, se të gjitha lëvizjet që bënte ky shkurtabiq qenë të tilla. Trashaman dhe me duar të plota ai dukej si ndonjë dordolec që e kanë vënë në mes të arës për të trembur zogjtë.

Profesor Rikardoja i bënte të tëra këto me gjithë mend dhe nuk tallej aspak.

— Dil ti, Sotir Demiri, t'u tregosh shoqëve të tu se si bëhet «il saluto romano».

Sotiri, i cili gjer atëherë qeshte me profesorin italian, u zbeh në fytyrë. Nuk e pris-

1. përshëndetjen romake
2. udhëheqësi

te kurrë një gjë të tillë dhe s'dinte se ç'të bënte.

Tërë klasa qëndronte si e ngrirë nëpër bankat. Të gjithë studentët i ngulën sytë nga banka e Sotirit, që rrinte bashkë me Maço Sahatçiun dhe prisnin në ankth se ç'do të ndodhte.

Profesori, si e pa që nuk po ngruhej, e nxiti përsëri:

— E, Demiri, alzati.¹⁾

Dhe Sotiri me të vërtetë u ngrit, por, i vrenjtur, ashtu siç ishte, tha:

— Nuk salutoj unë në mënyrë romake, se jam shqiptar!

Profesor Rikardoja nuk priste kurrë një përgjigje të tillë. Puliti sytë, sikur nuk e kishte kuptuar mirë, dhe përsëriti:

— Come? Come?²⁾

— Nuk salutoj unë në mënyrë romake, se jam shqiptar! — e kundërshtoi prapë Sotiri.

Atëherë Rikardoja thërriti si i tërbuar!

— Fuori! Fuori!³⁾

Dhe Sotiri me çap të vendosur kaloi midis bankave.

Si doli Sotini nga klasa, Rikardoja i ra dhe dy-tri herë dhomës poshtë e përpjetë, i nevrikosur, saqë dhe duart i dridheshin nga inati. Pastaj tha:

— Unë kisha dëgjuar diçka për të, por s'më besohej. Tani s'kam asnjë dyshim! —

1. Ngrehu.

2. Si? Si?

3. Jashtë! Jashtë!

Dhe prapë vazhdoi: — Po njerëz të tillë të pabindur dhe ngatërrestarë ka pasur gjithmonë dhe do të ketë. Vetëm rendi i ri do t'i edukojë, me ndëshkime, me burg, bile edhe me pushkatime. Se rendi i ri kërkon sakrifica që të arrihet. Por le të kthehemi prapë në përshëndetjen romake.

— Dil ti, Maqo Sahatçiu, t'u tregosh shokëve se si bëhet «il passo romano»! E more vesh apo jo?

Por edhe Maqoja nuk luajti nga vendi.

Atëherë profesor Rikardoja u çmend fare dhe bërtiti:

— Fuori, anche tu!¹⁾ Tani do të zbres në drejtori dhe do të shikoni ju se si kundërshtohet bërja e përshëndetjes romake!

Edhe Maqoja doli nga klasa dalëngadalë. Pas tij doli dhe Rikardoja e u kthye bashkë me drejtorin.

Nxënësit u ngritën më këmbë.

— Ç'janë këto gjëra që po bëhen këtu! Ku është parë që studentët tanë të mos kryejnë urdhrat e profesorëve?! Prandaj për mosbindje dhe për kryengritje karshi autoriteteve shkollorë Sotir Demiri dhe Maqo Sahatçiu do të zbohen nga Liceu për një vit!

Këto fjalë ranë si rrufe e papritur në klasë. Studentët u lahtarisen. Asnjë prej tyre nuk guxoi të thoshte as gjysmë fjale.

Drejtori vazhdoi:

1. Jashtë edhe ti!

— Dhe këtë do ta pësojnë të gjithë ata që do të ndjekin shembullin e tyre.

Dhe doli. Në korridor kaloi pranë Sotirit dhe Maqos pa i vështruar fare dhe zbriti në drejtori. Pastaj dërgoi sipër xha Nisin t'u thoshte se për aktin e tyre antiitalian qenë dëbuar nga Liceu.

XII

Sotiri u nda me Maqon tepër i dëshpëruar, por nuk vajti t'i lutej as drejtorit, as ndonjë profesori tjetër për të ndërhyrë. Shau një herë nëpër dhëmbë

Si do ta kuptonin të tjerët? Si do ta kuptonin shokët e tij? Po babai?

Me këto mendime arriti në shtëpinë e te-
to Sofikës.. Hyri në dhomën e tij, ku kishte kaluar një pjesë të mirë të jetës, ndofta atë më të bukurën, dhe e vështroi me mallëngjim. Ai tani do të ndahej edhe prej saj, edhe prej Korçës, edhe prej shokëve të ngushtë dhe ndjeu një zbrazëturë në vetvete.

Bëri gati plaçkat. Velenxat dhe librat i mblodhi deng. Dhe dhoma mbeti si e shkretë. Librat dhe rrobat i jepnin bukuri. Dhe i erdhi keq më shumë që po ndahej prej këtej. Pastaj dengun e la para derës, që të mos i prishte punë teto Sofikës, se plaka, me siguri, pas ikjes së tij, do t'ia lëshonte me qira ndonjë djali që mësonte në Korçë për të marrë ndonjë lekë sa për të jetuar.

Si i bëri të gjitha gati, u hodh në të ndarën e shokut më të vjetër.

— Vaskë, — iu lut Sotiri, — a mund të vish pak në dhomën time?

Vaska u ngrit menjëherë nga tryeza ku po lexonte diçka dhe e ndoqi prapa. Kur hyri në dhomën e Sotirit, i bëri përshtypje çrregullimi që mbretëronte atje. Nuk iu durua dhe e pyeti:

— Ç'janë këto, Sotir? Apo ke vendosur të pastrosh dhomën?

— Jo, Vaskë, jo! Sot bashkë me Maqo Sahatçiun na dëbuan nga shkolla.

Dhe me disa fjalë ia shpjegoi shkaku.

Vaska po e dëgjonte si i ngrirë. Nuk dinte ç't'i thoshte. Ai që gjithmonë e këshillonte për kryengritje mbeti si memec përpara këtyre fjalëve.

Një copë letër që mbante në dorë zuri ta bënte copë-copë në mënyrë të pavetëdijshme dhe po e hidhte në dysHEME, sikur të ishte në rrugë.

Edhe Sotiri heshte. Në dhomë pllakosi një qetësi rrëqethëse.

Sotiri e kuptoi që shoku i tij më i vjetër nuk e justifikonte veprimin e tij dhe nuk e kishte kuptuar ashtu si duhej.

Të lutem të lajmërosh shokët e tjerë për këtë! — shtoi Sotiri.

— Do t'i lajmëroj! Medoemos do t'i lajmëroj!

— Tani e tutje ti do t'i mbash lidhjet me mua. Për çdo gjë unë do të të lajmëroj. Por dhe ti hidhu ngandonjëherë këtej. Në mos më gjetsh mua, shko andej nga Petroja.

— Falemnderit! Falemnderit! — përsëriste Sotiri.

Në këto e sipër erdhi dhe teto Sofika. Ajo si gjithnjë hyri drejt e në dhomë, nuk vuri re asgjë, se edhe nga sytë s'para shikonte, dhe i pyeti djemtë:

— Po ju pse rrini kështu të menduar, sikur ju janë mbytur gjemitë?

As Vaska, as Sotiri nuk iu përgjigjën.

— Po thumëni, de, ç'keni, mos më lini në këtë merak?

Atëherë Vaska ia shpjegoi.

Plaka menjëherë zuri të mallkonte:

— Pika u rëntë që të gjithëve, të gjithëve, që na sollën në këtë derexhe! Që po na marrin më qafë djemtë, — dhe si e zuri Sotirin për dore, vazhdoi: — Mor bir, po i bihet murit me kokë! Këta janë të shkalluar, mor bir! Këta nuk kanë insar, as perëndi!

Sotiri e dëgjonte dhe fjalët e saj e shpoin si me gjilpërë në zemër. Atij i dukej si-

kur ajo donte t'i thoshte: «Po tani si do t'i thuash tyt eti? Zikes së gjorë?»

Ja kështu u nis Sotiri, i brengosur dhe më këmbë. Po e linte Korçën me zemër të përvëluar dhe ecte me nxitim, me mendjen në fshat, tek i ati, te fshatarët. Si do t'u thoshte që e kishin dëbuar nga shkolla?

Një zë i fortë, në gjuhë të huaj, e solli në vete!

— O, la, dove vai cosi?!

Sotiri u përgjigj:

— Po vete në Thikës!

— Va bene! — ia ktheu italiani.

Edhe te kulla e Qarrit, në majë të malit, Sotirin e ndaluan dy xhandarë, që po bënë rojë bashkë me dy karabinierë italianë. Por pyetjet edhe këtu i bënë të huajt dhe jo vendësit siç pretendohej nga të përditshmet dhe nga fjalët e qeveritarëve që kishin ardhur në fuqi.

— Nga je ti? — e pyeti ashpër një nga karabinierët.

— Nga Thikësi!

— I kujt je? — e vazhdoi hetimin xhandari shqiptar:

— I Xel Demirit!

Atëherë xhandari u kthye për nga karabinieri italian dhe seç i tha me zë të ulët. Pastaj u dëgjua.

— E njoh, e njoh, burrë i mirë është.

— Hajde, shko! — e urdhëroi italiani.

1. Hej, ti, ku po vete kështu?

Si u largua pak prej tyre, Sotiri tha me zemërim:

— Mor po këta të poshtër e paskan kthyer tërë vendin në një burg!

Në fshat nuk hyri ditën. Nuk donte ta shikonin fshatarët para se të takohej me të atin. Për herë të parë po hynte në Thikës si hajdut. Qentë lehnin herë të egërsuar e herë të qetë.

Sotiri qëndroi përpara portës dhe trokiti dy herë.

Nga brenda u dëgjua zëri i të atit:

— Kush është?

— Unë, unë jam, Sotiri.

U dëgjua një zhurmë nëpër shkallë dhe te dera u shfaqën menjëherë Xeli dhe Zikja. E përqaftuan djalin dhe hynë te soba ku rrinin zakonisht. U ulën si gjithnjë, babai nga ana e djathtë e gllanikut, nëna nga ana e majtë dhe Sotiri në mes të tyre.

— E po si kështu, ne s'të prisnim të na vije kaq shpejt? — e pyeti i qetë i ati.

— Mirë bëre, xhan i tetos, se që kur erdhi mandata e vrasjes së djalit të Nashos nga italianët në Durrës, gjithë te ti e kisha mendjen. Pa dhe djemtë e tjerë s'kanë ardhur akoma nga ushtria, — e ndërpreu ajo.

E zuri për dore dhe e vështroi me mall. Tërë ajo brenga që rëndonte në shpirt sesi iu zhduk.

Xeli kyçi vetullat nga fjalët e së shoqes. Dhe, vetëm sa për të këmbyer muhabetin, tha:

— Po ç'kemi andej nga Korça, mor bir?

— Italianë, baba, italianë sa t'i gërryesh me lopatë! — iu përgjigj me inat dhe i dëshpëruar Sotiri për të mësuar mendimin e babait të tij për ngjarjet e fundit.

— Edhe këtu në fshat na sollën dy italianë në postëkomandë.

— Kështu është kudo, baba, që nga Korça e gjer këtu, plot me italianë është mbushur vendi.

— Mor po ne e dimë se sa të fortë janë këta italianët, se ua kemi pirë lëngun që në Luftën e Parë, por edhe shumë janë të mallkuarit! — vazhdoi Xeli duke tundur kryet.

— Thonë se do të sjellin dhe familje, burra dhe gra! — shtoi Zikja.

— Po të sjellin dhe familje, vaj medet, se është i madh. Sa njerëz bëhen? — e pyeti ai Sotirin.

— Nja dyzet milionë!

— I lëmë këto tani, — tha papritur Xeli dhe shtoi: — Po me mësimet si vete, mor bir?

Kjo pyetje e zuri Sotirin ngushtë. Ç't'i thoshte të atit tani? Psherëtiu një herë thellë dhe pastaj u përgjigj.

— Më dëbuan nga shkolla, se kundërshtova të përsëhendes në mënyrë fashiste me dorën përpjetë.

Xeli dhe Zikja po e dëgjonin me sy të çakërritur, të trembur e të habitur. Dhe ki-

shte në shikimet e tyre edhe turp, edhe zemërim, edhe urrejtje.

Një heshtje rrëqethëse ra në dhomën e Demirëve. Sotiri priste me padurim përgjigjen e të atit, kurse Zikja rrinte e trembur anës gllanikut. Ajo e dinte se sa i rreptë që i shoqi dhe se me sa qejf e kishte dërguar për të mësuar. Kushedi se ç'do të bënte tani. Edhe mund ta rrihte. Dhe u mblodh për një çast kruspull nga frika dhe u habit kur dëgjoi të shoqin:

— Në humbëm Shqipërinë! Ç'na lypset shkolla neve tani. Mirë ke bërë, mor bir!

Atëherë Sotiri kërceu nga vendi dhe iu hodh të atit në qafë duke përsëritur:

— Unë e dija, baba, që ti do të më kuptoje! Unë e dija, baba, që ti do të më kuptoje! — dhe lot i rrodhën nga sytë.

Por i ati nuk e la gjatë ta përqafonte. I hoqi duart nga qafa e tij dhe i tha:

— Tani edhe të parët e fshatit edhe postëkomanda do ta shikojnë me sy të keq. Çdo gjë duhet bërë me mend. Hëpërhë nuk do të thuash se të kanë dëbuar nga shkolla, por ke ardhur në shtëpi me pushime.

— Mirë thua, baba!

Dhe prapë që krenar për atin, i cili jo vetëm që e kishte kuptuar, por tani e mësonte dhe se si të vepronte.

Dhe që atë natë në shtëpinë e Demirëve, bashkë me ardhjen e Sotirit, hyri dhe shqetësimi.

XIII

Këtë radhë Sotiri nuk doli menjëherë nga dyqani i Markos, nuk priti as vërsnikët e tij të vinin ta shikonin, por u nis për nga Vangjeli i Nastës.

Në rrugë takoi Dhosin e Maros. Po shpinte ca drithë për të bluar në mulli. Që kur Xeli kishte marrë anën e tij kur kishte ardhur taksidari për të mbledhur taksat e Thikësit, ai i ndiente Demirët si miq të vërtetë dhe, me të parë Sotirin, u ndal dhe e përshëndeti:

— E po mirë se na erdhe, mor djalë. Qëkur kështu në fshat?

— Mbrëmë erdha.

Dhosi atëherë iu afrua Sotirit, u përku
nga ai dhe ngadalë pëshpëriti:

— Mos ke dëgjuar gjësendi andej nga
Korça, se këtu flitet se gjoja labët u kanë
kthyer pushkën italianëve?

— Nuk kam dëgjuar gjësendi për këtë,
po derisa flitet, ashtu do të jetë, se, si i tho
në fjalës, s'ka vdekje pa sebeb!

— Ore, dhe ne duhet të bëjmë si ata, por
s'ka se kush të na mësojë se ç'të bëjmë! Se
këta të parët tanë këtu, të cilët prisnin të na
udhëhiqnin, e di si thonë: «Të presim, të
presim se ç'do të bëjnë Inglizi me Frëngun,
se ne jemi popull i vogël dhe asgjë vetëm
s'mund të bëjmë!»

— Kështu thoshin ata dhe gjatë Rilindjes,
por populli mendonte ndryshe dhe ia dhanë
dërrmën halldupit, që ishte edhe më i egër
nga breshkamani! — iu përgjigj Sotiri.

— E, ashtu të lumtë goja, de! — dhe
shtoi: — Ju Demirët jeni të guximshëm, s'i
harroj dot ato fjalët e babait tënd, që i tha
atëherë taksidarit. Po pate nevojë për mua,
më thërrit se këtu më ke! — tha Dhosi dhe
i ra gomarit përpara.

Sotiri vazhdoi rrugën. Dhosi sikur e ki
shte zgjuar nga ndonjë gjumë i rëndë, e
kishte tundur e shkundur nga rrënjët dhe, du
ke ecur. thoshte me vete: «E, popull, popull!»
dhe, me këto fjalë në gojë, u gjend përpara
portës së Nastës. Trokiti.

Pas pak te porta u duk vetë Vangjeli dhe

kur pa Sotirin iu hodh në qafë duke i thënë:
— O, sa mirë që na paske ardhur! O, sa mirë! Po qëkur kështu? Ne s'kemi marrë vesh asgjë!

— Mbrëmë erdha.

— Hajde, hajde brenda! — e ftoi ai.

Dhe që të dy djemtë, zënë krah për krah, u futën te soba e Nastës.

— Po ç'kemi këtej nga fshati, o Vangjel?
— pyeti ai.

— Ç'të kemi?! Përveç dy karabinierëve italianë që na kanë ardhur këto ditë në fshat, asgjë të re s'kemi!

Sotiri papritur e ndërpreu!

— Po shoqëria e futbollit si vete?

Vangjeli u habit nga pyetja e shokut të tij. Me vete tha: «Kësaj i thonë «Stambolli digjet, kurva krihet!» dhe me zë vazhdoi:

— Ka kohë që kemi hequr dorë prej tij. Në fillim e kishim me qejf të madh, por pastaj e lamë. Të të them të drejtën e lamë edhe sepse u zumë me Muço Thekrën, rojen e Sefer Beut. Nuk donte ta bënim fushën te kodra sipër, gjoja ato vende qenkan të beut. Por tani s'jemi më për futboll, o Sotir. Do të qeshin me ne tërë fshatrat rreth e rrotull!

— Nuk është ashtu, ne duhet t'i mbledhim që të gjithë shokët bashkë në një vend, se vetëm kështu mund t'i bëjmë ballë armikut. Përveç kësaj kjo do të jetë dhe një mënyrë e maskuar organizimi. Se si do të të lërë përndryshe armiku të vepros, po ta dijë se ti organizohesh kundër tij? — ia ktheu Sotiri.

Vangjeli po e dëgjonte me gojë hapur. Pas-taj tha:

— Mirë e ke gjetur, Sotir, neve kurrë nuk do të na vinte ndër mend një gjë e tillë. Futbollin e ka Minai i Cingos!

— Atëherë i thuaj Minait ta bëjë gati dhe të gjithë djemtë e fshatit të mblidhemi të dielën te fusha e futbollit.

— Hë, ata atë presin, që të gjithë do të vijnë!

Në këtë kohë hyri Nasta me dy filxhanë kafe, vendosur në një dhisk të bardhë.

— Urdhëro! — dhe, si mori Sotiri kafenë, e pyeti: — Po Zikja si është? Kushedi sa u gëzua kur të pa?

— E po, nënë është, u gëzua me të vërtetë se nuk më kishte parë, kishte kohë. Që para se të hynin italianët.

— Perëndia e shoftë. Malli i nënës është pa kufi! — e ndërpreu, sikur i thoshte këto fjalë jo për Ziken, po për veten e saj.

Si piu kafënë, Sotiri u ngrit dhe u nda nga Nasta dhe nga shoku i tij duke thënë.

— Të dielën atëherë të gjithë djemuria në fushën e futbollit.

Dhe me të vërtetë të dielën qëmenatë djemtë e Thikësit u gjendën që të gjithë te fusha e futbollit.

Minai mbante topin në dorë dhe ishte krenar. Kurse Sotiri po vërtiste një bilbil nëpër dorë, me të cilin do të referonte ndeshjen. Të gjithë të tjerët që i rrinin prapa, e shikonin me një lloj admiringimi, sepse ishte më

i mësuar nga të tërë, por edhe që kujtuar për të riorganizuar përsëri shoqërinë e futbollit. Që të gjithë prisnin si do të ndaheshin dhe cilët do të qenë ata që do të kishin fatin të loznin, se qenë më tepër se njëzet e dy veta, sa duheshin për lojën e futbollit.

Sotiri tha:

— Pörtat qenkan mirë. Vërtet se nuk kanë shtylla, por gurët e tregojnë qartë vendin e tyre.

Djemtë filluan të zhvisheshin se të tërëve ua kishte ënda të loznin.

Sotiri vazhdoi:

— Zhvishuni, zhvishuni, s'ka gjë, se koha është e mirë dhe le t'ju pjekë dielli.

Sotiri dha shenjën me bilbilin e tij. Topi zuri të vërtitej herë këtej, e herë andej.

Ata që kishin mbetur jashtë fushës së futbollit bënëin zhurmë edhe më të madhe. Herë i thërrisnin me emër ndonjë lojtari që i afrohej portës për të bërë gol, herë heshtnin, bile edhe frymë nuk merrnin kur rrezikohej porta e atyre që ata donin të fitonin.

Po loja e parë kaloi pa u bërë asnjë gol.

Që të gjithë pastaj u mblodhën tog atje ku qenë zhveshur dhe u ulën të çlodheshin për dhjetë-pesëmbëdhjetë minuta.

Fusha e futbollit shtrihej në një shesh të bukur përmbi kodrën e Shëngjergjit. Që andej dukej tërë fshat, si ndonjë amfiteatër i vjetër, me shtëpitë e gurta, me lëmenjtë për-anës shtruar me pllaka dhe plevicat përpara.

Pastaj vinin brigjet dhe luginat, që shtrihe-
shin poshtë, lumenjtë që gjarpëronin dhe sy-
ri arrinte pastaj që nga mali i Gramozit e
gjer tutje në Nemërçkë. Nga e djathta dukej
mali i Rodomit, Malet e Zez dhe Qarri dhe
tërë pellgu i Kolonjës mbyllej brenda këtij
rrethi si në ndonjë kafaz. Fshatrat që kishin
zënë vend rreth tyre, si fole zogjsh, shquhe-
shin një këtu, një atje tej, afër njëri-tjetrit
sikur ishin zënë për dore. Në mes tyre dukej
Erseka, qytet i vogël, që i tërhiqte më tepër
fshatrat me pazarin që bëhej atje çdo të mër-
kurë.

Siç rrinin e shikonin kështu pa qëllim Mi-
nai u hodh e tha:

— Vend të bukur kemi, besa! Ja, shikoni
Luarasin përtej në kurrizin e malit! Ja dhe
Vodica më të majtë, fshehur në mes të pe-
mëve.

Sotiri atëherë tha serioz:

— Që kur erdhën italianët, sikur u zhduk
dhe bukuria. Njeriu e shikon, e shikon dhe
me të vërtetë që e gjen të bukur, se është
vendi yt, por, po të mendohesh pak, dhe bu-
kuria e tij zhduket, se të del përpara syve
i huaji.

— Vërtet ashtu është, kur veja në çezmë
më parë, fishkëlleja, po, që kur erdhën ita-
lianët në fshat, s'më fishkëllehet, — shtoi
Ndreçi.

— Ti përzëmë që këtu, ç'deshën ata në
vendin tonë! shau një nga të vegjlit.

— S'i përzëmë dot se janë shumë! — ia priti Lipja i Markos.

— Mor s'na dhanë pushkë, pa, po të na kishin dhënë, ata s'do të qerë tani fare këtu! — e kundërshtoi Ndreçi.

Sotiri shtoi:

— Fajin e ka mbreti që iku dhe tradhtarët e vendit.

— Ore, ne u harruam me llafe dhe ora kaloi. Hajde të fillojmë lojën! — shtoi Sotiri.

Dhe që të gjithë djemtë kërcyen në këmbë. U ndërruan vetëm rja katër a pesë nga ata që kishin luajtur në pjesën e parë dhe loja filloi përsëri.

Por nuk kishin kaluar as pesë minuta, kur nga kodra sipër u dëgjua një zë i fortë:

— E ç'bëni atje, qerratenj! Daleni! Daleni!

Djemtë e lanë lodrën dhe kthyen sytë për të parë se kush po u kanosej kështu. Dhe panë rojën e Sefer beut me pushkë krahëve, që vinte përposh duke e hedhur çapin me nxitim dhe i krekosur.

Sotiri i porositi shokët:

— Mos lozni nga vendi, pa do t'ia ndreqim qejfin këtë radhë Muço Thekrës!

Roja pandehte se, me të dëgjuar zërin e tij, djemtë do të zhdukeshin si tjetër herë. Por, kur e pa që ata nuk po loznin nga vendi, zuri përsëri t'u thërriste:

— Daleni, daleni, pa do ta shihni se ç'kam

për t'ju bërë! — dhe u hoqi një të sharë
Po çapet sikur i ngadalësoi pak.

— Hajde, Muço, hajde, se kemi për të
larë hesape të vjetra me ty! — iu përgjigj
Sotiri.

Muçoja s'kishte se ç'të bënte. Që të mos
turpërohej, zbriti me rrëmbim poshtë te fu-
sha e futbollit dhe e shtyu të parin që i
doli përpara.

Atëherë Sotiri u thirri shokëve:

— A e shikoni se si sillen këta qen me
ne, me këmbë duan të na shtypin! — dhe iu
hodh Muços përsipër, e zuri për kondaku
dhe i përdrodhi rripin.

Por roja ishte i fortë dhe e shtyu.

Atëherë iu hodhën Vangjeli, Ndreçi, pas-
taj Minai. Roja humbi në mes tyre. Vetëm
zëri i tij dëgjohej:

— Ou, të marrë jeni, ç'bëni kështu, lë-
shomëni; lëshomëni, se do t'i them Sefer be-
ut!

Më në fund ai u shpëtoi nga duart dhe u
hodh mënjanë, mori dyfekun në dorë dhe
qëndroi kundrejt djemve.

Por edhe ata kishin qëndruar më këmbë,
grumbull, fitimtarë, po të përmbajtur.

Muçoja u kanosej:

— Do t'ju ndreq qejfin unë! Mos ma thë-
nçin emrin Muço Thekra! Do të shikoni!

Hodhi dyfekun në sup dhe bëri përpjetë
me bisht ndër shalë.

Sotiri tha si me të qeshur:

— E patë se ç'bën bashkimi? Tani hajdeni të vazhdojmë lojën.

Rrahja e Muço Thekrës, rojës së Sefer beut, i cili e kishte shtëpinë veçan larg fshatit, si ndonjë kështjellë më vete, bëri bujë të madhe edhe nëpër fshatrat përreth, se që të gjithë kishin ndezur prej atij burri të gjatë, me mustaqe gjer te veshi, i fortë, me malisher në dorë dhe me krahun e Sefer beut në komunë. Ai bënte si i donte qejfi, pa pasur frikën e askujt. Rrihte, gjobonte dhe, kur e takonin, fshatarët i bënë udhë, se e dinin që ishte sherrxhi dhe mund ta pinin më kot.

Burrat te dyqani i Markos nuk e lëshonin nga goja këtë ngjarje. Ajo sikur u jepte zemër dhe i harronin për një çast edhe ardhjen e italianëve dhe hallet e tyre.

— Dhe si the, o Vangjel? Thërriste, hë?
— qeshte Dhosi i Maros.

— Thërriste se hante grushte kurrizit!

— Hë, ashtu më ju lumtë dora, de, juve të rinjve! Se ashtu e duan ata, kokës, përndryshe kurrë s'do të na lënë të ngremë krye! — ia ndërpreu fjalën Dhosi.

— Kullota është sa e fshatit aq dhe e Sefer beut. Dhe s'ka të drejtë t'i përzërë djemtë nga kodra e Shëngjergjit! — shpjegoi xha Noxi.

Plaku qe kundër lojës së futbollit që kur doli ajo në fshat për herë të parë, por tani mba-

nte anën e fëmijëve dhe u thoshte djemve:

— Ashtu na mori beu edhe malin. Seftë nuk na linte të venim për dru, pastaj nxori tapi false dhe tani ua shet mot për mot vllëhëve dhe mbush xhepin me verdhushka, kurse ne s'kemi as ku të presim dru, as ku të kullosim bagëtinë, — vazhdoi ai.

— Atëherë ishte Turqi dhe ai bënte si i dorte qejfi, se kishte miq edhe në Ersekë, Korçë e Manastir, bile gjer në Stamboll.

— Ashtu është, mor djalë, — ia ktheu prapë xha Noxi, — por ne këtu jemi prapa botës dhe ata do të bëjnë gjithnjë si u do qejfi. Edhe kur ishte Turqia, Sefer beu ishte Sefer bej, edhe në kohën e Zogut, po ai i pari, ja, tani Sefer beun thonë se do ta bëjnë përsëri të madh, federal, a fiqeral, nuk di si ia thonë emrin, po në gjuhën tonë me siguri që kjo do të thotë bej.

— Bej, bej, po Muço Thekra e hëngri kopaçen pas bishtit. Hë, më u lumtë dora këtyre të rinjve, de! — përsëriti Dhosi i Maros.

Markoja i dëgjoi sa i dëgjoi prapa banakut dhe u thirri burrave:

— Ore, po llafe të tjera s'keni ju, po tërë me Muço Thekrën dhe me Sefer beun do të merreni. Mjaft, zini ndonjë muhabet tjetër, se mos kalojnë këtej dhe na bëjnë ndonjë të pabërë. Ta dini, Muçoja nuk do ta lërë pa e marrë hakun.

— Le ta provojë, pa do të shikojë se ç'do të pësojë prapë, — ia ktheu Sotiri.

Dhe me të vërtetë nuk kishte kaluar as një javë nga këto fjalë dhe Muço Thekrën e kishin parë disa herë të vërtitej nëpër fshat dhe sidomos nga shtëpia e Demirëve.

Ai nga ana e tij nuk i kishte thënë asnjë fjalë Sefer beut se ç'i kishte ngjarë me djemtë e Thikësit, se i vinte turp t'i tregonte të vërtetën, por do t'i thoshte si të merrte hakun dhe atëherë do t'i mburrej beut për ato që kishte bërë.

Një pasdreke vonë Muço Thekra kaloi nëpër fshat me kryet përpjete si ngaherë dhe qëndroi te dyqani i Markos. Pa një herë rreth e rrotull, si për të vëzhguar se mos e ndiqte njeri prapa, pastaj hyri brenda, u ul në një tryezë dhe menjëherë i thirri dyqanxhiut:

— Një raki rrushi, por nga ajo imja, o Marko!

— Si urdhëron! — iu përgjigj dyqanxhiu që prapa banakut dhe u ul përpara, mbushi një shishe të vogël nga damixhana dhe prej saj një kupë dhe ia shpuri myshteriut.

Ishte në atë kohë të ditës kur dyqani i Markos qe gjithnjë i qetë, burrat nuk ishin kthyer edhe nga puna, prandaj dyqani ishte si i shkretë.

— Zirxhirin e ka si rruaza, akoma nuk i ka shkuar që kur e hodha! — i tha Markoja duke i vënë kupën në tryezë.

Muçoja nuk iu përgjigj fjalëve të tij, por shtoi:

— Tani më sill dhe pak djathë, se kjo e flamosura dhe gojën time e përvëlon.

— Ja, tani, — ia ktheu Markoja dhe re-ndi përsëri prapa banakut, mori një copë djathë nga një qyp, e peshoi në pallanxë dhe ia shpuri.

Në dyqan ishin vetëm të dy dhe Markoja nuk donte të zinte muhabet me Muçon, se nga fjala në fjalë do të vinin te zënka e tij me djemtë e fshatit, prandaj u kthye prapa banakut dhe zuri të fshinte diçka.

Muçoja e pa një herë kupën, gëlltiti pë-shtymën, por, në vend që të pinte, theu një copë djathë dhe kafshoi. Pastaj, si e për-typi nëpër dhëmbë, i foli Markos:

— Mbushe edhe një herë!

— E kam rakinë të mirë!

— Rakinë e ke të mirë, po djathi pesë para s'të bën! — ia ndërpreu fjalën Muço-ja.

Markoja s'iu përgjigj. Ia mbushi kupën për-sëri dhe ia shpuri në tryezë.

Në atë kohë hynë në dyqan edhe dy udhëtarë të tjerë. Ishin dy burra nga Qafë-zezi, miq të ngushtë të Muço Thekës, i ci-li, me t'i parë, u ngrit, u përçafua me ta dhe i ftoi të uleshin në tryezën e tij. Pastaj menjëherë thirri:

— Marko, edhe dy kupa të tjera!

Dhe Markoja pa një pa dy mbushi ku-pat dhe ua shpuri myshterinjve të rinj.

Në këtë kohë hyri në dyqan nga dera prapa Talia dhe zuri t'i ndihmonte të atit për të fshirë e për të larë enët që ishin mbledhur në kazan.

Muços i qe zgjidhur goja nga rakia dhe flisite me zë të lartë, por ndofta donte edhe të mburrej.

— Zbrita këtu në Thikës për të qëruar një hesap. Para nja dy javësh më ngjau një grindje me këta djemtë e fshatit. Kanë një çamarrok këtu, që nuk i lë djemtë rehat, i mëson gjithë për keq.

— O, këta të rinjtë po tërbohen fare. Nga ata ndezëm edhe ne andej. I tërbuan gramët që mësojnë! — ia ktheu njëri prej tyre.

— Gramët, gramët e kanë fajin. Ne s'dinim dhe s'dimë as emrin të shkruajmë, por ishim dhe jemi të bindur, ashtu siç na mësonin hoxha dhe prifti, — shtoi tjetri.

Talia vuri vesh dhe e kuptoi se Muço Thekra e kishte fjalën për Sotirin.

— Ty, Muço të t'i bëjnë këto gjëra! Ty s'ta ha qeni shkopin! — ia kreu bishtin njëri prej tyre.

— Ata s'e njohin mirë siç duket se cili është Muço Thekra, — shtoi tjetri. — Për një dhjetë do të ma paguajë. Mezi i gjeta arallëkun. Kam ditë që po e vëzhgoj. Sot është vetëm andej nga arat e Mosinicës dhe do t'i heq një dru, që të më mbajë mend tërë jetën!

— Ashtu e duan ata, që t'u vijnë mendtë në kokë! — ia priti prapë një nga të riar-dhurit.

Talia, me të dëgjuar këto fjalë, e la punën dhe doli në oborr. Jashtë kishte filluar të errej. Ç'të bënte? Shikoi se mos ishte gjëkundi Lipja, por nuk e pa. Atëherë hodhi një shall në qafë dhe doli në rrugë. Po edhe atje s'gjeti ndonjë djalë, të cilit mund t'i hapte zemrën e ta dërgonte te Sotiri. Dhe, duke nxituar, bëri vetë për nga Mosinicat.

Fshatarë që ktheheshin nga puna, kur shikonin Talinë duke u sulur për poshtë, vetëm filli, e pyesnin:

— Për ku kështu, tani vonë, moj çupë?

— S'na është kthyer një kec dhe dola ta kërkoj një çikë! — ua kthente ajo.

— Mirë, mirë, po nxito se do të erret fare dhe nuk shikon dot! — e këshillonin ata.

Kur u afrua në Mosinicat, ajo e pa Sotirin që po ujiste akoma. Asnjëri nuk kishte më nëpër arat. Ajo ishte shumë e tronditur, por nuk guxonte të thërriste.

Më në fund pëshpëriti:

— Sotir! Sotir!

Në qetësinë e natës fjalët e saj tingëlluan si ndonjë jehonë e largët.

Sotiri e ndjeu zërin e saj dhe, me shatën në dorë ngriti kryet dhe mbanë arës dalloi Talinë.

— Sotir, hajde, hajde këtu! — dhe i bëri shenjë me dorë.

Sotiri e la punën dhe rendi për nga vajza që po e priste e trembur.

— Tali, — i tha ai, kur u afrua pranë, — më fal, se kam ditë që kam ardhur dhe s'të kam takuar. Por besomë, të kam kërkuar disa herë.

— Lëri, lëri këto tani!

Sotiri u prek nga përgjigjja e saj.

— Si e ke hallin që po flet kështu?

— Dëgjova Muço Thekrën që po fliste në dyqan me dy të njohur nga Qafëzezi. Ka vendosur sonte të të dalë përpara e të të rrahë. Mos u kthe në shtëpi nga udha e madhe, kthehu nga përroi, që të mos të shikojë!

— Faleminderit për të gjitha sa më the. Sa për Muçon, ai do të marrë sonte një mësim edhe më të mirë nga ai i kodrës së Shëngjergjit.

— Mos, Sotir, mos! Kam frikë për ty!

— zuri t'i lutej Talia.

— Të jap fjalën e nderit që unë asgjë s'do të bëj! — Sotiri u përkul për nga vajzaa dhe se ç'i tha në vesh, që e bëri Talinë të qeshte. Pastaj Sotiri vazhdoi: — Hajde, nxito tani dhe kthehu sa më shpejt në shtëpi.

Talia mezi e shkëputi dorën nga dora e tij dhe u largua. Sotiri ktheu menjëherë postatin, lau këmbët me ujë të pastër, u vesh, u mbath dhe rendi për nga kasollja që ki-

shin ngritur në një çip të arës dhe ku flinin kur arriheshin misrat.

Aty e priti Sotirin me të lehura të gëzuar. Baliku i tyre, qen i madh stani, i cili kushedi sa herë u kishte bërë ballë edhe ujqve.

— Hë, si vete, Balik? — e pyeti ai sikur e kuptonte qeni.

Eéééé! — zuri të skërmitëj i gëzuar Baliku, që po e shikonte të zotin e tij përpara.

— Na, Balik, ha! — e përkëdheli Sotiri dhe i hodhi një copë bukë që i kishte mbetur në torbë.

Baliku e hallaviti një copë herë nëpër dhëmbë dhe pastaj e kullufiti të tërë dhe prapë filloi: Eéééé!

Sotiri e zgjidhi atëherë zinxhirin nga zhgëryja ku e kishte lidhur dhe e hoqi qenin pas vetes.

Baliku u gëzua dhe më tepër dhe filloi të hiqte të zotin herë këtej, herë andej, por Sotiri iu kanos:

— Ngadalë, Balik! Ngadalë!

Dhe që të dy morën rrugën e madhe për t'u kthyer në fshat.

Ishte errur, por kishte dalë hëna. Tërë fusha kishte rënë në qetësi. Vetëm cinxërit dëgjoheshin nga të katër anët dhe zhurma monotone e lumit që rridhte.

Sotiri ecte e shikonte me kujdes rreth e përçark.

Ishte thuajse i sigurt që Muçoja do ta priste prapa shkëmbit, se atje udha bën një kthesë dhe vendi është i fshehtë.

— Ngadalë, ngadalë, xhan! Ngadalë se mos na dëgjojnë!

Dhe qeni sikur e mernte vesh të zotit dhe as lehte, as nuk tërhëqej pas zinxhirit.

Kur arritën afër shkëmbit, u duk një hije, e cila doli ngadalë dhe zuri udhën. Sa më tepër i afroheshin, aq më e madhe dhe më e qartë bëhej ajo, për Sotirin s'kishte asnjë dyshim se ai që Muço Thekra, dhe e lëshoi qenin duke e ndërsyer:

— O burra, Balik!

Qeni u derdh kundër hijes që kishte përpara.

Hija u duk që u kthye prapa dhe ua dha këmbëve. Por qeni ishte më i shpejtë.

— Oburra, Balik! Oburra! — e nxiti Sotiri.

Qeni sikur mernte guxim nga fjalët e të zotit dhe lehte akoma më shumë. Kurse hija herë sulej, herë qëndronte, i kanosej qenit, i binte me ndonjë gur dhe prapë ikte.

Kështu u largua mjaft nga Sotiri. Atëherë ai e ndolli qenin:

— Na, Balik, na!

Dhe qeni e la si me urdhër hijen që ndiqte dhe u kthye prapë tek i zoti.

Muçoja nuk donte ta tregonte veten se cili ishte dhe zuri të ngrihej përpjetë pa bërë zë.

— Dale, o Muço, dale!, — i thirri Sotiri Atëherë Muço Thekra qëndroi në vend dhe iu kanos:

— Këtë që më bëre sonte, s'do të ta fal kurrë, gjersa të jem i gjallë.

— Mirë, mirë, me atë mendje shko ti. Po do të qe më mirë të mendoja ndryshe, se dhe ti je fukara njeri, si ne të gjithë, dhe të mos bëhesh vegël dhe mashë e Sefer beut.

Po këtyre fjalëve Muço Thekra nuk iu përgjigj.

Sotiri e lidhi përsëri Balikun me zinxhir se mos hante ndonjë njeri tjetër dhe me të bashkë, si dy shokë të ngushtë, u kthyen në shtëpi.

XIV

Brenda një kohe të shkurtër shoqëria e futbollit u bë e njohur në tërë rrethin e Kolonjës. Në fushën e sportit vinin tani edhe burrat, bile edhe ndonjë plak për të shikuar djemtë.

Muço Thekra nuk i trazonte më, por që nga larg fshehur prapa ndonjë drize, i vështronte dhe u tundte gishtin duke ia bërë me vete: «Do të më bini ju në dorë! Atëherë do ta shihni se cili është Muço Thekra!»

Edhe djemtë e fshatrave të tjera kishin

formuar shoqëri të tilla dhe dendur bënin ndeshje midis tyre. Një ditë ata vajtën në Vodice, hipur në kuaj dhe gomarë, si krushq, bashkë me shumë fshatarë të tjerë që i shoqëronin tani kudo që venin.

Këtu Sotiri u njoh me një djalë nga Vodica. Josif ia thoshin emrin. Josifi atë vit kishte mbaruar Normalen e Elbasanit dhe priste ta emëronin mësues gjëkundi në Kolonjë.

Josifi, me ta parë, e përshëndeti:

— Kam dëgjuar për ty dhe kam dashur të të takoj, po pa rënë në sy.

— Ke të drejtë, unë jam i shënuar! — ia ktheu Sotiri.

— Mor, nga ajo unë s'kam frikë, por më vjen mirë që po gjej një shok të guximshëm, që s'ia pati për pesë italianit. Ma treguan shokët në Korçë.

Sotiri e dëgjonte me vëmendje dhe ia bënte me vete: «Ja, këtij i thonë luftëtar, i vërtetë, që s'i trembet syri prej asgjëje!»

Pastaj filloi ndeshja, e cila mbaroi me rezultat të barabartë.

Rreth lojëtarëve u mblodhën fshatarë, si nga Thikësi, ashtu dhe nga Vodica. Aty ishin edhe Josifi me Sotirin.

Duke qeshur me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë, Josifi tha:

— Ne i duam thikësit, se janë fshatarë si ne. Prandaj s'u bëmë dhe asnjë gol. Po

të ishin breshkamanë, do t'i rrihnim, jo me futboll, por me kopaç!

Josifi i thoshte fjalët si me shaka, por, kur pa se u erdhi mirë nga fjalët e tij, thirri me sa zë kishte:

— Poshtë okupatori fashist!

Këto fjalë shpërthyen si bombë. Asnjë s'bëri zë. Sikur këto fjalë qenë thënë në ndonjë shkretëtirë dhe s'kishte as ndonjë njeri pranë, por, si e morën pak veten, u gëzuan nga guximi i Josifit nga Vodica.

Kur u ndanë, Josifi me Sotirin u përqa-fuan si të njohur të vjetër.

— Për çdo nevojë që të kesh, kërkomë dhe me sa të mundem do të të ndihmoj! — i shtrëngoi dorën Josifi.

— Faleminderit, Josif, për fjalët e mira dhe për besimin që tregon karshi meje.

— Midis shokëve s'ka faleminderit. Çdo gjë ia bëjmë vetvetes, vendit dhe popullit! — ia ktheu Josifi.

Kur u kthye në shtëpi, Sotiri gjeti një letër, të cilën ia dërgonte Vaska. E kishte sjellë Ndreçi, që punonte tani në Korçë si çirak te një bukëpjekës.

Vaska i shkruante:

«I dashur Sotir,

Që kur ke ikur ti, këtu në Korçë kanë ngjarë shumë gjëra, sidomos në grupin tonë. Nikon e përjashtuan nga radhët tona dhe grupi po forcohet dita me ditë, po zgjerohet

dhe po futet thellë në masat, ashtu siç kishim vendosur, në një mbledhje, në të cilën ke marrë pjesë edhe ti. Kemi ndër mend që grupet e veçanta të bashkohen dhe për së shpejti është në plan që tërë grupet të derdhen në një parti të vetme, në Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Tani për tani direktiva e grupit është të hyjmë edhe në radhët e ushtarëve italianë, se ndër ta ka mjaft elementë, të cilët janë kundër luftës dhe okupacionit të Shqipërisë. Ata do të na ndihmojnë më tepër brenda radhëve të tyre, sesa vetë ne, për të çorganizuar ushtrinë italiane.

Të gjithë anëtarët e grupit të dërgojnë të fala dhe të lavdërojnë për aktin patriotik.

Në dhomën tënde teto Sofika futi një djalë tjetër, Belul ia thonë emrin, është djalë i urtë dhe merremi vesh mirë me të. Teto Sofika nuk të harron kurrë, bën ç'bën dhe ta zë emrin në gojë.

Edhe një gjë tjetër. Emri im tani është Leka. Të gjithë shokët këtu kanë emra të ndryshëm të fshehtë, që të mos zbulohen nga xhandarmëria dhe okupatori.

Të përqafoj me mall,
Leka

P.S.

Letrën lexoje dhe menjëherë digje.»

Sotiri nuk e lexoi vetëm një herë, por

disa herë me radhë. Donte t'i mbante mend të gjitha sa i shkruante Vaska, të gjitha, asnjë presje të mos harronte. Dhe, si u sigurua se të tëra i dinte përmendsh, mori një shkrepëse, e ndezi dhe e dogji në oxhak.

Sotirit i erdhi mirë që Nikon e kishin flakur nga grupi i tyre, se gjithmonë do të nxirrte ndonjë yckël në mbledhje. Por më tepër nga të gjitha e gëzoi lajmi se po bëheshin përgatitje për të themeluar Partinë Komuniste të Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë arriti një letër edhe në postëkomandën e Thikësit. E dërgonte Komandatura e Qarkut të Korçës dhe përsipër saj shkruhej: «Shumë sekrete!»

«Në fshatin Thikës i rrethi i Kolonjës, ndodhet Sotir Demiri, i biri i Xelit dhe i Zikes, njëzetedyvjeçar, i dëbuar nga Liceu i Korçës. Aktivitet antiitalian. Anëtar i grupit Komunist të Korçës. Të jetë nën vëzhgim të pandërprerë dhe, po të tregojë aktivitet subversiv, të arrestohet menjëherë!

Komandanti i përgjithshëm i karabinierisë së qarkut të Korçës, gjeneral:

Silvio Robino»

Kapteri i postëkomandës dhe sidomos të dy karabinierët italianë mbetën gojëhapur, të kishin një njeri kaq të rrezikshëm në rrethin e tyre dhe ata të mos e dinin fare, por t'ua njoftonin që lart?!

Edhe kafshëve nuk u jepnin dot ujë, se nuk u vinte radha kurrë.

Atëherë u mblodhën burrat dhe zgjodhën një dërgatë e shkuan te koloneli italian, i cili qe komandant. Anëtar i kësaj dërgate qe edhe Sotiri, se ai ishte i vetmi që mund të merrej vesh me italianët.

Koloneli i priti fshatarët në çadrën e tij, që e kishte ngritur në një breg përmbi fshat.

— Ç'doni? Përse keni ardhur këtu? — i pyeti ai.

— Fshati s'mbush dot ujë në çezmë nga ushtarët tuaj! — i shpjegoi çështjen e ardhjes Sotiri.

— Uji është pa para dhe për të gjithë! — ia ktheu si me të qeshur koloneli italian.

— Ashtu është, — ndërhyri atëherë Ligor Broqja, që ishte kryeplak, — por neve na lypset ujë për të pirë dhe ai nuk arrin, se ushtarët janë shumë dhe nuk na vjen radha të mbushim enët tona! Përktheje, — i tha pastaj Sotirit.

Koloneli këtyre fjalëve iu përgjigj:

— Do ta rregullojmë. Sa lyfytë ka çezma?

— Dy lyfytë, — ia priti Sotiri.

— Atëherë në njërin lyfyt do të mbushni ujë ju, me tjetrin ne. Mirë? — shtoi ai.

— Mirë, po për kafshët si do t'ia bëjmë? — pyetën atëherë fshatarët.

Kolonelin e inatosën këto fjalë dhe ua ktheu i zemëruar:

— Ju nuk qenkeni fare të kënaqur nga

bujaria ime, mos doni të më përzini edhe që këtej?

Sotiri i përktheu këto fjalë.

Atëherë u hodh Dhosi i Maros:

— Po të bënit këtë, do të qe më mirë. Por tani e kemi fjalën për kafshët tona, që po na ngordhin për ujë.

Sotiri nuk deshi t'i përkthente këto fjalë. Por Dhosi nguli këmbë. Fshatarët u shqetësuan dhe po flisnin midis tyre.

Koloneli e kuptoi se diçka po ndodhte dhe pyeti:

— Ç'thotë, ç'thotë?

Atëherë Sotiri ia përktheu fjalët e Dhosit.

Koloneli rrudhi vetullat. Të gjithë prishnin të bënte ndonjë të pabërë, por ai u shpjegoi:

— Ne do të jemi për pak kohë dhe me vendësit duhet të shkojmë mirë. Nuk do t'jua prish, kafshët tona do t'i shpiem në lumë për ujë. Të kënaqur jeni?

— Të kënaqur! — u përgjigj Ligori.

Kur dolën jashtë çadrës, fshatarët të çuditur zunë të bisedonin për sjelljen dhe fjalët e kolonelit italian.

Xha Noxi tha i merakosur:

— Nuk më pëlqyen fjalët e tij. Ai do ta ketë mirë me ne, se diç di më tepër se të gjithë nga planet e tyre. Dhe ta dini, këta s'kanë ardhur për mirë këtu. Do t'i bien Greqisë!

— Ashtu tregojnë bathët! — pohuan dhe fshatarët.

Dhe që atë ditë vunë rojë në çezmën e fshatit, nga një anë rrinte një ushtar italian me pushkë në dorë dhe nga ana tjetër ndo një djalë nga fshati. Por prapë mezi mbushnin ujë, se lyfyti ishte i vogël; por sidoqoftë nuk vuanin nga etja. Vajzat dhe gratë nuk venin më në çezmë, por vetëm burrat dhe djemtë.

Aty u njoh Sotiri me një ushtar italian. Ishte një burrë në moshë mesatare. Kishte lënë mjekër dhe tregonte më i madh. Që të dy qenë rojë. Si ndenjën një copë herë pa folur, italianit s'iu durua dhe pyeti:

— A di pak italisht?

Për çudi të tij Sotiri iu përgjigj!

— Po, po!

Atëherë italiani menjëherë u interesua:

— Ç'mal është ky që ngrihet para nesh?

— Mali Gramoz.

— Gramozi?! Mos është këtu kufiri i Shqipërisë me Greqinë?

— Po, ç'të shikon syri është Shqipëri, kurse matanë është Greqi!, — pohoi Sotiri.

— Domethënë këtu na kanë sjellë për të na hedhur në luftë. Porca miseria! — thirri italian.

Rreth e rrotull tyre kishte plot ushtarë që qenë radhitur për ujë. Atëherë italianit që fliste me Sotirin u kthye nga ata dhe thirri:

— A e dini se përse na kanë sjellë këtu?

Për të luftuar me grekun, se Shqipërinë e ndan nga Greqia, ja, ky mali që kemi përpara dhe që s'është më larg se një orë!

Atëherë edhe italianët e tjerë zunë të shanin në gjuhën e tyre:

— Porca miseria! Mannaccia la madona!

Të dëshpëruar dhe të inatosur ata filluan t'i hidhnin në erë gavetat, t'u binin me këmbë matarave. I prishën radhët dhe fshatarët që po i shikonin çuditëshin me ta se nuk merrnin vesh fjalët dhe shkaku e tyre.

— Të paktë janë ata që kanë ardhur me qejf në vendin tuaj, vetëm këmishëzinjtë. Ne të tjerët na kanë sjellë me zor.

S'duam të derdhim gjakun që të marrin edhe më tepër pasanikët e Italisë.

— Si ju quajnë? — e pyeti Sotiri.

— Xhulio Gargano, nga qyteti Breshia. Po ju?

— Sotir Demiri.

Dhe qysh prej asaj dite Sotiri u lidh me Xhulion dhe shpesh bënë rojë bashkë dhe bisedonin gjatë për shumë çështje anës çezmës së fshatit.

Kështu kaluan disa ditë. Pastaj përnjëherësh Xhulioja u zhduk, nuk dukej më nga çezma. Sotiri u bë merak për fatin e tij dhe, sa më shpesh vente ta kërkonte nga krojet, aq më tepër i shtoej dhe shqetësimi.

Një ditë pyeti një ushtar tjetër, që e kishte parë me të.

— Ah, Xhulion, ishte shpirt njeriu, por e hoqën që këtu. Dhe s'dihet se ku e kanë shpënë. E paditën për propagandë antifa-

shiste në rrethet e ushtarëve dhe për kryen-
ngritje. Eh do ta pësojë i shkreti, do ta
pësojë! — përsëriti italianin.

Sotiri vazhdonte të mblidhej me djemtë
e fshatit; jo për të lutitur futboll, se fusha
e Shëngjergjit nxirte tani nga çadrat e ush-
tarëve italianë, po nga misrat dhe vreshtat,
ku flinin natën, për t'i ruajtur se mos i hanin
ushtarët. Me Talinë nuk ishte takuar fare, se
gratë e vajzat nuk dilnin përjashta nga frika.
Vetëm ndonjë plakë do të shikoje rrugëve
të fshatit që vente o në kishë, o te dyqani
i Markos për të blerë gjësendi.

Sotiri kishte formuar në Thikës një grup,
ashtu siç kishin bërë në Korçë dhe në këtë grup
bënin pjesë djemtë më të guximshëm, Vangjeli
i Nastës, që ishte pak i rrëmbyer, por e dë-
gjonte Sotirin, Minai i Cingos, djalë i urtë
dhe i qetë, Ndreçi, po ai kishte shkuar në
qytet si çirak, Dhosi i Maros dhe Llambi,
i cili qe më i vogli, por arsyetonte si i madh.
Dhe kur vinin nga misrat mblidheshin nën
dritën e hënës, apo brenda në kalibe, kur
ishte natë e errët.

— Ore, këta duan plumbin, plumbin! —
thoshte i dëshpëruar Vangjeli i Nastës.

— Edhe ajo kohë do të vijë, por me ra-
dhë, tani duhet të bashkohet populli, i madh
e i vogël, dhe pastaj do t'u hidhemi përsi-
për e do t'i flakim nga viset tona!

Sotirit i vinte ndër mend letra e Vaskës.

që i shkruante se po bëheshin përgatitje për t'u shkrirë të gjitha grupet në Partinë Komuniste të Shqipërisë. Donte t'ua jepte edhe atyre këtë lajm, por e përmbante vetën, se akoma ishte shpejt.

Një mbrëmje Sotiri i lajmëroi:

— Nesër kemi Ditën e Njëzet e tetë nëntorit, Ditën e Flamurit. Dhe në këtë ditë duhet të tregojmë përpara botës dhe italianëve se jemi të gjallë dhe ne shqiptarët:

— Thuaj, Sotir, ç'duhet të bëjmë? Ne jemi gati për çdo gjë, — tha Vangjeli.

— Nuk do të bëjmë ndonjë gjë të madhe. Do të hidhemi gjer në Ersekë. Atje do të bëhet një manifestim i madh me rastin e Ditës së Flamurit. Të marrim pjesë dhe ne.

— Ç'është kjo? Asgjë! — shtoi përsëri Vangjeli, i cili priste ndonjë sulm kundër italianëve.

— Kjo është diçka e madhe, se do të kryhet përpara syve të fashistëve dhe kundër tyre. Festën që ata përgatitin për të gënjer popullin ta kthejmë në manifestim antifashist, antiitalian! — sqaroi Sotiri.

— Mirë e ka Sotiri. Kjo është me të vërtetë gjë shumë e madhe, por a do të arrihet? — shtoi Minai i Cingos.

— Do të arrihet, këtë më tha Josifi nga Vodica, kur isha të mërkurën e fundit në Ersekë.

Të gjithë qenë dakord dhe ranë të flinin shpejt duke ëndërruar për ditën e nesërme.

Qëmenatë ata u nisën për në qytet. Nxitonin të arrinin sa më parë. Edhe nga fshatrat e tjera po zbrisnin për në Ersekë. Udhës i arriti Sefer beu, hipur në një at të bardhë e të ushqyer mirë. Kur ecte, këmbët i lëshonin shkëndija nëpër kalldrëmin e xhadesë. Ai vetë kishte hedhur një bërrucë të zezë krahëve, kurse në kokë kishte një shapkë, e cila i ruante edhe veshët nga të ftohtët, se kishte filluar të prishej koha. Pas tij vinin katër burra të tjerë edhe ata hipur në kuaj. Midis tyre shquhej edhe Muço Thekra, i cili qe kapardisur dhe ai përmbi një kalë.

Kur kaluan pranë tyre, ata nuk u kthyen as kokën.

— Ky Sefer beu u tërbua fare që kur e bënë federal. I duket vetja më i madh se Musolini. Dhe shet mend poshtë e përpjetë, sikur kushedi se ç'di dhe budallenjtë që e ndjekin pas i mbajnë iso! — shfryu Sotiri.

— E di ç'dua unë? Dua ta shikoj një herë Sefer beun të ecë me këmbë, ja kështu si ne për në Ersekë.

— E shpon elbi atë! — shtoi Minai.

— Po kur kali ha elb shumë, i fryhet barku dhe pëlçet! — ia ktheu Sotiri.

Kur hynë në Ersekë, ndihej fryma e festës. Nëpër ndërtesat e zyrave kishin ngritur flamurët italianë dhe pranë tyre flamurin shqiptar; por me shenjën e liktorit në mes. Xhandarë dhe karabinerë bënë rojë nëpër rrugët e qytetit me pushkë, me bajoneta

mbërthyer krahëve. Po ushtarë italianë nuk dukeshin. Qyteti gumëzhinte vetëm nga pazarakët.

Sotiri me shokët e tij; që s'kishin as për të shitur, as për të blerë; nuk qëndruan te hani; po bënë drejt qendrës së qytetit, ku nga të gjitha anët po mblidheshin pazarakë.

Aty ata vunë re një grumbull njerëzish të veshur mirë, civilë dhe ushtarakë. Në krye të tyre shquhej një prift me rasë dhe një baba me rrobë të gjelbër.

Njerëzia po i shikonin me kureshtje. Disa qëndronin dhe tregonin me gisht ata që njihnin.

Ishin autoritetet e vendit: nënprefekti, kryetari i bashkisë, komandanti i rrethit, këmishëzinj të ndryshëm, të cilët po vinin të bënë meshën e rastit në katedralen e qytetit dhe në xhami, siç e donte zakoni i ditës. Midis tyre shquhej edhe Sefer beu, veshur me uniformën e federalit dhe me këmishë të zezë. Ai krekosej në mes tyre si ndonjë këndes majë plehut.

Një fshatar hodhi një romuz:

— Mor po si u bë kjo dyrja kështu, muhamedanët u bënë të krishterë dhe të krishterët muhamedanë. Shikojini që të gjithë së bashku po venë t'i luten zotit!

— Po venë t'i luten kësaj! — ia priti një fshatar tjetër dhe me gishtin e dorës bëri shenjë, që donte të të thoshte se i luten parasë.

Si u larguan autoritetet e vendit dhe nuk dukeshin më; nga rrethi i pazarakëve doli një djalë i ri dhe, me sa zë kishte, thirri:

— Poshtë fashizmi dhe tradhtarët e vendit!

Të gjithë mbetën të habitur kur dëgjuan këto fjalë, sa të pakuptueshme, aq dhe të frikshme. Megjithëkëtë u pëlqeu guximi i tij i çmendur dhe po e shikorin si të magjepsur.

Sotiri e njohu menjëherë. Ishte Sifi nga Vodica. Dhe bashkë me shokët e tjerë u afrua pranë tij. Erdhën aty dhe shumë djem të tjerë. Shkëmbejnë midis tyre ndonjë fjalë dhe radhiteshin njëri pas tjetrit. Pastaj njëri prej tyre nxori nga gjoksi një flamur kuqezi pa shenjën e liktorit dhe e shpalosi në erë. Dhe me të në krye u nisën për nga Presidioja e fashios duke kënduar.

*Sot lypset me flamurë,
malit të dalimë.
Përmbi shkëmbinj e gurë,
liri të ngjallimë!*

Kënga u hap si një kushtrim nëpër tërë qytetin. Zanatçinjtë e linin punën dhe dinin nëpër dyert e dyqaneve, kurse çirakët bashkoheshin me rininë. Edhe fshatarët, të cilët në fillim nuk dinin se ç'bëhej, i ndiqnin prapa.

Kënga ushtonte:

*Se mjaft në robëri,
o e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkatë,
ja vdekje, ja liri!*

Karabinierët dhe xhandarët, të cilët bënin rojë nëpër qytet, në fillim e pandehën si manifestim shkollor dhe nuk i trazuan, po, kur e panë që turma po rritej dhe po egërsohej, u radhitën anës trotuarëve dhe po i bënin sehir, pa ditur se ç'të ndërmerrnin. Kryetarët që duhej të jepnin urdhra mungonin, ata në këtë çast po dëgjonin meshën, e cila po mbahej në katedralen e qytetit.

Përpara Presidios së fashios të rinjtë dhe populli qëndruan dhe zunë të thërrisnin.

— Poshtë fashizmi! Rroftë Shqipëria e lirë!
Bashkim! Bashkim!

Që andej kaluan përpara nënprefekturës, gjithë duke kënduar e duke thërritur.

Pastaj u kthyen përsëri në mes të qytetit. Aty, ai djali i ri, i cili i pari kishte ngritur zërin kundër fashizmit, hipi në një fron, që ia sollën nga një dyqan dhe zuri të fliste:

— Të dashur bashkatdhetarë!

Sot ne të gjithë po festojmë në zi ditën e shenjtë të flamurit. Me 28 nëntor 1912, në një ditë si të sotmen, patrioti i flaktë shqiptar, Ismail Qemali, ngriti flamurin shqiptar në Vlorë. Dhe që atëherë shqiptarët e flakën në Anadoll halldupin e urryer. Por ja, Shqipëria jonë e dashur ra përsëri në robëri. Italia fashiste e pushtoi verdin tonë dhe me gënje-

shtra kërkon të na mashtrojë, se gjoja ajo na çliroi dhe ne vetë, me vullnet të lirë, i dhuroam Viktor Emanuelit të Tretë kurorën e Skënderbeut.

Por kjo, të dashur vëllezër, nuk është e vërtetë, këtë kurorë nuk ia dhuroi Viktor Emanuelit populli shqiptar, por tradhtarët e vendit!

Rroftë Shqipëria e lirë!

Populli përsëriste me ashk:

— Rroftë Shqipëria e Lirë! Rroftë Shqipëria e lirë!

Sheshi buçiti nga jehona e zërave të tyre, që dilnin nga gjokset e kaq njerëzve.

Komandanti italian i qytetit, me të marrë vesh se ç'po bëhej nëpër Ersekë, u turr me zhurmë dhe i inatosur për nga sheshi i pazarit bashkë me karabinierët e tij duke thirrur:

— Hapuni! Hapuni!

Po asnjëri nga turma nuk donte të bënte udhë.

Si e pa komandanti se me të mirë nuk do t'ia arrinte qëllimit, dha urdhër të rreptë:

— Shpërndajini me forcë!

Atëherë karabinierët dhe xhandarët u hodhën në sulm.

Populli u përlesh me ta. Në sheshin e qytetit u bë rrëmujë. Dëgjoheshin vetëm të sharat e komandantit dhe të karabinierëve, që thërrisnin në gjuhën e tyre:

— Mama mia! Porca madona! Fermate vi!

— Kur sheshi u zbraz, kishte të plagosur e të shtrirë përdhe nga të dy anët.

Ata që i zurë i lidhën dhe i shpunë te burgu i nënprefekturës. Midis tyre ishte edhe Sotiri.

Të arrestuarit, nja pesëmbëdhjetë veta, i futën në një dhomë të vogël, të parregulluar, as të lyer, as me dysheme, nën katin e parë të prefekturës, e cila shërbente më tepër për stallë, sesa për burg. Kur kapnin vjedhës apo ndonjë njeri që prishte rendin publik, e mbanin këtu derisa merrte fund çështja e tij.

Nga ana perëndimore dhoma ndriçohet prej dy dritareve të vogla, të cilat jepnin një dritë fare të paktë. Ato qenë të siguruara nga jashtë me hekura dhe qe e pamundur të dilje prej andej. Brenda mbante një erë të keqe, erë bajgash të ndenjura. Vend për t'u ulur nuk kishte dhe të gjithë sa ishin mezi mbaheshin më këmbë.

Sotiri thujse i njihte të tërë djemtë që i kishte takuar gjatë ndeshjeve që kishin bërë me fshatrat e tjera, si nga Vodica, Rehova, Borova. Po aty ishin dhe nja dy a tre burra në moshë dhe një plak nga Qinami.

Të rinjtë ishin të shqetësuar, kurse plaku nga Qinami pinte duhan i qetë dhe u jepte zemër:

— Këta të huajt kështu e kanë. Po s'u vajte pas volles së tyre, bamp dhe të hedhin në burg. Dhe mos u trembni, djema. Mua më ka mbyllur këtu, ja në këtë birucë, edhe

turku, edhe greku, edhe frëngu. Ja tani edhe italiani. Dhe prapë iam i gjallë.

— S'më vjen keq nga të huajt, se i huaji është i huaj, por më vjen keq nga këta tanët, që u shërbejnë si mashë atyre dhe nuk kuptojnë! — shtoi një nga burrat.

— Kush të tha që nuk e kuptojnë, — ia ktheu plaku nga Qinami, — kuptojnë fare mirë, por ashtu janë mësuar dhe nuk heqin dot dorë, se atëherë duhet të luftojnë, të japin jetën, kurse atyre u pëlqen të rrojnë, dhe të rrojnë mirë, të hanë pilaf dhe kadaif, kurse tani shqepen me makarona.

— Ashtu është, — ia priti fshatari tjetër. Teki Rusi; nënprefekt në kohën e Zogut, nënprefekt më italianët.

Nëpër shkallë u dëgjuan çapa të shpejtë, si të zemëruar, që po ngjiteshin sipër, dhe jo vetëm të një njeriu, por të disa vetave.

Përposh në qilar pllakosi një heshtje, derisa u qetësuan hapat.

— Unë pandehja se do të na linin këtu tërë ditën dhe tërë natën, se sot kanë festë, por siç duket qenkan shqetësuar më tepër sesa e pandehja unë! — shqiptoi si me të qesëndisur plaku nga Qinami.

Nuk kaluan as pesë minuta nga këto fjalë dhe derën e qilarit e hapi një xhandar, kapi dy prej të arrestuarëve për mënge.

— Hajde, sipër në pyetje!

Që lart u dëgjuan zëra të inatosur, që vazhduan një copë herë.

Ata që qenë në qilar vunë vesh se mos kuptonir gjësendi, por asgjë. Zërat vinin të mbytur, pa kuptim.

Pas pak xhandari e hapi derën përsëri, kapi dy të tjerë dhe prapë i nxori përjashta nga qilari duke i shtyrë.

Ç'kishin mbetur në qilar zunë të pëshpëritnin midis tyre.

Derisa të parët që morën në pyetje nuk i sollën këtu, domethënë i kanë lëshuar, — u shpjegoi shokëve një djalë nga Rehova, i cili kishte punuar disa kohë në nënprefekturë.

Por pas pak, njërin nga të fundit, që e kishin marrë në pyetje, e kthyen përsëri poshtë.

Atëherë që të gjithë u turrën drejt tij dhe e mbytn me fjalë:

— Ç'pyesin?

— Cili është sipër?

Djali që tepër i shqetësuar, se vetëm atë po e kthenin përsëri në qilar dhe u përgjigj i dëshpëruar:

— Teki Rusi është në mes të tryezës, më të djathtë ka komandantin italian, kurse më të majtë është kapiteni i xhandarmërisë. Në një tryezë tjetër të vogël është një sekretar, i cili shkruan të gjitha ç'thuher.

Sotiri s'dëgjoi më tepër, se xhandari e kapi për mënge dhe e nxori nga qilari.

Atij i erdhi mirë kur doli përjashta, kur i ra në fytyrë era e freskët. I ngjiti shkallët ngadalë, se që i lodhur, i këputur dhe ashtu

hyri në dhomën e madhe të nënprefektit. Kater palë sy e shpuan si me shigjeta të zjarra, të cilat donin të depërtonin në zemër të tij dhe t'i zbulonin çdo të fshehtë. Sotiri pa në fillim vetëm kokën e madhe të Teki Rusit.

— Ulu! — iu kanos kapiteni i xhandarmërisë duke i treguar një karrige, e cila qe vendosur kundrejt tyre.

Atëherë Sotiri vuri re edhe të tjerët. Komandanti italian dallohej prej shqiptarëve nga uniforma e tij elegante, nga flokët e krehur me kujdes që i shkëlqenin. Edhe nishanet që kishte në mëngët e divizës, si dhe ato nëpër supe qenë qepur mirë e bukur dhe i zbukuronin edhe më tepër uniformën. Kapitenit shqiptar i spikatnin vetëm mustaqet që i kishte dredhur si dy bishta minjsh. Sekretari ishte civil dhe dukej që nuk kishte atë rëndësinë e të tjerëve, se e kishin vendosur veçar, pak më tutje.

Sotiri i shqetësuar para se të hynte e mori veten.

— Si ta thonë emrin dhe nga je? — e pyeti Teki Rusi.

— Sotir. Jam nga Thikësi!

— Si e quajnë babanë tënd? — vazhdoi ai për t'u siguruar.

— Xeli!

— Mos je djali i Xel Demirit? — e ndërpreu kapiteni i xhandarmërisë.

— Po!

— Atëherë si s'ke turp, të kesh baba të

tillë të ndershëm, që ka emër të mirë në tërë rrethin, dhe ti të merresh me gjëra të tilla! — ia priti Teki Rusi.

Kapiteni i xhandarmërisë u ul prapa kurrrizit të nënprefektit dhe se ç'i dha komandantit italian.

— Ju jeni sudenti i liceut të Korçës, që ju kanë dëbuar nga shkolla për aktivitet antiitalian, apo jo? — pyeti komandanti.

— Po si t'ju them, zotërinj..

— Ç'ju shtyu ju të veproni në këtë mënyrë, kur dihet se Italia e çliroi Shqipërinë dhe bashkoi kurorën e Viktor Emanuelit të Tretë me kurorën e Skënderbeut? — ia preu fjalën Tekiu.

Sotiri heshti. Vetëm një buzëqeshje e lehtë i kaloi nëpër buzë.

— Këtu jeni në pyetje dhe duhet të përgjigjeni, — iu kanos komandanti italian.

— S'kam se ç't'i përgjigjem kësaj pyetjeje!

— Kur s'ke se ç't'i përgjigjesh kësaj pyetjeje, atëherë thuaj kush e organizoi demonstratën e sotme? — e ndërpreu i zemëruar.

Sotiri përsëri heshti.

— Thuaj kush është organizatori i demonstratës së sotme! — e kërcënoi këtë radhë kapiteni shqiptar.

— Kjo nuk ishte demonstratë, por manifestim me rastin e Njëzet e tetë Nëntorit! — tha i qetë Sotiri.

— Mos u bëj bisht fjalëve, Sotir Demiri, por përgjigju, se ka edhe mënyra të tjera,

që mund të të bëjnë të përgjigjesh! — ndërhyri nënprefekti.

— S'kam ç't'ju them më tepër. Ky që një manifestim spontan i rinisë dhe i popullit të Kolonjës me rastin e Ditës së Flamurit, — tha prapë Sotiri.

— Lëri ato fjalë, neve na tha Koçoja se organizatori i këtij farsit të ndyrë ishte Josifi nga Vodica! — e ndërpreu kapiteni.

Koçoja ishte djali që e kishin kthyer përsëri në qilar pas pyetjes.

Sotirit i erdhi ta pështynte në fytyrë kapitenin, por e përmbajti veten.

— Kur e dirin, zotëri kapiten, pse më pyesni mua që s'di gjë.

— Ne duam vetëm të vërtetojmë! — shtoi nënprefekti duke pritur që të fliste Sotiri.

— Ti e njeh Sifin? — e pyeti atëherë italiani.

— Po, e kam takuar një herë në një ndeshje futbolli që kemi bërë në fshatin e tyre.

— Domethënë ai të ka thënë të vish sot në Ersekë? — vazhdoi ai.

— Sot, siç e dini, është ditë pazari dhe ardhja për të psonisur, si të gjithë fshatarët e tjerë! Dhe si të gjithë u bashkova dhe unë me manifestuesit.

— Domethënë nuk do të flasësh? — tha kapiteni shqiptar dhe u ra duarve. Në dhomë hyri xhandari që rrinte te dera.

— Merre këtë dhe fute përsëri në qilar. Për atje e ka kokën ai.

Xhandari e shtyu përpara dhe Sotiri doli nga dhoma si i shastisur.

Përposh e pritën me pyetje të njëpasnjëshme.

Por Sotiri heshtte. Pa Koçon që rrinte mënjanë kokulur dhe tepër i dëshpëruar.

— Koço, mbaje veten, ashtu si të kanë gënjyer ty për ndonjë tjetër, ashtu më gënjyen edhe mua për ty.

— Ç'të thanë? — lëvizi atëherë Koçoja.

— Më thanë se ti u ke thënë që Josifi e ka organizuar demonstratën.

— Të poshtrit! Kurse mua më thanë se Selamiu u ka thënë që demonstratën e kemi organizuar Josifi dhe unë!...

Selamiu ishte një nga të arrestuarit e parë, që e kishin marrë në pyetje dhe e kishin liruar.

— Të poshtrit, ata janë në gjendje të kurdisin çdo gjë vetëm e vetëm t'ia arrijnë qëllimit të tyre të fëlliqur!

Në qilar kishin mbetur vetëm pesë veta pa u pyetur akoma, por edhe ata i thirrën shpejt sipër dhe nuk i kthyen më poshtë. Aty ngelën vetëm Koçoja me Sotirin, strukur në një qoshe, ngjeshur pas njëri-tjetrit.

Të nesërmen në mëngjes shkoi në Ersekë Xeli. Ai e kishte marrë vesh arristimin e Sotirit nga shokët e tij të fshatit. Duke e ditur se ku ishte i biri, filloi të thërriste përposh dritares:

— Sotir! Sotir!

Sotiri e njohu menjëherë zërin e të atit dhe kërceu më këmbë.

— Ç'deshe që erdhe, baba! Ç'u mundove më kot!

— Na, tetja të bëri një lakror, se kushe-di mund të mos kesh ngrënë bukë! — dhe ia dha nga xhami i thyer. — Pse ju mbyllën këtu? — pyeti pastaj Xeli.

— Na mbyllën se morëm pjesë në demonstratën e djeshme! — iu përgjigj Koçoja.

Sotiri priste tani se ç'do t'i thoshte i ati, do ta qortonte, apo do të heshte. Në vend të fjalëve të të atit u dëgjua zëri i xhandarit:

— Është e ndaluar të flasësh me të arrestuarit! Largohu që andej!

Xeli ia ktheu që poshtë:

— More, njëri nga djemtë është djali im. Si s'ju erdhi keq një çikë që i keni lënë këtu të kalojnë natën. Zotrote ke fëmijë apo jo?

— Detyra është detyrë! Largohu që këtu! — i tha përsëri ai dhe e përzuri nga dritarja.

Xeli me çap të ngadalshëm dhe me zemër të thyer mezi u largua.

Sotiri mbeti i kënaqur nga ardhja e babait.

— Paskë baba të urtë! — tha Koçoja.

Sotiri nuk u përgjigj. Zgjidhi grykën e torbës, nxori byrekun që i kishte bërë nëna dhe e ftoi Koçon të hanin.

Në mbrëmje xhandari e hapi derën përsëri dhe u la brenda një gavetë dhe një copë bukë. Sotiri i pa me përbuzje, por uria ishte

më e fortë dhe bëri ç'bëri pas pak i hëngri duke sharë nëpër dhëmbë.

Pas një jave Sotirin e morën përsëri në pyetje. Nënprefekti në mes të tryezës, më të djathtë komandanti italian, më të majtë kapiteni shqiptar, kurse veçan, mënjanë, sekretari.

Teki Rusi i vrenjtur, akoma pa u ulur Sotiri, e pyeti:

— E, a të erdhi mendja në kokë tani? Hajde, thuaj cili ishte organizatori i demonstratës?

Sotirin e inatosi kjo pyetje.

Komandanti italian ndërhyri menjëherë:

— Dëgjo, djalë, ne mund të të ndihmojmë për t'u regjistruar përsëri në shkollë. Vetëm nga ti varet tani, thuaj ato që të pyesin dhe puna është e mbaruar.

Sotirit iu duk ky propozim i neveritshëm. Ndërsa dy të tjerët donin t'i shkëputnin pohimet me kërcënime, ky donte ta bënte vegël.

— Ne humbëm Shqipërinë, zoti komandant, ç'më lypset shkolla mua tani! — ia ktheu Sotiri, duke përdorur fjalët e babait.

Komandanti italian kërceu nga froni si i tërbuar.

— Shpjereni në qilar! Dhe ta mbani atje derisa t'i tregojë të gjitha! Jashtë! Jāshtë! — thirri ai.

Xhandari e vuri përpara Sotirin dhe, me të shtyra, e shpuri përposh në qilar dhe e kyçi.

Por këtë radhë, me gjithë dëshirën e komandantit italian, ai nuk ndenji aty më shumë se dy-tri ditë, se në komandën e rrethit erdhi një letër urgjente nga komanda e përgjithshme e karabinierisë së qarkut, e cila jepte udhëzimet e mëposhtme:

«Komandës së karabinierisë së rrethit,
Ersekë

Sipas njoftimeve që na dhatë për demonstratën që u bë atje më njëzet e tetë nëntor të këtij viti, keni kapur dhe arrestuar të riun Sotir Demiri, të birin e Xelit dhe të Zikes, nga katundi Thikës, njëzetedyvjeçar. Subjekti i lartpërmendur është i nevojshëm për këtë komandë, meqë ai bënte pjesë në grupin Komunist të Korçës dhe mund të nxjerrim prej tij njoftime të cilat janë tepër të nevojshme. Prandaj i lartpërmenduri të dërgohet menjëherë urgjent dhe me siguri të plotë për në këtë komandë.

Komandanti i përgjithshëm i karabinierisë së qarkut të Korçës,
gjeneral: Silvio Robino»

Dhe Sotirin e hipër menjëherë në një makinë të mbyllur dhe, të shoqëruar nga dy karabinierë, e nisën për në Korçë.

XV

Familja e madhe e Broqeve e hanin drekën si të ndodhte, po mëngjeset dhe darkat i hanin gjithnjë së bashku. Në krye rrinte Ligori, si më i madhi i shtëpisë, dhe nga ana tjetër gjyshja plakë, pas saj vinte Markoja dhe gratë, si e Ligorit ashtu dhe Markovica, pastaj Serafimi i Ligorit, Lipja e çupat e vogla, dy të Markos dhe njëra e Ligorit. Tاليا, si më e madhe që ishte, u shërbente, se ajo që në moshë për t'u martuar dhe duhej të mësonte se si duhej të sillej në shtëpinë e burrit.

Gjatë darkës apo mëngjesit ata do të flinshin për punën e shtëpisë dhe të dyqanit, ku do të venin dhe ç'do të bënin, po që kur e futën Sotirin e Xel Demirit në burg, familja e Marko Broqes nuk e lëshonte dhe atë nga goja. Sikur ai kishte dhënë shenjën e një frike të largme, e cila vetëm mund të pandehej, por jo të dukej e qartë përpara syve, se punët e familjes së tyre tani për tani venin mirë. Nga dyqani, që prej ardhjes së italianëve, fitimet, u dhjetëfishuan. Nga malli i madh që kishin, ata siguronin jo vetëm bukë e gjellën, por edhe shisnin grurë dhe misër, kurse nga kopetë me dhen e me dhi, bënin aq bulmet, saqë çdo vit në pazarin e Korçës apo të Ersekës nxirrnin me dhjetëra teneqe gjalpë, djathë e gjizë. Por megjithëkëtë tani, posa shtroheshin të hanin darkë apo mëngjes, Ligori ose Markoja do të thoshin diçka.

— Hej, ky djali i Xelit, turpëroi fshatin. Gjer më sot Thikësi llogaritej si një nga fshatrat më të qeta, po që kur e dërgoi Xeli të birin në Lice, e ktheu fshatin me kokën tatëpjetë.

— Kapteri më tha se e paskan dërguar në burgun e Korçës. Dhe kush hyn atje, s'del më! — sqaroi fjalët e Ligorit Markoja.

— Mirë ia bënë. Zikja me të e mbante kokën përpjetë, sikur që e para e fshatit dhe s'të peshonte për pesë para. Të gjente në rrugë dhe s'të jepte as vaktin. Por tani i ranë petkat. E pashë në çezmë, e kishte varur kokën! — shtonte Markovica.

— Mos fol kështu, i vjen keq tjetrës! —
ia kthente e Ligorit.

— Për atë hiç s'më vjen keq.

— Do ta dërgonin në shkollë të lartë, veç
dynjasë ata.

— E dërguan dhe e hoqën! — ia priti e
Ligorit.

Talisë, që i dëgjonte të gjitha këto, i pi-
konte në zemër. I vinte edhe asaj të merrte
fjalën e t'u thoshte të pushonin, të mos fli-
snin më për të. Ajo e merrte me mend që i
ati dhe e ëma e bënin kastile, që ta ftohnin
dhe ta shtynin ta urrente. Kurse ajo e da-
shuronte më tepër. I dukej trim përmbi tri-
mat, i cili nuk donte vetëm veten e tij dhe
atë, po tërë fshatin, gjithë Shqipërinë.

Një natë, kur ishin në shtrat, Markoja i
tha së shoqes:

— Tani është rasti më i mirë të rregu-
llojmë edhe ne Talinë, sa nuk është kthyer
çamarroku i Xelit.

— Ç'ke ndër mend, mor burrë? — ia
ktheu ajo gjoja sikur s'i kishte kuptuar
fjalët e tij.

— Ç'kam ndër mend!? Ja, ta zëmë çupën
me ndonjë djalë të mirë në fshat dhe ta mar-
tojmë!

— Këtë ta kam thënë unë që njëherë.
Mirë që të erdhi ndër mend.

— Lëri ato tani. Po ti si grua dhe si nënë
që je do ta gatitësh, që të mos e ndiejë
Talia sikur ia japim me zor.

— Sefte duhet të gjejmë djalin.

— Djema në fshat ka sa të duash, vetëm të hapim gojën. Kush nuk do ta marrë Talinë tonë?!

— S'është ashtu, unë për shembull do t'i zgjidhja djalin e Kiço pitropit, Josifin, djalë i urtë, punëtor, po edhe nga gjendja s'janë keq, mall e bagëti kanë plot.

— Djali është i mirë, dhe mua më pëlqen. Atëherë shiko, fol ti nesër me Talinë, pa sa për Kiçon e rregulloj vetë, se më vjen përditë ardej nga dyqani për të blerë vaj apo qirinj për kishën.

Dhe kështu e lanë.

Të nesërmen në mëngjes, kur të gjithë u shpërndanë nëpër punët e tyre, e Markos gjeti rastin kur Talia qe vetëm në sobë dhe po krihte flokët përpara pasqyrës.

— Këta flokët i ke si të artë, gjer te mesi të arrijnë, apo s'të kanë hije, si ndonjë kore me je, çupë e nënës! — i tha ajo.

— Nënave të gjitha çupat u pëlqejnë dhe u duken sikur janë të Bukurat e Dheut!

— Mua s'më zë qederi për çupat e botës dhe ç'thonë nënat e tyre për to. Unë kam hallin tënd, se ja tani erdhe në vaktin për t'u martuar.

Dhe e Markos s'vazhdoi më tutje, donte të dëgjonte përgjigjen e saj dhe e la fjalën përgjysmë.

Po edhe Talia heshtte duke vazhduar të krihej e të shikohej në pasqyrë.

— Fol, de, urë të flas, nëna jote!

— Po ç'të të them, moj nënë.

— Ja, të më thuash këtë djalë pëlqej, këtë djalë dua, dhe babai dhe nëna jote do të të zënë me të!

— O, sa lehtë të duket, moj nënë!

— Po lehtë është, si s'është lehtë, me atë baba që ke ti, — iu afrua dhe zuri t'i përkëdhelte flokët, që tani e bija po i bënte gërshet. — Dale të të ndihmoj unë. Kur të bëj gërshetat, më kujtohesh kur ishe e vogël, sa e urtë ishte atëherë, për çdo gjë më dëgjoje.

Talia kuptonte që e ëma fshihte gjëka-fshë, se kishte diçka për t'i thënë, se gjithnjë, kur donte t'i bëhej e saja, e merrte kështu me të mirë.

— Dëgjo, çupë e nënës, ty me të vërtetë të erdhi vakti për t'u martuar. Babai dhe unë kemi menduar për ty dhe të kemi gjetur djalin më të mirë në fshat.

Talia kërceu nga vendi, sikur e kafshoi ndonjë grerë.

— Cili qenka ky djali më i miri në fshat?

— Josifi, djali i Kiço pitropit!

Talia zuri të qante.

— Ç'ke, moj, nuk e do atë? Po cilin do ti, moj bushtër?

— Ti e di cilin dua unë!

— Ti do hajdutin, që po kalbet nëpër burgje, që të na bësh të gjithë për turp të botës. Ai as që ka për t'u kthyer që andej. Po si do t'i them unë tyt eti, moj kërcure? — shfreu Markovica.

Të thirrurat e s'ëmës sikur e sollën pak në vete Talinë dhe, përmes lotëve, shqip-toi:

— Ju doni prej meje të pamundurën. Ju doni të më vrisni.

— Cili është ai prind që do të vrasë çupën apo djalin e tij? Ç'janë këto llafe?! Nuk ka në botë baba dhe nënë të tillë.

Dhe Markovica i mori kokën çupës në duart e saj dhe, duke e përkëdhelur, i fliste:

— Mos na turpëro, çupë e nënës, bëja vollen babait dhe nënës sate dhe pastaj do ta shikosh se sa mirë do të jetë!

Talinë e kishte zënë lemza nga të qarët, gjoksi i ngrihej dhe i ulej pa pushim dhe zëri i mbeti në grykë.

Në mbrëmje, me të rënë në shtrat, Markoja u kthye nga e shoqja dhe tha:

— Këtoja u gëzua shumë kur dëgjoi për atë që folëm. «Kurrë s'më vente ndër mend të lidhnim krushqi bashkë, me një derë të tillë si juaja!» më tha. Dhe, të të them të drejtër, më gëzuan dhe mua fjalët e tij. Po Talia? — e preu fjalën ai.

— Ç'do të thoshte, qau një copë herë dhe pastaj nuk foli, por dukej që edhe ajo nuk ishte kundër.

— Po s'të thashë unë! Tani duhet të nxi-tojmë sa më parë të këmbejmë nishanet dhe s'ka ç'të bëjë më.

— Po, po, sa më parë, aq më mirë! —
pohoi dhe Markovica.

Pastaj dolën fjalë në fshat se Talinë e Markos do ta zinin me Josifin e Kiço pitropit dhe prisnin me padurim ditën që do të këmbenin nishanet. Po për këtë ditë duhet të përgatiteshin të dy palët.

*
* *
*

Dita e dytë e kërshëndellave, kur kishin vendosur të bënin fejesën, po afrohej. Talia pyeste për Sotirin, po për të nuk kishte asnjë lajm. Tërë atje e kishte mendjen. Ditën harrohej pas punëve të shtëpisë, he për ujë, he për kashtë nga plevicat, he për të fshirë shtëpinë e për të rregulluar drekën e darkën dhe koha kalonte shpejt. Por netët qenë të tmerrshme. Me të rënë në shtrat dhe mendja zinte t'i punonte si sahat. Herë thoshte të ikte fare nga shtëpia. Po ku të vente? Atëherë do të humbte edhe veten e saj, dhe Sotirin. Herë i vente mendja te vdekja dhe plekste të dy duart prapa qafës. Dhe me mendime të tilla e zinte një gjumë i rëndë e me ëndrra të liga, të cilat e bënin të kërcente nga shtrati.

Sa vente dobësohej. Buka s'i shkante. Vetëm ujë i kërkonte zemra e zhuritur, se gjithnjë qe me ethe.

Mbrëmjeve, kur mblidheshin që të gjithë në sofër, vinte vetëm se mos dëgjonte ndonjë fjalë për Sotirin, por tani edhe Ligori dhe Markoja flisnin për gjëra të tjera. Me shtimin e punëve të tyre dhe të parave tani fshati u' dukej i ngushtë dhe gjatë darkës ndonjë prej tyre thoshte:

— Po sikur të hapim një dyqan në Korçë, hə?

— Në Korçë? Mor në Ersekë të hapim, gjene mirë!

— Mirë u kujtove, në Ersekë, se do ta kemi afër fshatit dhe mbrëmjeve mund të kthehemi në shtëpi.

— Do gjetur ndonjë dyqan atje. Nga behari shohim e bëjmë.

Këto bisedime e shqetësonin edhe më shumë vajzën.

Ditën e parë të kërsëndellave Talisë i ra të fikët dhe nuk vajti dot në kishë. Edhe e ëma ndenji pranë saj, tepër e dëshpëruar. Ajo bënte ç'bënte dhe thoshte:

— Po nesër si do të bëjmë, çupë e nënës? Ti duhet të ngrihesh medoemos të presësh krushqit. Përndryshe do të prishet fejesa. Do të ngrihesh për një çikë se s'bën.

Vajza dergjej në shtrat, nuk i përgjigjej as po, as jo. Të nesërmen ajo u bë më keq. Në mëngjes i erdhi një e nxehtë si prush dhe ra në një kllapi të thellë.

E Markos dhe e Ligorit i rrinin mbi krye

e i flisnin me të mirë, por çupa as i dëgjo-
nte, as mundte t'u përgjigjej.

Një rrëmujë u bë atëherë në shtëpinë e
madhe të Broqëve. T'i prisnin krushqit me
nusen në shtrat, s'bënte. T'u thoshin të mos
vinin, keq. U mblodhën që të gjithë te soba
e tyre për t'u këshilluar.

Markoja tha:

— Unë them të dërgojmë Lipen t'u thotë
të vij në tjetër herë kur të marrë veten çupa,
ta zëmë pas një muaji, ditën e shën Tha-
nasit. Edhe atëherë e kremte e madhe është,
dhe shkëmbejmë nishanet siç e do zakoni i
verdit.

— Jo Lipja, duhet të vesh ti vetë; që të
mos fyhen — e kundërshtoi Ligori.

— Mirë thua, por dhe mua më vjen turp
të vete, vëllaçko!

— Turp pa turp, ti duhet të vesh. Ku
di Lipja ç't'u thotë! — ia priti prapë Ligori.

Dhe Markoja pa ç'pa u ngrit nga vendi
dhe u nis për nga Kiço pitropi dhe e shtynë
fejesën edhe për një muaj, sa ta merrte ve-
ter. Talia.

Dhe me të vërtetë çupa erdhi në vete
pas një tri a katër ditësh. Dhe kur mësoi
se ç'kishte ngjarë u gëzua edhe më tepër.
Asaj edhe një ditë të fitonte i vinte mirë.
jo një muaj të tërë. Po rreziku nuk ishte
zhdukur, vetëm qe shtyrë për njëfarë kohe.
Ajo thoshte me vete:» Gjer atëherë Sotiri
mund të vijë dhe mund të rregullojmë rdo-
një gjë së bashku!»

Po Sotiri edhe atëherë nuk erdhi. Në fshat u hap lajmi se Josifin e Kiço pitropit me disa djem të tjerë të fshatit të moshës së tij i thërrisnin menjëherë ushtarë.

Dhe kështu vajza u qetësua. Një vit e tetë muaj Josifi do të qe ushtar. Gjer atëherë s'dihej. Edhe babai me nënën do ta linin të qetë e nuk do ta trazonin më, se ata vetë kishin vendosur me atë dhe s'mund të zgjidhnin tjetër.

XVI

Xel Demiri e nxori dimrin me çap e jak në Korçë. E bëri Korçën si nga çezma në shtëpi. Por të gjitha përpjekjet e tij për të gjetur se në ç'burg e kishin hedhur Sotirin i venin kot. Sa herë kishte pyetur në burgun e ri, apo në atë të kuesturës, i përgjigjeshin se nuk dinin gjë dhe e përzinin.

Një ditë iu lut rojës:

— More djalë, të kesh dëgjuar gjësendi, a është këtu brenda një Sotir, Sotir Demiri?

— Është e ndaluar të flasësh me rojën, xhaxho!

— Pse, more? Nuk jam njeri unë?!

— Largohu të thashë! — iu kanos këtë radhë roja:

Dhe Xeli u spraps me fjalë të hidhura nëpër gojë.

— Mor po s'paska një njeri me mëshirë këtu në Korçë! Të gjithë qenkan bërë katilë!

Dhe nga burgu i ri bëri për nga burgu i kuesturës. Por edhe atje mori prapë të njëjtën përgjigje.

Herë pas here Xeli shikonte nëpër dritaret nga jashtë, por atje venin e vinin më tepër karabinierë e xhandarë dhe rrallë dallonte ndonjë civil.

Një ditë, mori vesh nga teto Sofia se edhe Vaskë Telin e kishin arrestuar dhe e kishin mbyllur në burg. Po se në ç'burg s'e dinte. Kishte pyetur edhe ajo, por nuk i tregonin.

Kjo e dëshpëroi Xelin edhe më tepër.

Gështenjashitësi, — që rrinte në një qoshe pranë urës së burgut të ri, e ndaloi dhe i foli:

— Më fal, xhaxho, po ti më dukesh se nuk je prej Korçe?

— Vërtet nuk jam, jam nga fshatrat e Kolonjës.

— Kam ditë që të shikoj të vesh e të vish nga burgu i ri, te burgu i kuesturës. Si e ke hallin?

— Hallin tim mos e pastë as dushmani. Më kanë arrestuar djalin dhe e kanë hedhur në

burg, mirëpo nuk tregojnë se ku është, që t'i shpie ndonjë rrobë, apo gjësendi për të ngrënë.

Gështenjshitësi tundi kryet i menduar.

— Si e kanë zënë këta, tërë Shqipërinë do ta kthejnë në burg! — shfryu ai.

Xeli bëri të shkonte, por ai iu lut:

— Eja të heqim mënjanë pak këtë thesin me gështenja!

Dhe Xeli e ndihmoi për ta zhvendosur thesin me gështenja të ngrohta në një kasolle të vogël, që ishte prapa mangallit.

Brenda ai i tha:

— Eja me mua tani, kam një xhandar të njohur në kuesturë dhe do të na ndihmojë.

Gështenjshitësi e kyçi derën e kasolles dhe u nisën. Ecnin pa folur.

Xhandari në fillim kundërshtoi, por, si i premtuan një bakshish të mirë, i përcolli duke thënë:

— Tani shkoni, me drekë do të vij tek ura dhe do t'ju them.

Xeli me gështenjshitësin u ndanë.

Në drekë xhandari erdhi me të vërtetë.

— Mezi e zbulova. Në kuesturë e ke.

— Si është me shëndet? A i the gjësendi për mua? — pyeti Xeli i merakosur.

— Dhe ne nuk na lënë të flasim me të. Puna është që e gjeta dhe është i gjallë.

— Rrofsh e qofsh! — i tha Xeli dhe nxori një pesëfrangëshe dhe ia dha xhandarit. Pastaj u kthye nga gështenjshitësi: — Këtë që më bëre ti, nuk do të ta harroj kurrë. Që

sot do të kthehem në fshat të gëzoj edhe gruan që qenka gjallë. Se, të them të drejtën, mendja më vente gjithë në të liga!

— Kohët janë të atilla! — ia ktheu gështenjashitësi.

Këtë radhë Xeli e bëri për katër orë jo si zakonisht pesë e më tepër. Fluturonte nga gëzimi. Më në fund e kishte zbuluar se ku qe djali, pa tani do të gjente ndonjë mënyrë për ta ndihmuar.

Kur erdhi në shtëpi dhe ia tha Zikes të gjitha ç'i kishin ngjarë, ajo sa s'luajti mendsh nga gëzimi. Pastaj zunë të flisnin si e qysh të bënin. Dhe herë thoshin t'i luteshin Markos, herë kapterit, por ç'mund t'u ndihmonin ata?

Më në fund Zikja iu lut të shoqit:

— Dëgjo, burrë, po sikur të vesh t'i thuash Sefer beut? Vetëm ai mund të të ndihmojë!

— Ba-ba-ba! Po dëgjoi Sotiri, do të zemërohet. Ai s'do t'i shohë sytë Sefer beut.

— Atëherë tjetër njeri ne s'kemi se kujt t'i themi përveç atij. Ai i njeh të gjithë dhe tani që e bënë federal, i shkon fjala edhe më shumë. Po i tregove Sefer beut nja pesë verdhushka, ai kurrë nuk do t'i lërë pa marrë. Kështu që nesër nxirr kazilin në Ersekë, shite dhe shko te Sefer beu. Kur e ke xhepin plot, di si të bësh.

— Oh, sa i dhembshur qenka fëmija! Dhe në derë të hasmit të shpie. Mirë, moj

grua, po sikur të më përzërë, do të më turpërojë përpara gjithë fshatit. Pastaj do të tallen me mua.

— Le të tallen, le të bëjnë ç'të duan, ne i bëjmë të tëra këto për Sotirin, për djalin e tetes! — dhe lotët i rrodhën nga sytë.

— Ë ke të drejtë, po të humbim djalin, ç'na duhet neve jeta!

Dhe Xeli e nxori kazilin në pazarin e Er-sckës dhe e shiti mirë, në vend që të merrte pesë, i dhanë dhjetë napolona.

Sefer beu e priti fshatarin në dhomën e madhe me një buzëqeshje të lehtë.

— Ç'të kthejmë përmbys, o Xeli. Sa vjet ke që nuk je hedhur këtej nga ne? — i tha ai.

— Shumë vjet, vërtet, po, siç e di, jemi të zënë me punë dhe s'na mbetet kohë. Dhe tani nga halli kam ardhur!

— E di, e di, të kanë arrestuar djalin! — e ndërpreu Sefer beu.

— Dhe thashë, ne asnjëri nuk na njeh. Ju jeni njeri i dëgjuar, keni miq më të djathtë e më të mëngjër, e mund të na ndihmoni!

Sefer beu u mendua pak.

— Ashtu është, kam të njohur shumë dhe më dëgjojnë. Por, që të mbarosh këtë punë, duhet të qerasësh këtë, të japësh bakshishe, se kështu është kurdisur kjo botë? — shtoi ai rëndë-rëndë.

— Të gjitha harxhet i heq unë, vetëm thuaj se do të më shpëtosh djalin!!

— Dëgjo, Xeli, për këtë punë do të lypsen

nja tri-katër napolona dhe vallë do të arrijnë. Se do të japësh dreka e darka, jo tek Abdu-rrahmani, po te «Pallasi».

— Vetëm të nxjerrësh djalin nga burgu, pa dhe më shumë do të të jap. Ja, këto para i kam taksur për këtë punë!

Dhe nxori nga xhepi pesë napolona dhe ia lëshoi në dorë.

— Të premtën do të hidhem në Korçë dhe do ta mbaroj këtë punë. Skënder Çamin, kapitenin e xhandarmërisë së kuesturës, e kam mik të ngushtë dhe do të shikoj se si qëndron puna. Nuk besoj të më thotë jo! — u mburr ai.

Dhe me të vërtetë, të premtën, aty nga ora dhjetë Sefer beu hyri te hani me dy porta, ku ishte vendosur kuestura. Kërkoi Skënder Çamin dhe ai e priti, megjithëqë para tij kishte shumë njerëz të tjerë.

Si u përshëndetën me zhurmë të madhe dhe folën një copë herë për raki e për verë, për gra e për qyfyre të tjera, Skënder Çami i tha:

— Po ti, Sefer bej, nuk ke ardhur vetëm për të më parë apo jo?

— Vallahi vetëm për të të parë dhe për të të kujtuar shoqërinë tonë të vjetër. Por kam, kam dhe një punë të vogël. Ti ke mbyllur këtu një fshatarin tim, Sotir Demiri ia thonë emrin.

Me të dëgjuar këtë emër, Skënder Çami kërceu përjetë.

— Për të mos më fol. E kam këtu nja dy a tre muaj dhe më plasi shpirtin, një fjalë

s'i nxjerr nga goja, me gjithë mjetet që kam përdorur, të cilat besoj se i di se sa të këndshme janë.

— Do ta bësh për mua, do ta bësh edhe për një gjë tjetër. Po ta lirosh, do të qetësosh të rinjtë e asaj ane, se që kur e kanë arrestuar, kanë zënë të ngrenë kryet më shumë.

— Jo, jo. S'e bëj dot, për zotin! — e ndërpreu Skënder Çami dhe vazhdoi: — Ne duam me anë të tij të kapim disa komunistë, të cilët kanë kryer krime të rënda e janë tepër të rrezikshëm. Por ai jo vetëm që s'i tregon, por na bën edhe ne budallenj. Dhe disa prej xhandarëve, sidomos rojat e burgut, i ka bërë për vete. Dhe i ndihmojnë, i japin edhe bukë, edhe letrat ia çojnë fshehurazi. Pardje i gjeta dhe libra të ndaluar.

Sefer beu po e dëgjonte me vëmendje. Ai e dinte që edhe Skënderit po t'i jepje gjëkafshë do ta pranonte dhe i tha:

— Shiko, Skënder, sot të kam për drekë unë në Pallas, dua të fjalosemi më gjatë. Po këtë punë ama do të ma mbarosh.

Skënder Çami u mendua pak dhe pastaj shtoi;

— Unë mund të bëj vetëm një gjë, ta sjell këtu dhe ta pyesim për ato që më interesojnë dhe të shikojmë se ç'do të thuash atëherë.

— Mirë, — ia ktheu Sefer beu, duke pandehur se në këtë mënyrë mund t'i mbush-te prapëseprapë mendjen mikut të tij.

Skënder Çami thirri menjëherë brenda një xhandar dhe i dha urdhër:

— Sill këtu të burgosurin e qelisë 53.

— Si urdhëron, — tha xhandari dhe doli. Skënder Çami u ngrit nga karrigia ku qe ulur dhe zuri të vinte vërdallë nëpër dhomë.

Kurse Sefer beu rrinte i qetë dhe nuk i shkante mendja kurrkund përse shoku i tij po i kurdiste këtë skenë.

Pas pak hyri në dhomë Sotiri. Ishte dobësuar mjaft dhe qe i zbehtë në fytyrë. Dukej që gjatë kësaj kohe kishte vuajtur shumë. Ai qëndroi prapa derës pa folur, por i vrenjtur, sidomos kur pa brenda dhe Sefer beun.

— I arrestuar, a e njeh zotërinë i cili ka ardhur të të shohë?

— Jo vetëm që e njoh, por e di që është një tradhtar me damkë, një tregtar flamujsh. Babai i tij ishte me Turqinë, ky u bë me Zogun dhe tani me Italinë. Dhe, po të vijë ndonjë tjetër...

Sefer beu kërceu në këmbë dhe zuri të vinte vërdallë nëpër dhomë si pak më parë shoku i tij, i cili tani rrinte i qetë, me një buzëqeshje ironike në fytyrë.

Sefer beu qëndroi në vend si i gozhduar.

— E, ta lëshojmë tani? — e ngacmoi Skënder Çami.

Sefer beu mezi e përmbajti veten, nuk donte të bëhej harbut. Atë që s'bëri ai e bëri Skënder Çami, i cili iu afrua Sotirit, e

kapi për flokësh dhe ia përplasi kryet pas murit duke thërritur:

— Do të pohosh tani! Do të pohosh tani!

Të arrestuarit filloi t'i rridhte gjak nga hundët. Kapiteni i xhandarmërisë e lëshoi dhe u zbraps prej tij.

Pastaj i thirri xhandarit dhe e urdhëroi:

— Shpjere të arrestuarin në qelinë e tij.

Kur mbetën vetëm të dy miqtë, Skënder Çami i tha Sefer beut:

— Hë, ta lëshojmë?!

— Nuk e prisja të ishte bërë kaq i rrezikshëm, — ia ktheu Sefer beu.

Kshte ardhur koha e drekës dhe të dy miqtë të zënë krah për krah u nisën për nga hotel «Pallasi» për të ngrënë drekë me paratë e të atit të Sotirit.

XVII

Një mbrëmje roja e burgut i solli si zakonisht darkën, një copë bukë dhe një gavetë me lëngun e përhershëm. Ai e theu çyrekun menjëherë dhe brenda gjeti një pusullë të vogël, të shkruar me germa shtypi të imëta. që mezi lexoheshin.

«Shokë, mos u dëshpëroni! Ne përpiqemi për shpëtimin tuaj. Qëndrimi juaj heroik na bën ta ndiejmë veten kryelartë. Kemi dijeni se Italia fashiste ka ndër mend t'ju ngrejë prej këtej e t'ju hedhë në Itali. Ne bëjmë çmos për ta shmangur këtë. Por duhet të luf-

toni dhe ju brenda në burg! Përhape këtë lajm dhe te shokët e tu!

Vdekje fashizmit! Liri e popullit!»

Në atë çast muri i qelisë zuri të kërciste nga të rënat me grusht të Sotirit. Shenjat e tij u përhapën nëpër tërë burgun e kuesturës.

Të gjithë të burgosurit e kuptuan se kishte diçka alarmuese, diçka të jashtëzakonshme, por, se ç'ishte në të vërtetë, nuk e dinin. Por megjithëkëtë vazhdonin t'u binin mureve me grushte dhe s'pushuan me orë të tëra. Dhe prisnin t'i nxirrnin për pak në oborr, që të merrnin vesh se ç'kishte ngjarë.

Sotiri pa që nga larg duke u ngjitur nëpër shkallë Vaskën. Ai ecte kokulur dhe tepër i menduar. Bëri si bëri dhe u gjend pranë tij. Gjatë udhës ai nuk i dha asnjë shenjë, as nuk i foli. Po, kur dolën në oborr dhe filluan të bënin shëtitjen e tyre të zakonshme duke u rrotulluar njëri pas tjetrit në rreth të mbyllur, i pëshpëriti:

— Kemi lajme të liga. Duan të na heqin prej këtej e të na hedhin në Itali!

— Këtë nuk do ta lejojmë!

— Po hë, si?

— Të shpallim grevë urie. Menjëherë, se kushedi kur do të na nxjerrin përsëri jashtë!

— Mirë!

Dhe Vaska me Sotirin zunë të përhapnin lajmin midis të burgosurve, të cilët, sa dëgjonin, zinin të shanin, bile ndonjë ngrinte edhe grushtin përpjetë në shenjë kërcënimi.

Në oborrin e kuesturës u bë një zhurmë e madhe.

— Mjaft llafet! Ç'është kjo zhurmë që po bëni? Do t'jua presim shëtijtjen po të vazhdoni! Mjaft! Mjaft!

Po në vend që të heshtnin, të burgosurit ia filluan këngës;

*Të gjithë ne, o djema,
malit do të dalim!
Përmbi shkëmbinj e gurë,
liri do ngjallim!
Eja mblidhuni këtu, këtu, këtu,
eja mblidhuni këtu, këtu,
eja mblidhuni këtu,
bashkë me ne...*

Rojat u hodhën atëherë si të tërbuar përmbi të burgosurit dhe me kamxhikë mezi i qetësuan. Pastaj menjëherë i futën nëpër qelitë e tyre. Por dhe që andej kënga buçiti përsëri. Çdo i burgosur këndonte nga qelia e tij dhe tërë burgu ushtonte nga kënga e tyre.

— Ç'janë këto që po bëhen në burg? —
thirri Skënder Çami.

— Të burgosurit po këndojnë, zoti kapiten! — u përgjigj me druajtje një prej tyre.

— Se ç'i ka kapur sot dhe ne s'e dimë, zoti kapiten. I nxorëm pak përjashta, sipas urdhrorit tuaj, që të mos u bjerë të fikët, dhe që atje plasi kjo këngë dhe akoma s'po pushon.

Skënder Çami u mendua pak.

— Do ta kenë marrë vesh, — i tha kap-terit dhe tundi kryet.

— Po le të protestojnë akoma sa të duan, ne prapë atë që kemi ndër mend ta kryejmë, do ta kryejmë. Sonte të bëhen gati dy ma-kina dhe më të rrezikshmit do t'i nisim me-njëherë në Itali. Shenja që na dhanë na bëri më mirë sesa pandehnin ata. Prandaj, si të thashë, vepro shpejt dhe në fshehtësi të plotë!

— Si urdhëron!

Atë mbrëmje të burgosurit nuk e pranuan ushqimin dhe shpallën që të gjithë grevë urie.

Kshtu Skënder Çami tregoi se bëri mirë që kishte marrë masa aq të shpejta dhe ur-gjente. Lajmi i shpalljes së grevës nga ana e të burgosurve të nesërmen do të dilte me siguri përjashta dhe do të ngjallte pakëna-qësi në popull dhe mund të kishte pasoja të tjera të papritura.

Aty nga mesi i natës në oborrin e burgut të kuesturës hynë dy kamionë të mëdhenj dhe u ndalën afër qelive të të burgosurve, pastaj hapën kapakët e prapme e vendosën prapa tyre nga një shkallë për të hipur më lehtë brenda. Xhandarët u radhitën nga të dy anët.

Pothuajse asnjë nga të burgosurit nuk i dëgjoi. Të lodhur e të kapitur nga protesta që kishin bërë dhe nga uria që kishin shpa-llur, ata i kishte zënë gjumi i parë, një gjumë i rëndë dhe i thellë.

Nata përjashta ishte xup e errët. Asnjë yll, asnjë dritë sado e vogël nuk dukej në qiell. Edhe në oborr i kishin shuar llambat elektrike. Karabinierët e xhandarët që vërtiteshin rreth kamionëve, përdornin elektrikë dore.

Nëpër errësirën e natës u dëgjua zëri i Skënder Çamit. Pastaj hapa të shpejtë, të shqetësuar. Zunë të kërcisnin dyert e disave prej qelive. Dhe ata të burgosur që qenë caktuar për t'u deportuar i zgjonin ngadalë, pa zhurmë, u hidhnin pranga nëpër duart dhe i nxirrnin në oborr.

Të hutuar e të habitur nga tërë ato që po u ngjisnin, ata nuk ndërmoren dot asgjë, nuk treguan as më të voglin kundërshtim as kur i rrasën në karoceritë e kamionëve.

Kjo e gëzoi Skënder Çamin dhe, kur u nisën për udhë, i përshëndeti shoferët:

— Hajde, udhën e mbarë! Dhe, kur të mbërrini në Tiranë, bëni qejf se asgjë nuk na doli nga ç'prisnim!

Makinat dolën nga kuestura, morën më të majtë, kaluan pazarin, që tani qe si i shkretë dhe hynë te xhadeja e gjerë që të çon për në Tiranë.

Çdo gjë kishte mbaruar si jo më mirë. Karabinierët dhe xhandarët që i shoqëronin të burgosurit, nga katër në çdo kamion, u qetësuan dhe ata. Njëri prej tyre, i cili qe nga ana e pasme, nxori shkrepësen dhe ndezi një cigare.

Atëherë të burgosurit për herë të parë panë

për një çast njëri-tjetrin. Sotiri me Vaskën kishte zënë vend karshi njëri-tjetrit. Ata panë edhe vendet e karabinierëve dhe të xhandarëve. Dy përpara dhe dy prapa, me pushkë ndër duar dhe me bajoneta të ngulura. Ata buzëqeshën në mënyrë kuptimplote. Dhe kaq. Errësira pllakosi përsëri në kamion, se bri-zenti që shumë i trashë dhe nuk lejonte të hynte asnjë rreze drite nga jashtë.

Sotiri po llogariste kohën a qenë larg Korçës, apo jo. Dhe me vete bluante: «Tani do të jemi në Shënmëri! Tani arritëm Dunavecën!» se dëgjoi njëfarë zhurme lumi. Por edhe gjumi po e mundonte, se akoma nuk e kishte marrë veten mirë dhe, megjithëqë e kishte të qartë se po i shpinin në Itali, prapë atij i dukej sikur ëndërronte.

Kamioni i tyre ishte i dyti. Ata e kuptuan këtë, se në njëfarë vendi i pari qëndroi dhe dikë mori.

Atëherë u dëgjua zëri i shoferit të kamionit të tyre:

— O la! Pse qëndruat!

— Tani, tani do të nisemi! — iu përgjigj shoferi i kamionit të parë.

Kur u nisën, shoferi i kamionit të tyre zuri të toriste një këngë, e cila bënte fjalë për një fshat, larg në Kalabri, i cili ndodhej sipër në një breg, për shtëpinë që kishte lënë atje dhe për fqinjën e bukur që s'e harronte kurrë.

Edhe Sotirit i vajti mendja në fshat, iu kujtuan prindërit. Talia dhe psherëtiu thellë. Ndofta nuk do t'i shikonte kurrë më.

Por si udhëtuan dhe pak, njëri nga karabinierët ndezi një fener dhe e vari në anën e kabinës së shoferit, ku kishte një vend të posaçëm për të.

Karabinierët dhe xhandarët ndezën cigare. Por edhe të burgosurit qenë të kënaqur, se nuk ishin më në errësi dhe s'dinin se ç'bëhej as brenda, as jashtë. Të paktën kështu shikonin njëri-tjetrin dhe, duke u parë, sikur fjaloseshin me shikimet e tyre.

Vaska që qe kundrejt Sotirit e vështroi një herë me ngulm sikur donte t'i thoshte: «Mbahu mos u dëshpëro, dhe në rastet më të rrezikshme njeriu mund të gjejë rrugëdalje.»

Sotiri nga ana e tij sikur i përgjigjej:

«Ç'mund të bëjmë ne tani, duarlidhur, të çarmatosur, të lodhur, të kapitur e me katër cereberë të rreptë rreth e rrotull.»

Kamionët vazhdonin këngën e tyre nanuritore. Karabinierët dhe xhandarët, si pinë dhe nga një cigare, zunë dhe ata të tundnin kryet të përgjumur. Bile njëri prej tyre e vari kokën pas kondakut të pushkës që herë pas here i tundej si këmborë, gjer përposh te rripi. Pastaj e ngrinte përsëri, por nuk kalonin as pesë sekonda dhe ajo i përplasej përsëri përposh.

Sotiri ishte si i heshtur kurse Vaska, vetullngrysur, shikonte herë këtej, herë andej dhe seç bluante në kokë. Kur e pa se të gjithë rojtarët e tyre zunë të dremitnin, filloi t'u jepte shenja me sy shokëve të tjerë. Atëherë sytë e të gjithëve filluan të gjallërohe-

shin, të shkrepnin, të flisnin midis tyre, pa i penguar as zhurma e kamionëve, as ndodhja aty e xhandarëve.

Dhe ata u morën vesh te kthesa e parë të sulmonin rojet e tyre dhe të bënin tentativë për të shpëtuar.

Kamionët po e ngadalësonin shpejtësinë. Atyre sikur po u merrej fryma, domethënë i qenë qepur së përpjetës. Një nga karabinierët hapi sytë dhe pa një herë rreth e rrotull. Si u sigurua se çdo gjë ishte e qetë, zuri të dremiste përsëri.

Atëherë Vaska bëri një shenjë me dorë, u ngrit i pari nga vendi, çau brizentin dhe u hodh përjashta. Pastaj kërcyen edhe Sotiri, edhe të tjerët. Dhe në një hop nga një qetësi e plotë, karrocera prapa u kthye në një kaos që nuk merrej vesh se ç'po ngjiste.

Pastaj u dëgjuan të shtëna revolesh, zëra të mbytur, çapa të shqetësuar, fjalë shqip e në gjuhë të huaj, të thirrura, të cilat prishën qetësinë e natës.

Kur i mblodhën përsëri të arrestuarit, pesë mungonin, midis tyre qenë edhe Vaska me Sotirin. Në errësirën e natës nuk i gjetën dot, por lanë dy xhandarë t'i ndiqnin këmba-këmbës. Me ta u bashkuan dhe karabinierët që kishin marrë me vete. Kurse shoferët do të lajmëronin postëkomandën më të afërme që t'u venin në ndihmë edhe forca të tjera.

XVIII

Sotiri eci kuturu tërë natës. Mëngjesi e gjeti në një lëndinë në mes të pyllit, të lodhur, të urët dhe të veshur me setër prej të burgosuri të cilën nuk mund ta zhvishte dot ngaqë duart i kishte me pranga. Vështroi një herë rreth e rrotull, vuri vesh, por as pa, as dëgjoi ndonjë zë. Donte t'i thërriste Vaskës, por druhej nga karabinierët dhe xhandarët që u kishin rënë prapa. U përplas përdhe, u struk pas një trangu dhe e zuri menjëherë gjumi, një gjumë i thellë dhe i rëndë.

Sa fjete kështu, dhe ai vetë nuk e dinte,

por, kur hapi sytë, mbeti për një çast i habiturë pa ditur se ku ndodhej. Kaloi mjaft kohë sa e mori veten duke fshirë sytë e duke menduar për tërë ato që i kishin ngjarë. Uria që e para, e cila e përmendi. Ai u ngrit, u afrua pranë ca gurgullinjave që skuqnin përkarshi, mblodhi një grusht dhe i hodhi në gojë. Pastaj edhe një, edhe një derisa zboi pak urinë.

Tani nga t'ia mbante? Ku të vente? Cilido që do ta shikonte do ta njihte që ishte i burgosur dhe që ndiqej prej xhandarmërisë. Duheshin hequr prangat. Mori një gur dhe zuri t'u binte me tërë fuqinë e tij. Por sado që u mundua një copë herë, hekurat nuk donin t'ia dinin. Vetëm duart iu plagosën dhe zunë t'i rridhnin gjak. Si e pa që kjo që e pamundur, hoqi dorë.

Nga vendi ku kishte kaluar natën dukej vetm lëndina e vogël dhe pylli që e rrethonte. Mori prapë të përpjetën. Ai duhej të dilte medoemos në ndonjë vend të lartë nga ku të kuptonte të paktën se ku gjendej.

Ishte vjeshtë dhe pylli nuk kishte më atë freskinë e zakonshme. Kullumbritë, murrizat dhe gurgullinjat ishin plot e përplot, që, aty skuqnin, atje nxinin dhe sikur e ftonin për t'u afruar e për t'i shijuar. Dhe ai ecte, aty merrte një grusht kullumbri, atje këputte një dorë murriza dhe kështu shuante urinë.

Herë pas here ai vinte vesh dhe dëgjonte me vëmendje, se mos shikonte ndonjë njeri, apo të dëgjonte ndonjë zë. Por asgjë. Ve-

tëm kënga e ndonjë zogu, apo zhurma e ndonjë ketri e bënin të qëndronte për një hop, pastaj prapë qetësi.

Më në fund u ngjit në majë të një shkëmbi. Që aty u hap përpara tij një horizont më i gjerë. Pa fushën e Korçës, në lindje malet e Moravës. Domethënë ishte në udhë të drejtë. Po t'ia mbante gjithë nga lindja, do të dilte pas dy-tri ditësh në fshatin e tij. Jo shumë larg dalloi një çoban me një kope dhensh. Ishte me të vërtetë ky një fat i mirë.

Sotiri s'kishte se ç'të priste më tepër dhe thirri.

— E e e-ej!

Këtë e bëri kastile, se mos i lëshonte çobani qentë dhe, duke qenë larg, prapëseprapë, mund të ikte pa pësuar gjësendi.

Çobani, para se t'i përgjigjej, lidhi qentë pas një zhgëryapi dhe pastaj iu përgjigj:

— Ej, ç'je ti, more?

— Njeri jam! Shqiptar! — ia ktheu Sotiri.

— Shqiptar! Po nga të kemi?

— Nga fshatrat e Kolonjës jam!

— O, kam qenë një herë andej, në Skorovot, qeshë në një dasmë. Vend të bukur keni. Po eja de, mos ki frikë nga qentë!

Kur dëgjoi këto fjalë, Sotiri mori guxim dhe bëri për nga çobani i cili e shikonte i habitur, me sy të çakarritur dhe i shqetësuar këtë njeri me rroba prej të burgosuri dhe me pranga ndër duar.

— Domethënë ti qenke një nga ata! — tha çobani.

— Cilët? — iu përgjigj pyetjes së papritur të çobanit.

— Nga ata që i ndjekin karabinierët! Kanë pllakosur fshatin dhe kanë dhënë urdhër që çdo njeri dhe kudo që t'ju gjejnë t'ju kapin.

Sotiri u gozhdua në vend.. Tërë ajo shpresë, tërë ai gëzim që kishte ndier pak më parë, iu zhdukën,

— Ulu, ulu, — vazhdoi çobani dhe nxori nga torba një limë që e kishte për të mprehur thikat dhe daltat që përdorte për të gdhendur dhe zuri t'i priste prangat.

Këndonte lima, këndonte njëkohësisht dhe zemra e Sotirit.

— I fortë, bre, i fortë ky hekuri i breshkamanëve, — tha bariu.

Kur i mbaroi së prori dhe i flaku tutje prangat. Sotiri i dha dorën shpëtimtarit të tij:

— Falemnderit, falemnderit, shumë. Mua ma thonë emrin Sotir Demiri, nga fshati Thikës i Kolonjës.

— S'ka përse, s'ka përse. Mua më thërrisin Laskë çobani. Emrin e vërtetë e kam Iljaz Sheme, nga katundi i Voskopit, bari në fshatin e Voskopojës. Po a ke ngrënë gjësendi?

— Murriza dhe kullumbri, — e ndërpreu Sotiri.

Atëherë çobani rrëmbeu torbën, nxori prej saj bukën dhe gjellën që kishte marrë me vete, ca djathë e disa kokë qepë dhe ia shtroi përpara mysafirit.

— Me qumësht s'të kënaq dot, se dhentë shteruan.

Dhe Sotiri theu një copë bukë, mori dhe ca djathë dhe filloi të hante me aq uri dhe shije, sa nuk kishte ngrënë kurrë.

Çobani nuk e pyeti më. Por dhe Sotiri heshtte. Tani që i kishte duart të lira, zunë ta mundonin të tjera mendime. S'kishte se ku të vente gjetkë, përveçse në Thikës, dhe atje do të fshihej gjëkund.

— Nga duhet t'ia mbaj për të vajtur në Kolonjë, o Laskë? — e pyeti ai

— Ti do të ikësh malit, apo jo? Dhe sa më parë të nisesh, aq më mirë. Do të marrësh këtë qafën që shikon përpara dhe do të ecësh gjithë krehrit, krehrit, ndonjë ditë, pastaj do të dalësh në malet e Vithkuqit, që andej besoj se e njuh vendin.

— O, të dāl një herë unë atje, pastaj edhe symbyllurazi e gjej udhën.

Dhe Sotiri u ngrit nga vendi.

— Dale, more, si do të të lë unë të shkosh me këto rroba kështu. Udhës mund të takosh turli njerëzish dhe mund ta pish pas bishtit për hiçmosgjë. Pantallonat nuk të duken, po setrën hiqe. Dhe na këtë gunën time, ta kesh edhe për të fjetur.

Sotiri po e dëgjonte si i shastisur.

— Do të të jap edhe torbën me bukë, se unë do të kthehem në mbrëmje në shtëpi. Brenda do të të lë edhe këtë thikë, ta kesh si shok, se s'dihet se ç'mund të të dalë përpara!

Sotiri e përqafoi:

— Rri me shëndet, Laskë, dhe t'i shpërble-fsha një ditë,

— Ç'janë këto fjalë!

Sotiri ngriti dorën e i la shëndet dhe bëri përpjetë. Por zemrën e kishte plot, edhe me kurajë, edhe me shpresë. Dhe me këto ia kishte mbushur Iljaz Shemja, bariu i thjeshtë i Voskopojës, dhe e hidhte çapin përpara me vendosmëri dhe u zhduk shpejt nga sytë e tij.

Edhe Laska u ngrit nga vendi dhe si njeri i vuajtur që ishte i mori hekurat që kishte prerë dhe i hodhi në një hon prapa shkëmbit. Mori pastaj setrën e të burgosurit dhe e dogji në një zjarr që bëri anës burimit për t'u ngrohur dhe s'la asnjë shenjë prej tij.

Sotiri me të vërtetë do të kishte arritur në Kolonjë ashtu si i kishte thënë Laska, po, pa hedhur mirë pllajën, ai vuri re dy karabinierë, ulur në mes të sheshit, me pushkë përpjetë duke pirë duhan.

Qëndroi si i gozhduar në vend. Ç'të bënte? U mendua pak. Pastaj bëri një kthesë më të djathtë dhe u fut në një shteg në pyll për t'u ardhur rrotull.

Por edhe që këtej ai dalloj në pllajën tjetër përkarshi një trumbë njerëzish që po kalonin në radhë njëri pas tjetrit. Qe mjaft larg dhe nuk shquheshin se ç'ishin, karabinierë apo ushtarë. Sotiri u detyrua të fshihej aty atë ditë.

Të nesërmen ai nuk guxoi të merrte udhën

që i kishte treguar Laska, por mori një shteg tjetër për të dalë në majë të malit dhe që andej të shikonte se ku ndodhej.

Nuk kaloi shumë kohë dhe lart në qiell u dukën me dhjetëra aeroplanë, të cilët po fluturonin për nga lindja, ngadalë, të ngarkuar rëndë dhe me një zhurmë shurdhuese. S'kishte më asnjë dyshim. Italia kishte sulmuar Greqinë.

Në qiell u shfaq një skuadër me avionë ndjekës grekë, të cilët dalloheshin fare mirë nga shenjat e tyre me kryqin e bardhë poshtë dhe hynë në luftim me bombarduesit italianë.

Sotiri u ngrit nga vendi ku ishte shtrirë barkas dhe bëri përpjetë. Njëpër shtigjet e malit, apo njëpër pllajrat nuk dukeshin më as karabinierë, as ushtarët e djeshëm dhe ai gati sa s'fluturonte.

Nga maja e malit zbuloi se kishte arritur mbi Kolonjë. Asgjë nuk i bëri përshtypje, as fshatrat, as vendet, veç fusha e luftës.

Që nga malet e Moravës dhe gjer tutje në Pind, toka dhe qielli sikur kishin marrë flakë dhe po digjeshin. Të dy ushtritë si dy gjigantë të mëdhenj po villnin nga grykët e tyre zjarr dhe tym.

Makina dhe tanke dukeshin që nga Qarri dhe deri poshtë tek Ollmi, si gjarpërinj të zez që tërhiqeshin me një zhurmë shurdhuese për nga fushat e luftës. Andej sipër nga Furka pylli kishte marrë flakë dhe po digjej si pishë e ndezur. Tym i këtij zjarri kishte

mbuluar një pjesë të Gramozit dhe ngrihej përpjetë deri në qiell.

Sotiri u nis për poshtë me çap të shpejtë, ngjiti një të përpjetë të vogël dhe hyri në kufirin e fshatit. Dhe tani atij i dukej sikur çdo gjë po e priste si ndonjë të njohur të vjetër. Kishte dalë hëna dhe vendi dukej si në pasqyrë. Pa arrat e Mesicës. Kaloi nga ara e tyre. Iu duk sikur ajo po e ngjatjetonte: «Mirë se erdhe!» Sa herë kishte mbjellë apo korrur, sa herë kishte fjetur nën hijen e lisit, sa herë kishte ngrënë drekë anës burimit ndenjor përmbi barin e butë të Meneçikës.

Sa më tepër i afrohej fshatit, aq më shumë i shtohej edhe gëzimi. Ja, kaloi Kristoforicën, kodrën e lartë të Thikësit nga kjo anë, ku kishte qëndruar kushedi se sa herë për të kundruar xhadenë poshtë dhe automobilat që shkonin nga Korça në Ersekë, apo anasjelltas. Që këtej pa edhe Luadhet e Gjetë, burimin dhe iu kujtua ajo dita e qershorit, kur kishte puthur për herë të parë Talinë.

Duke u afruar ndiente t'i rrihte dhe më shumë zemra. Vuri re se shtëpitë, megjithëqë, tanimë dalloheshin fare mirë, asnjë nuk kishte ndezur dritë.

Kur u afrua më pranë, ai u tremb se nuk dëgjoi as ndonjë të lehur qeni, apo këngë këndesi, pëllitje, apo blegërimë bagëtie, që në fshat nuk reksin për asnjë çast. Tërë ai gëzim që e kishte zaptuar, iu kthye në shqetësim, në një ankth që i shtrengoi zemrën.

Kur hyri në shtëpitë e para të fshatit,

Sotirit iu duk sikur hynte në ndonjë vend të shkretë. Në këtë rrugë ai kishte kaluar kushedi se sa herë, njihte çdo gur, çdo portë, çdo shtëpi.

Sotiri vrapoi të arrinte sa më parë në shtëpinë e tij të shikonte se ç'kishte ngjarë. Por edhe porta e shtëpisë që e hapur kravastare, si shumë të tjera. U turr nëpër oborr pa thirrur, se dukej që edhe ajo ishte e braktisur. Hyri në ashef, gjeti shkrepësen ku e linin zakonisht, ndezi kandilin dhe filloi të hynte e të dilte nga oda në odë, por nuk gjeti asnjë brenda dhe asnjë shenjë se ç'kishte ngjarë.

Ishte i lodhur, i këputur dhe këmbët nuk i bënë për më tutje. Mbylli portën, pastaj ra të flinte në shtratin e tij të butë dhe menjëherë e kapi gjumi.

Kur doli në mëngjes, nga shtëpia, Sotiri ishte veshur me rrobat e tij, pallton e madhe, që e kishte qepur vitin e fundit në Lice të Petro rrobaqepësi. Ecte dhe kalldrëmi karciste nga këpucët e tij me prroqe. Dhe i ngjiste tani më tepër një mësuesi fshati, sesa një fshatari.

Rrugët e fshatit qenë si të shkreta. Vetëm ndonjë mace sulej nga gjëkundi, e shikonte Sotirin me sytë e saj si dy detka të zjarrta dhe futej e trembur në ndonjë portë të hapur. Oborret qenë të pafshira, gardhet të rëna, sofatet, që i mbanin në fshat aq pastër, plot me pluhur.

Mori udhën e malit, po mali ishte i gjatë e i gjerë dhe do t'i duheshin orë të tëra për t'i ardhur rrotull.

Larg diku dëgjoheshin akoma të shtëna topash dhe uturima aeroplanësh. Lufta vazhonte njëlloj.

Ecte Sotiri dhe sytë nuk i shkëpuste nga udha që kishte përpara dhe që gjarpëronte. Por edhe ajo që e zbrazët, pa asnjë lëvizje. Kur arriti aty nga Sikoveci, pa larg një njeri që po vinte për poshtë. Ishte vetëm, në sup i shquhej dyfeku. Nuk ndërroi udhë. Tani që në fshatin e tij dhe kushdo që të ishte do t'i jepte përgjigjen e duhur. Megjithëkëtë Sotiri u ul në ca gurë dhe priti derisa erdhi i panjohuri.

Ishte Pandoja, roja e fshatit.

— Ti, Sotir, qenke! Po kur erdhe kështu? — i thirri ai që larg kur e njohu. Të dy burrat u përqaftuan. Pastaj u ulën anës udhës dhe zunë të pyesnin njëri-tjetrin. — Po, si na erdhe kështu papandehur?

— Më liruan! Po ju këtej si jeni? — e ndërpreu Sotiri.

— Ne? Si gjithnjë kur ngjasin gjëra të tilla në mal. Po këtë radhë e pamë vdekjen me sy, se u ndez një luftë e madhe përmbi fshat midis grekëve dhe italianëve. Po të mos kishin ikur, do ta kishin pësuar.

— Po në ç'vend jeni?

— Te Shkëmbi i Bletës. Përmbi ujët e ftohtë.

— Po si i kam teten, babanë? — pyeti Sotiri.

— Me shëndet mirë janë. Merakun tënd kanë, — ia ktheu i kënaqur Pandoja.

Atëherë Sotiri sikur u kujtua për rojën vetë dhe e pyeti:

— Po ti, për ku kështu?

— Unë zbres përmëngjes në fshat, shikoj se si është gjendja dhe kthehem prapë sipër. Se s'ka më as postëkomandë, as xhandarë, as karabinierë, asgjë, — dhe u ngrit.

Sotiri e ndoqi rojën me sy, pastaj u nis edhe ai. Po tani ecte i qetë dhe me zemër të gëzuar.

Udha sa vinte ngjitej përpjetë e më përpjetë. Përpara Sotirit i dilnin pllajat e gjera dhe të shtruara të Gramozit, kurse më të mëngjër ngrihej si pìrg i lartë një shkëmb, një kurriz mali, i veshur me boriga të gjata e me bredha. Ishte Shkëmbi i Bletës. Dhe në skutat e tij, lugina të vogla, si oaze të blerta, në mes të shkëmbinjve dhe gurëve të bardhë. Poshtë në fshat çdo gjë qe tharë, bërë shkrumb, kurse këtu çdo gjë gjelbëronte, edhe sheshet, edhe lajthitë, murrizat dhe gurgullinjat, që atë mot mend thyheshin nga frutat e shumta që vareshin nëpër degët e tyre.

Një grua, e cila po lante rrobat te përroi, e vuri re këtë djalë që po ngjitej sipër në çadrat e tyre, i la rrobat dhe zuri ta vështronte me kujdes. Ishte Nasta, fqinja e tyre. Sotiri e njohu dhe e përshëndeti:

— Mirëdita, nënë e Vangjelit!

— Uh, ti, Sotir, je, po mirë se erdhe, mor

bir! Sa do të gëzohet Zikja e gjorë, — tha e i dha dorën.

— Ku është çadra jonë? — pyeti ai.

— Ja, ajo atje, me velenxat laragane! — ia tregoi me gisht Nasta.

Dhe Sotiri i njohu velenxat dhe, si i la shëndet gruas, bëri për andej. Nxitonte të arrinte sa me parë, për t'u bërë një befasi të ëmbël prindërve, por nuk mundi, se fëmijët që e panë dhe e njohën rendën të gëzuar për nga Xel Demiri.

— Sihariq, xha Xeli! Sihariq! Erdhi Sotiri! — thërrisnin ata.

Dhe nga të gjithë tendat zunë të zgjatnin kryet burra, gra, vajza për të parë Sotirin e Xel Demirit, që po kthehej në shtëpi, thuajse pas një viti të tërë.

Xeli i daroviti fëmijët dhe priste te dera me ankth e me zemër të ndrydhur. Kurse Zikja u lëshua përpara duke rendur, ashtu siç qe ndodhur me duart në brumë.

— Djali i tetes! Djali i tetes! — po fjalët i mbetën në grykë, e zuri lemza e nuk foli dot.

— Mos qaj, tete! Mos qaj! Ja, tani erdha!

Dhe të dy bënë për nga çadra.

Zikja dridhej e tëra si në ethe. Këmbët mezi e mbanin. Dhe po të mos ishte Sotiri, që e mbante për krahu, me siguri që do të qe përplasur përdhe.

Xeli si gjithnjë e përshëndeti të birin serioz dhe me pak fjalë;

— Epo mirë se erdhe, or djalë! Do të qe

më mirë të të prisnim në shtëpi, por edhe këtu gëzimi ynë nuk është më i vogël.

Nuk hynë brenda, se edhe nga çadrat e tjera dolën fshatarë dhe bënë për nga Xel Demiri për ta përshëndetur për gëzimin e madh që djali më në fund i qe kthyer në shtëpi.

Si edhe në fshat, edhe këtu, në krye të vendit u ulën pleqtë dhe pastaj me radhë burrat e tjerë. Të rinjtë dhe fëmijët rrinin nga fundi më këmbë.

Sotiri këtë radhë kishte nderin të rrinte në mes të Nox Kacorrit dhe Xheko Kocaqit, dy nga pleqtë më të urtë në fshat. Atij në të vërtetë nuk i rrihej këtu, do të qe me versnikët e tij me Minanë e Cingos, me Ndreçin e me të tjerët, por nuk mund t'ua prishte në asnjë mënyrë rregullin pleqve.

— E po ç'thonë andej nga Korça për luftën midis italianëve dhe grekëve, mor bir? — e pyeti xha Noxi. — E kush do të fitojë?

— Po ta zëmë nga madhësia dhe sipas armatimeve, italianët do ta fitojnë! — ia ktheu Sotiri.

— Ashtu është, këto shtetet e mëdha janë të pangopura sa më shumë të kenë, aq më tepër u duket se s'kanë. Dhe janë kail tërë botën ta zaptojnë — shtoi xha Noxi.

— Por edhe greku nuk është vetëm, ai ka prapa anglezin dhe frëngun! — shpjegoi Xhekë Kocaqi.

— Ore, që një ditë do të zihen të gjithë për gryke, do zihen. Por puna është këtu,

ç'faj kemi ne që të vuajmë nga marrëzitë e tyre! — u hodh e tha Dhosi i Maros andej nga mesi i rrethit.

— Se peshku i madh e ha të voglin! — ia priti Nox Kacori dhe shtoi: — Por s'ka më paqedashës dhe më të urtë se popujt e vegjël. Ata kanë qenë gjithnjë të shtrënguar të mbrohen dhe kurrë të mos sulmojnë. S'mbaj mend dhe nuk di që ne t'i kemi rënë ndonjë kombi tjetër. Por dhe një gjë tjetër di, që të gjithë ata që kanë sulmuar këto vise kanë ngrënë kokën e tyre.

Të gjithë sa dëgjonin i gjenin fjalët e tij sa të drejta, aq dhe të urta. Ky plak që kishte gjezdisur botën e tërë si mjeshtër, kishte parë shumë njerëz dhe kishte dëgjuar shumë fjalë me mend.

Në këtë kohë u dëgjuan të shtëna pushkësh dhe zëra që vinin nga maja e malit.

Burrat u ngritën nga vendi dhe vështruan një copë herë për andej.

Sotiri, i cili s'dinte se ç'po ngjiste, pyeti:

— Ç'është kjo?

— Atje sipër janë rojat tona dhe po na lajmërojnë se ka gjësendi, — ia shpjegoi i ati.

— Burra, rrëmbeni ç'të rrëmbeni dhe hajde t'u vemi në ndihmë shokëve! — tha xha Noxi.

Dhe kush me kopaçe, kush me sëpatë në dorë bënë përpjetë. Të rrallë ishin ata që kishin pushkë e revole.

Por nuk arritën gjer sipër, se rojat po

zbrisnin vetë me dy njerëz të huaj, që i kishin
vënë në mes dhe po i sillnin te sheshi.

Kur u takuan me burrat, Vangjeli i Nas-
tës u shpjegoi:

— Po vërtiteshin rreth shkëmbit tonë. I
pamë dhe u thërritëm të dorëzohen. Por ata
ua mbathën këmbëve! Atëherë i ndoqëm dhe
i kapëm. Se ç'janë as që e marrim vesh! Po
më duket se grekë janë.

Xha Noxi, i cili dinte greqisht, i pyeti:

— Ç'jeni ju? Dhe ç'kërkoni këtu?

— Kirie, ne jemi ushtarë grekë, kemi
humbur udhën dhe s'dimë se si të kthehemi
në repartin tonë! Jemi të urtë! A mund të
na jepni për të ngrënë?

— Bukë t'u japim ne këtyre? — u hodh një
nga rrethi. — Këta duan drunë!

— Si shqiptarë që jemi duhet të trego-
hemi mikpritës. Por për t'i besuar s'duhet t'i
besojmë, se mund edhe të gënjejnë. Sidoqoftë
hajde të zbresim te sheshi dhe atje do të
vendosim se ç'të bëjmë! — tha xha Noxi.

Dhe përsëri u nisën për udhë.

Atëherë një nga ushtarët grekë i doli për-
para plakut dhe zuri t'i thoshte:

— Ku po na shpini kështu, xhaxho? Ne
s'jemi kundër arvanitëve, ne luftojmë me ita-
lianët. Mos na vrisni!

Kur zbritën te sheshi, burrat u ndanë më-
njanë, kurse robërit i lanë më tutje. Ata u
mblodhën kokë më kokë dhe prisnin të trem-
bur vendimin e tyre.

Pleqtë e Thikësit nuk folën gjatë. Pastaj xha Noxi u afrua pranë robërve dhe u tha:

— Tani do t'ju sjellim bukë për të ngrënë dhe me t'u ngrysur burrat do t'ju tregojnë udhën për të dalë në Greqi!

Grekët, kur dëgjuan këto fjalë, zunë të falënderonin plakun!

— Ju arvanitët jeni shumë bujarë! Jeni njerëz të drejtë dhe trima! Ne s'jemi kundër jush, po kundër italianëve! Faleminderit! Faleminderit!

XIX

Që kur mësoi për ardhjen e Sotirit, Talia sikur u bë tjetër. Deri atëherë ajo që gjithnjë e menduar dhe e brengosur. Lajmi i ardhjes së tij e çeli menjëherë.

Tani për herë të parë e vështroi veten në pasqyrë dhe u tmerrua nga pamja e saj. Flokët të pakrehur, sytë me rrudha, me rrobat më të vjetra në trup. U ngrit dhe vuri një kazan me ujë në zjarr.

Drutë ishin të njoma dhe zunë të këndonin. Megjithëkëtë Talia u frynte edhe me gojë herë pas here që të merrnin flakë sa

më shpejt. Dhe tingujt e ëmbël për herë të parë i gëzonin zemrën e brengosur.

E ëma po vështronte me kujdes ç'bënte e bija! Nga një anë i vinte mirë që ajo po e merrte veten, nga ana tjetër po mundohej të zbulonte shkakun.

— Ç'do të bësh më këtë kazan ujë, moj çupë?

— Do të laj një çikë kokën, tete. Kam ditë që nuk e kam larë, — ia priti Talia.

— Mirë, mirë! — tha ajo me gjysmë zëri dhe mblodhi buzët, se ato zakonisht laheshin të shtunave; kurse atë ditë qe mes i javës.

Si u ngroh uji, Talia u fut prapa çadrës së tyre, që e kishin ndarë nga pjesa e përparme me një velencë të madhe dhe për herë të parë, pas kaq kohësh, u la me qejf.

Ajo kishte marrë një sapun myshku dhe era e tij e këndshme sikur e dehte.

Si u la mirë e mirë, ajo veshi të lintat përposh; pastaj u ul në një jastëk dhe kreu flokët një copë herë. I bëri me vijë në mes, me gërshetat mbledhur prapa.

Jeta aty nëpër pllajat e Shkëmbit të Bletës i kishte lidhur më ngushtë fshatarët midis tyre. Aty i bashkonte fatkeqësia e përgjithme, nga e cila nuk kishte shpëtuar asnjë. Pastaj ata kishin sjellë me vete edhe kafshët e trasha si dhe bagëtinë dhe, meqë nuk kishin më as çobarë, as shërbëtorë, duhej të kujdeseshin vetë për to. Në mëngjes i lëshonin nga vathat që kishin ngritur aty pranë, azat, se këtu nuk kishte as ara, as livadhe,

po vetëm musha me bar të njomë dhe mbrëmave dilnin t'i mblidhnin, t'u jepnin ujë dhe t'i mbyllin përsëri atje. Dhe kjo punë bëhej njëkohësisht prej të gjithëve dhe dukej sikur kafshët nuk qenë të njërit apo të tjetrit, por të të tërëve së bashku.

Sotiri, nga ara e tij, priste edhe ai rastin për të takuar Talinë. Ai kishte pyetur bile të ëmën për të dhe ajo i kishte thënë:

— Talia e Markos më ka ndihmuar shumë, edhe ujë më ka sjellë me çupat e tjera ngadonjëherë, edhe hajvanët na i ka ruajtur. Shumë çupë e sjellshme është. Nuk kalon kurrë pa më përshëndetur!

Sotirit i kishte ardhur mirë nga këto fjalë dhe i qe përgjigjur:

— Tani nuk do të kesh më nevojë të të sjellë ujë ndonjë tjetër. Edhe kafshët do t'i shikoj vetë.

Po e ëma ia kishte kthyer:

— Ti e shikon vetë që unë po plakem, mor bir. Duam dhe ne të gëzohemi si gjithë bota dhe të na hyjë edhe neve në shtëpi një nuse.

Sotirit i kishte ardhur turp nga këto fjalë, se e ëma kishte ndër mend Talinë, dhe ai nuk i qe përgjigjur më.

Në mbrëmje, si zakonisht, të gjithë fshatarët u lëshuan të mblidhnin gjënë e gjallë. Vajti edhe Sotiri. Ai kishte vënë Bardhor dhe lopën me vëcin përpara, kurse kalit i kishte hipur dhe po i shpinte t'u jepte ujë

anës lumit të Hasit. Ndiente diçka të gëzuar në vetvete dhe parandjenjë se do të takonte Talinë.

Fshatarë, fshatare, burra e gra venin e vinin nëpër pllajat e Shkëmbit të Bletës dhe nxitonin të mblidhnin hajvanët nëpër va-
that e tyre.

Ishte një mbrëmje e freskët dhe e kthjellët. Të ftohtët rdihej më tepër, sidomos mbrëmjeve, kur dielli perëndonte. Atëherë bredhat dhe borigat zinin të fishkëllenin nga flladi i lehtë që frynte. Edhe lumi i Hasit, që rridhte i shkumëzuar përposh, e shtonte edhe më tepër shushurimën e tij. Dhe duke sikur tërë mali këndonte.

Sotiri i la kafshët anës lumit të pinin ujë dhe po u fishkëllente që të pinin me endje. Po mendjen dhe sytë i kishte në zërat dhe njerëzit që vinin e shkonin. Dhe ja, me të vërtetë, rja pesëmbëdhjetë hapa më poshtë ai dalloi Talinë me të vëllanë, Lipen, që po u jepnin ujë hajvanëve të tyre.

I vinte rëndë të zbriste tek ata, po sytë nuk i hiqte nga Talia. Me sa kuptoi edhe ajo e kishte vënë re, se edhe Talia nuk i shkëpuste sytë prej tij.

Vajza kishte zënë për kapistre doriun; kurse Lipja nga ana tjetër po shikonte se si pinin ujë qetë dhe të dy lopët me dy viçat që u vinin pas.

Talisë i shpëtoi kali nga duart dhe re-
ndi pas tij.

Ajo i thirri të vëllait:

— Lipe, po shkoj të kap kalin! Ti ngaji
qetë përpjetë, pa të arrij unë!

Kali arriti pranë kafshëve të Sotirit dhe
qëndroi: Duke gulçuar erdhi dhe ajo:

Sotiri i doli përpara dhe i dha dorën.

— Mirë se erdhe, Sotir! — e përshëndeti
Talia.

— Sa herë kam menduar për këtë çast,
Tali, — ia ktheu ai.

Dhe ndenjën pa folur, si të qenë ma-
gjepsur, më këmbë. Rreth e rrotull tyre
kishte akoma njerëz dhe mund t'i shikonin.

Pas pak Sotiri i tha:

— Edhe tetja më tha që e ke ndihmuar
gjatë mungesës sime. Faleminderit!

— S'ka se përse të më falënderosh!

Dhe ata u harruan pas fjalëve të tyre,
sikur ishin vetëm fare anës lumit të Hasit.
Kur ra errësira dhe i ndau nga sytë e të
gjithëve ata u ulën përdhe.

Zënë dorë për dore Sotiri i rrëfeu për di-
tët e gjata dhe të mërzitshme që kishte ka-
luar në burg, për vuajtjet e mëdha, për sho-
kët e tij, për Vaskën dhe më rë fund për
ikjen dhe bredhjet që kishte bërë nga mali
në mal.

Vetëm Talisë i tregoi të vërtetën për arra-
tisjen e tij nga kamioni që do t'i shpinte në
Itali.

Kurse Talia nga ana e saj i tregoi të gjitha
ç'i kishin ngjarë në shtëpi, për Josifin e Kiço
pitropit, me të cilin donin ta fejonin, për së-

mundjen e saj dhe për marrjen e Josifit ushtar.

Sotiri e dëgjonte me nofulla të kyçura.

Në këtë kohë u dëgjua një zë që sipër.

— Tali! Oj Tali! — Ishte Markoja që kishte dalë të kërkonte të bijën.

Ajo u ngrit duke i thënë Sotirit:

— Po shkoj!

Sotiri e pushtoi me të dy duart dhe e puthi me zjarr. Po vajza u shkëput prej tij duke i thënë:

— Natën e mirë. Po më thërret babai!

— Natën e mirë, Tali! — ja ktheu ai duke e shikuar me mall.

Talia ia hipi kalit dhe i ra përpjetë. Kur arriti pranë të atit, ajo zbriti dhe i tha sikur t'i kërkonte ndjesë:

— Na shpëtoi kali, baba, dhe mezi e zura gjer atje sipër te Gurj i Madh!

Markoja, i ngrysur dhe shumë i inatosur, as që ua vuri veshin fjalëve të saj, por e pyeti:

— A e takove sonte djalin e Xelit? Se Lipja më tha që e kishte parë këtej!

— E pashë dhe unë! — tha shkurt Talia.

Atëherë Markoja ngriti dorën dhe i ra një dackë.

— Tani e tutje nuk do ta shikosh më! Ti e di që ne do të të zëmë me Josifin e pitropit dhe, po të mos ishe sëmurrur, do të qe bërë gruaja e tij. Ne kemi dhënë fjalën dhe s'mund ta kthejmë dot.

U nisën me çapa të rëndë për nga çadra e tyre.

— Megjithatë Talia qe e kënaqur që ishte takuar më në fund me Sotirin dhe ia kishte thënë të gjitha dhe e ndiente veten më të lehtë se kurrë.

XX

Kishte kohë që topa dhe të shtëna pushkësh nuk ndiheshin më në mal. Dhe avionët italianë nuk dukeshin nga këto anë. Shikoje vetëm ndjekës grekë, të cilët çanin ajrin si shigjeta dhe zhdukeshin përsëri prapa maleve të Gramozit.

Kjo qetësi i trembte edhe më tepër fshatarët që s'dinin se ç'bëhej rreth tyre e se si venin luftimet midis italianëve dhe grekëve.

Po një pasdreke Pando pendari solli që poshtë një lajm të papritur. Fshatin e kishte pushtuar ushtria greke. Italianët ishin tërhe-

qur nga Kolonja. Bashkë me ta ishin zhdukur edhe përkrahësit e tyre. Në shkollën e fshatit kishte zënë vend shtabi i intendencës së ushtrisë greke. Pando pendari tregonte:

— I madhi i tyre më thërriti dhe më tha: Ku janë fshatarët? Kanë ikur nga lufta! iu përgjigja unë. Me breshkamanët kanë ikur! m'u kanos ai. Jo, ata prej tyre kanë braktisur fshatin dhe janë fshehur në mal, i thashë unë. Atëherë sikur u zbut dhe ma ktheu: Lajmëroi të vij në se ne i përzumë breshkamarët dhe kështu si i kemi vënë përpara për së shpejti kemi për t'i hedhur në det!

Por fshatarët prapë nuk vendosnin dot të zbrisnin apo jo në fshat. Burrat biseduan gjatë dhe më në fund vendosën të vente një dërgatë për të parë me sytë e tyre gjendjen dhe për t'u marrë vesh me grekët.

Dhe u nisën për poshtë në fshat xha Noxi, si më plaku i fshatit, Xheko Kocaqi. Dhosi i Maros dhe Sotiri. Atë e morën me vete, se ishte i mësuar dhe, po të binte fjala për ndonjë gjë që ata s'dinin, të përgjigjej ai. Bashkë me ta vajti edhe Pando pendari.

Fshatarët i përcollën për poshtë me druajtje në zemër, se kushedi ç'u hipte në kokë dhe mund t'u bënin gjëkafshë, por rrugë tjetër s'kishte. Duhej të venin medoemos. Koha po kalonte dhe moti do të prishej për së shpejti, dhe për të ngrënë më keq ishin.

Kur hyrë fshatarët në fshat, ai iu duk si i huaj. Nëpër shtëpitë e tyre qenë vendosur

ushtarë grekë. Ata ishin zënë me punët e tyre dhe as ua vunë veshin fare fshatarëve. Të vrenjtur e me shpirt të ndrydhur ata arritën tek oborri i shkollës.

Roja greke i ndali.

— Ç'kërkoni, zotërinj?

— I madhi juaj na ka thërritur! — ia ktheu xha Noxi.

— Prisni këtu! — dhe hyni brenda. Kur doli, tha: — Urdhëroni!

Fshatarët një nga një ngjitën shkallët e shkollës të menduar, ato shkallë që kushedi sa herë i kishin ngjitur.

Oficeri grek, një major eshtërmadh, me mustaqe të zeza dhe me vetulla të trasha, i priti në dhomën e mësuesit ku ishte vendosur dhe i ftoi të uleshin anës gllanikut. Ai vetë ndenji në një karrige pranë tryezës, karshi tyre, që qe plot e përplot me shkresa. Në gjoks i varej një kryq i florinjte. Ai ishte tepër i kënaqur nga ardhja e fshatarëve dhe i dha urdhër ordinancës që rrinte më këmbë t'u sillte mysafirëve nga një raki. Pastaj tha.

— A e shikoni, fshatarë, Greqia e re po përsërit të kaluarën e lavdishme të Greqisë së vjetër. Ja, ushtria e mbretit Jorgo; me trimat e saj, i mundi italianët dhe e afërt është dita kur do t'i mbytim në det!

Oficeri grek do ta vazhdonte akoma tiradën e tij, por erdhi ordinanca me rakinë dhe ai e preu fjalën.

— Urdhëroni! Urdhëroni! — tha ai atëherë dhe mori edhe vetë një kupë raki në dorë. Pastaj e ngriti përpjetë e u prezantua: — Mua më quajnë Kostandinos Jorgos Papadhopollos.

Edhe fshatarët pinë nga pak dhe prapë i mbanin kupat në dorë, se nuk i kishin zbratur.

Majori e mori fjalën përsëri:

— Po ju, xhaxho, si ju quajnë?

— Jorgji e kam emrin! — u përgjigj xha Noxi.

— O, barba Jorgos, rrofsh e qofsh. e pleqëri të mbarë. Paske emrin e babait tim, ta gëzosh, barba Jorgos! — përsëriti ai me një buzëqeshje të kënaqur. — Po ju? — vazhdoi ai duke u kthyer nga fshatarët e tjerë.

Secili tha emrin e tij.

Kur e mori vesh oficeri grek se që të gjithë kishin emra siç i donte ai, shtoi:

— Emra të bukur keni që të gjithë, si tarët, emra të krishterë!

Atëherë xha Noxi i tha oficerit grek:

— I keni thënë pendarit të zbresim poshtë, por, me sa na panë sytë, nëpër shtëpitë tona kanë zënë vend ushtarët tuaj!

— Po, po; vërtet. Por unë kam dhënë urdhër të mos trazojnë asgjë. Dhe, me t'u kthyer ju, ata do të dalin që andej dhe do të venë në çadrat që po ngrenë atje sipër në kodër.

— Mirë, — tha Xheko Kocaqi, — por që

të zbresim ne nga mali, duam të dimë se ç'kushte do të na vini.

Oficeri grek buzëqeshi nën hundë.

— Çfarë kushte? Ne nuk do t'ju trazojmë ju për asgjë. Përkundrazi do t'ju ndihmojmë. Edhe tani po të keni nevojë për ndonjë gjë, më thori dhe unë do t'ju jap edhe kafshë, edhe ushtarë, të vijmë gjer sipër në mal për t'ju ndihmuar.

— Jo, për asgjë s'kemi nevojë, kemi kafshët tona, — ndërhyri xha Noxi.

— Si të doni? — ia ktheu oficeri grek.

Me kaq bisedimi mbaroi, fshatarët u ngri-tën, i lanë shëndet majorit grek dhe dolën. Në oborr Pandoja u tha burrave.

— E patë, njeri i mirë është ky greku!

— Dhëndrin më në fund e rruajnë, o Pando. Por ne udhë tjetër s'kemi, do të zbresim në fshat, se ja, dimri po na troket te dera dhe sipër në mal s'rrojmë dot! — ia ktheu xha Noxi.

— Po si shumë na u lëvdua! — shtoi Sotiri.

— Aty Ëa kam fjalën dhe unë, — e përkrahu Dhosi.

— Kështu e kanë grekët, po s'u lëvduan një çikë, s'rrojnë dot! — tha dhe Xheko Kocaqi.

Fshatarët bënë drejt e për në mal. Fshati sesi u dukej sikur nuk ishte më i tyre dhe më mirë u rrihej tani në çadrat e Shkëmbit të Bletës, sesa poshtë nëpër shtëpitë. Atë natë ata fjetën aty, po të nesërmen ngarkuar pla-

çkat, vunë bagëtinë përpara dhe si vllhët u nisën për udhë; përpara kopetë dhe pas tyre kafshët, pleqtë e plakat, bashkë me ta dhe fëmijët. Ecnin të brengosur, megjithëqë ktheheshin nëpër shtëpitë e tyre. Vetëm fëmijët qenë të gëzuar. Ata u vinin vërdallë kafshëve, rendnin mbi rrugë e nën rrugë, ndiqnin zogjtë apo ndërshenin qentë, kur shikonin të dilte ndonjë lepur nga drizat.

Karvani i fshatarëve hyri në fshat i drujtur dhe me frikë se mos gjente nëpër shtëpitë ushtarët grekë: por oficeri e kishte mbajtur fjalën dhe i kishte vendosur nëpër çadrat e posangritura.

Papadhopollosi zuri miqësi me Broqet dhe shpesh do ta shikoje të vente nga dyqani i Markos. Zinte vend në ndonjë tryezë, porosiste raki, pinte dhe pastaj zinte të fliste.

— Sot kam lajme të mira. Ushtria jonë po vazhdon marshimin e saj triumfal. Korçën e morëm dhe po i afrohem Pogradecit. Nga ana e poshtme e frontit është çliruar Gjirokastra. Edhe nga deti kemi lajme të gëzuara, një nëndetësja jonë ka fundosur një vapor ushtarak italian që donte të shkarkonte ushtarë në prapavijat tona në Sarandë. Në ajër gjithashtu ndjekësit tanë kanë rrëzuar disa bombardues të mëdhenj italianë.

Fshatarët e dëgjonin, herë merrnin pjesë në bisedime me të, herë druheshin.

Si shkoi njëfarë kohe, ushtria greke arriti deri në një vend dhe s'bënte dot më përpara. Italianët ia kishin prerë hovin e parë

dhe bile po përgatiteshin për kundërsulm. Kishte rënë një dëborë e madhe dhe operacionet ushtarake kishin ngecur. Që të dy palët po përqendronin forca të reja për të sulmuar njëri-tjetrin.

Atëherë oficeri grek u thoshte fshatarëve të dyqani i Markos:

— Vërtet që italianët na qëndruan për pak, por kjo është diçka e përkohshme. Dimri na pengoi.

Fshatarët e kuptuan që grekët ishin në gjendje të vështirë.

Atëherë Sotiri u mblodh me burrat dhe djemtë e fshatit dhe vendosën t'u venin në ndihmë grekëve. Armiku ishte i përbashkët, t'i shporrnin italianët nga viset e tyre, pastaj edhe grekët të tërhiqeshin nga tokat që kishin zënë.

Dhe pesë burra, Dhosi i Maros, Sotiri, Ndreçi i Pepos, Minai dhe Vangjeli i vajtën oficerit grek për herë të parë vetë në shkollë.

U gëzua Papadhopollosi kur i pa te dera dhe i ftoi me një buzëqeshje enigmatike brenda.

— Urdhëroni, urdhëroni, palikaris!

Burrat u ulën anës gllanikut, ku bubullonte një zjarr bubulak dhe zunë të ngroheshin duart, se jashtë ishte ftohtë.

— E po ç'ju solli këtej? Të kthejmë gjësendi përmbys! Thoni.

— Zoti Papadhopollos, një komb i vogël, kur ka të drejtë, mund të mundë dhe

një ushtri më të madhe. Prandaj kemi vendosur t'ju vijmë në ndihmë edhe ne, — ia shpjegoi ardhjen e tyre Sotiri.

Oficeri grek mblodhi vetullat e trasha. Donte të merrte vesh se ku do ta nxirrte fjalën ky arvanit i ri.

— Thoni, thoni me çfarë mund të na ndihmoni?

— Ne kemi vendosur që të gjithë burrat e fshatit tonë mbase edhe të fshatrave të tjera, të cilat mund të mbajnë armë, të formojnë tani për tani një togë dhe të luftojnë bashkë me ju kundër italianëve. Edhe kafshët jua japim në qoftë se keni nevojë.

— Bravo ju qoftë! Bravo! Këtë e prisja prej jush! — i përgëzoi greku.

*

* *

Ditë për ditë Pandoja, bashkë me një korofillak, dilnin shtëpi më shtëpi e lajmëronin fshatarët të dilnin për të qëruar xhadenë, o për t'u nisur bashkë me kafshët e tyre për të shpënë ushqime dhe armë në ballin e luftës.

Tek oborri i shkollës u mblodhën të gjithë fshatarët që kishin thërritur bashkë me kuajt dhe gomarët e tyre dhe filluan të ngarkonin plaçkat që ushtarët grekë i kishin vënë grumbull përpara shkallëve: disa thasë me oriz e me stafidhe, dy vandakë me

pushkë dhe disa me fishekë. Përveç xha Noxiti aty qenë edhe Sotiri, Dhosi i Maros dhe Xheko Kocaqi.

Si më të rinj që ishin Sotiri me Dhosin ngrinin plaçkat e rënda, kurse Xhekoja me xha Noxin u vinin vërdallë dhe u jepnin litarët për t'i lidhur.

Si ngarkuan plaçkat, i vunë kafshët përpara dhe u nisën menjëherë për udhë. Bashkë me ta ishte dhe një korofillak, por ai që hipur në kalë, me pushkë krahëve dhe i mbështjellë me një gunë të trashë, kurse në kokë kishte një shapkë, e cila i mbulonte tërë fytyrën, vetëm dy vrima kishte përpara sa për të shikuar.

Akoma nuk kishin dalë mirë nga fshati, i zuri një dëborë, e cila binte lehtë-lehtë dhe sa vinte dendësohej më shumë.

Xha Noxi, i cili vinte prapa, mezi i ndiqte fshatarët e tjerë.

Sotiri bënte ç'bënte dhe i thërriste:

— Hajde, xha Noxi! Ç'u bëre?

— Po vij, bir, po vij! — por këmbët i epeshin dhe mezi i hidhte, i rëndonin si plumb.

*
* *
*

Pas disa ditësh doli lajmi edhe në fshat, si gjermanët u kishin rënë grekëve që prapa kurrizit dhe ata po tërhiqeshin nga të

gjitha anët. Ata u ngritën edhe nga Thikësi, po natën, në errësirë dhe pa zhurmë.

Fshatarët në mëngjes e gjetën shkollën të zbratur, bile nëpër oborr kishin lënë edhe disa plaçka nga nxitimi. Por këtë radhë nuk i kishin thirrur as për t'u ndihmuar, as për angari.

Djemtë e fshatit vunë re se edhe nga Ollmi, ku kalonte xhadeja, ushtria greke po tërhiqej për nga lindja. Dhe kjo vazhdoi për disa ditë me radhë.

XXI

Fshati mbeti fare i lirë, i pavarur prej askujt, se nuk kishin as postëkomandë, as grekë, as italianë.

E para që u duk pas ikjes së grekëve nga Kolonja që ushtria italiane, e cila po vinte pa luftë. Ata qenë të shumtë dhe ditë për ditë xhadeja nxinte prej tyre nga automobilat, motoçikletat, kuajt dhe mushkat e ngarkuara, si dhe nga tanket, që bënë një zhurmë të madhe, sa tundej vendi.

Pas tyre u kthyen në fshat edhe kapteri me xhandarët dhe me të dy karabinierët italianë.

Ardhja e tyre ishte shenjë e pamohueshme se fshati po binte prapë nën pushtimin e tyre.

Sotiri rrinte me zemër të ngrirë.

— Mos e ke marrë vesh gabim, baba?

— Si, mor, e kam marrë vesh gabim, të gjitha këto i dëgjova me veshët e mi! — e ndërpreu Xeli.

— Ku të vete? Të shkoj në Ersekë, keq, që të gjithë më njohin, të hidhem në Korçë, po ashtu. Ku mund të vete? — e pyeti ai të atin.

— Do të hidhesh në Helmës, do të kërkosh Xhemalin dhe i thuaj, se më dërgoi babai për ca kohë te ti dhe kaq, s'ka nevojë për më tepër.

— Si do t'ia zë tjetrit ashtu shtëpinë?

— Po ku njihet miku? Në nevojë! Dhe hiq mos u bëj merak, Xhemali do të të presë si djalin e tij dhe do të gëzohet kur të të shikojë, — e qetësoi të birin Xeli.

Dhe që atë ditë Zikja i mbushi një torbë me plaçka e me dhurata për fëmijët dhe gratë e shtëpisë të Xhemalit dhe e nisën Sotirin për në Helmës.

Nuk kishin kaluar as dy-tri ditë prej ikjes së Sotirit nga fshati, kur u kthye edhe Sefer beu bashkë me gratë dhe hyzmeqarët dhe me rojën e tij, Muço Thekrën, i cili hiqte karvanin e tyre. Sefer beu kaloi mes për mes fshatit, me zhurmë shumë dhe si gjithnjë me kryet përperjetë. Megjithatë ai i ngjatjeto fshatarët

që takoi rrugës, bile edhe plakat që turrnin rëndur nëpër sofatet e portave.

Kjo sjellje e papritur e Sefer beut i habiti fshatarët se nuk po ia kuptonin dot as hilen, as urtësinë.

Një ditë zbriti në fshat vetë Sefer beu dhe vajti drejt e te dyqani i Markos.

Dyqanxhiu e priti me një të qeshur në buzë dhe rendi t'i shërbente sa më parë.

— Po sillna një raki rrushi, de! — tha pas pak Sefer beu dhe u ul në një tryezë afër banakut.

Markoja i nxori myshterit të madh nga rakia më e mirë që kishte dhe ia solli në një kupë e ia lëshoi në tryezë duke i thënë:

— Po pak meze të të sjell, Sefer bej! Kam ca kaçkavall nga ata të vllahëve, manure.

— Po ai i biri i Demirit a është këtu? — e pyeti pas pak. Markon, duke pirë rakinë.

Dyqanxhiu, megjithëqë e kishte inat Sotirin, nuk donte ta tregonte veten aq të lig dhe iu përgjigj:

— Këtu duhet të jetë!

— Më mirë më thuaj këtu duhej të ishte, se mora vesh që s'është këtu. Për të zbrita sot në fshat. Doja ta takoja. Ai pandeh se unë nuk e dua, se e urrej, përkundrazi unë gjithnjë i kam dashur të mirën. Bile jam përpjekur edhe ta ndihmoj. Pse iku, ë?

Markoja ngriti supet.

— E po njeriu i ikur nga burgu edhe ka frikë, se ja italianin te dera e shtëpisë e ka.

— I thua j Xelit t'i dërgojë fjalë djalit kudo që të jetë të kthehet në shtëpi, se asnjëri nuk do ta trazojë më! — shpjegoi ai.

Sefer beu e zbrazi kupën dhe pastaj menjëherë u ngrit, i pagoi dyqanxhiut rakinë dhe, duke shkuar prapë, tha:

— Tani, që thua ti, Marko, hapet një faqe e re në historinë e Shqipërisë dhe neve na lypset bashkimi i tërë popullit. Këto fjalë ua thua j edhe fshatarëve të tjerë dhe t'i mbash mend edhe ti dhe, po s'dolën kështu, të mos ma thonë emrin Sefer bej.

— Ashtu, ashtu! — iu bënte prapa Markoja duke u përcjellë deri te dera.

Kur i la shëndet dhe u largua, Markoja tha:

— Qenka bërë me të vërtetë tjetër Sefer beu! E paska kthyer pafillen!

Këto fjalë i vanë në vesh edhe Sotirit, por ai nuk u kthye veç më vonë, kur doli amnistia nga ana e italianëve për gjithë ata që kishin kryer faje para dhe gjatë okupacionit grek.

Pas amnistisë Sotiri u kthye në fshat dhe filloi të vepronte me kujdes dhe pa u ngutur. Menjëherë i mblodhi shokët e tij të sigurt dhe bashkë bënë një plan të hollësishëm. Në fillim duheshin mbledhur vetëm ata të rinj që simpatizonin idetë komuniste, që ishin të sigurtë dhe që dëshironin të merrnin pjesë në grupin e tyre, pastaj të shtonin grupin edhe me vajzat.

— Mirë de, ta zëmë se verdosim t'i thërrsim dhe ato në mbledhjet tona, po si e qysh do t'u themi? — tha Ndreçi, i cili në të vërtetë dyshonte se si t'ia nisinin.

— O, kjo është fare e lehtë, ti do t'i thushash motrës, Marigose; Minai do të thërresë Marjanën. Si të vijnë një herë ato, pastaj vetë vajzat do të thërresin njëra-tjetrën.

— Edhe unë do t'i them Nikës të vijë! — shtoi Llambi.

Në mbledhjen e tyre të parë erdhën vetëm dy vajza, Limbia, motra e Ndreçit, dhe Nikja, kushërira e Llambit. Ajo hynë të druajtura në dhomën e shkollës, që tani qe mbyllur, po që Sotiri e mori çelësin nga pendari, gjoja për të ndrequr fronet. Të gjithë u ulën veç vajzave. Ato qëndruan afër derës, sikur, po të ngjiste gjësendi, të iknin të parat që andej.

— Hajde, uluni, përndryshe nuk do të fillojmë nga puna! — tha Sotiri.

Po vajzat ulën edhe më tepër kryet.

— Hajdeni de, do rrini a do shkoni? — i qortoi Minai.

— Jo, jo, më mirë le të rrinë më këmbë dhe të jenë brenda e të dëgjojnë se ç'do të flasim, sesa të shkojnë dhe të mos dinë asgjë; — ndërhyri Ndreçi.

Atë natë Sotiri u foli të rinjve për gruan shqiptare, për trimërinë e saj, për punën e pakursyer që i jep shoqërisë, por megjithëkëto ajo është më e shtypura nga të gjitha shtresat e tjera, ajo s'ka asnjë të drejtë, ajo është si skllave.

Pastaj djemtë diskutuan njëri pas tjetrit.
Vajzat s'folën fare.

Një mbrëmje Sotiri i dha një letër Limbisë që t'ia jepte Talisë. Fjalët që kishin dalë në fshat për përgatitjen e fejesës po shtoheshin dita me ditë. Të dy palët dëshironin që ta mbaronin sa më parë këtë punë, sidomos tani me ardhjen e Sotirit.

Limbia i vajti në shtëpi për të parë shoqen e saj dhe, kur mbetën vetëm, i dha letrën e Sotirit.

Talia e rrëmbeu dhe filloi ta lexonte menjëherë:

«E dashur Tali,

Kam disa ditë që jam kthyer në fshat nga Helmësi, por me gjithë interesimin tim nuk kam mundur të hyj në lidhje me ty. Më thanë që je e sëmurë. Nga ana tjetër këtu është Josifi dhe kanë hapur fjalë në fshat se të dy familjet tuaja po bëjnë përpjekje për të shpallur fejesën. Unë s'flas dot me Josifin për këtë gjë. Jo se kam frikë, por sepse s'dua të prisim miqësinë me të ose mund të ngjasë edhe ndonjë gjë e papëlqyer. Këtë çështje mund ta zgjidhësh më lehtë vetëm ti. Merr guxim, ngrihu nga rrobat, takohu me Josifin dhe ia shpjego të gjitha. As ai, as ti nuk do të dëshironi të jeni fatkeqë për tërë jetën. Dhe jam i sigurt që ai do të të kuptojë. Gjithsesi më

lajmëro menjëherë, që të di edhe unë se si të veprojmë.

Të puth,
Sotiri»

— Uf, unë e zeza! — tha Talia si lexoi letrën dhe zuri të qante.

— Mos qaj, mos qaj! — e qetësoi shoqja.

— Si të mos qaj, moj Limbi, shiko se ç'më shkruan Sotiri! — dhe i dha letrën.

Limbia e mori dhe e lexoi.

— Mirë të shkruan. Ne vajzat gjer më sot ishim si robëresha dhe na shitnin prindërit. Që kur vete në mbledhjet e djemve sikur m'u hapën sytë. Ngrehu nga rrobat, piqu me Josifin, shpjegojta që të gjitha, si të shkruan Sotiri, dhe do ta shikosh se sa do të lehtësohesh.

Talia dëgjonte dhe qante.

Pas nja tri a katër ditësh Limbia i solli Sotirit një letër nga Talia. Ajo i shkruante:

«I dashur Sotir,

Me përpjekje të mëdha mezi u ngrita nga rrobat dhe nuk qe vështirë për mua të piqem me Josifin. Këtë takim ma rregulluan vetë prindërit e mi dhe na lanë të fjalosemi. Më vinte shumë keq për të dhe s'dija se si të filloja. Por më në fund nisa e ia thashë të gjitha, të gjitha. I hapa dashurinë tonë, si u shtira e sëmurë para se të nisej ushtar. Dhe për letrën tënde të fundit i fola. Ai nuk m'u zemërua mua, por më tha: «Çfarë shoku

qenka Sotiri, i cili i di të gjitha këto dhe s'më ka thënë asnjë fjalë gjer tani?» Për këtë nuk të shfajësova dot. Tundja vetëm kokën. Por të shkruaj që të dish, se ai vetë do të të takojë dhe do të të thotë. Më në fund vendosëm që hëpërhë të mos u themi gjësendi prindërve. Ai do të kthehet prapë në kazermë në Tiranë. Do të rrijë atje edhe një vit. Gjer atëherë të gjitha do të rregullohen, kam shpresë.

Të përqafoj e të puth,
Talia»

Josifi i Kiço pitropi u nis që të nesërmen për në Tiranë, gjoja kishte marrë telegram urgjent për t'u kthyer dhe Sotiri nuk pati mundësi të takohej me të. Fejesa u shty për herë tjetër pa asnjëfarë shpjegimi.

Ngjarjet atë vit zhvilloheshin jo me ditë, por me orë. Po atë mbrëmje Ndreçi i Pepos u kthye nga Erseka ku kishte vajtur në pazar dhe në vend që të kthehej në shtëpi të tij, u drejtua për nga Sotiri. Zikja e ftoi të hynte brenda e ta priste.

— Nuk kam kohë, nënë e Sotirit, nxitohj. Po ku është? — e pyeti ai.

— Vajti t'u japë ujë hajvanëve! — ia ktheu ajo.

Ndreçi rendi për nga çezma.

Sotiri ishte me të vërtetë atje.

— Ç'kemi, Ndreçi? — e pyeti ai me ta parë.

— E ç'të kemi?! — u përgjigj i dëshpëruar ai.

— Thuaj de, ç'ka ngjarë?

— Gjermania ka sulmuar sot Bashkimin Sovjetik!

Pas disa ditësh Sefer beu zbriti në fshat bashkë me nja dhjetë a pesëmbëdhjetë veta pas, midis të cilëve shquhej edhe Muço Thekra, që të gjithë të armatosur gjer në dhëmbë. Ai i mblodhi të gjithë burrat tek ahuri. Donte me gojën e tij t'u rrëfente se ç'kishte ngjarë. U radhitën aty, pleqtë rdënjur këmbëkryq, kurse të rinjtë më këmbë prapa tyre. Aty ishte dhe Sotiri midis djemve të fshatit. Sefer beu ishte ulur përmbi bërrucën e tij të trashë dhe dukej sikur që përmbi të gjithë burrat. Ishte buzagaz dhe fjalët i dilnin vetë nga goja dhe, meqë të tjerët vetëm dëgjonin, i dukej se ato që thoshte ai qenë me të vërtetë të pëlqyera e të urta.

— Hë, tani të shikojmë se ç'do të thonë komunistët. Tani do t'i ulin petkat dhe këta çiliminjtë tanë që duan të prishin vatanin me budallallëqet e tyre. — Dhe padashur i hodhi sytë nga Sotiri, por jo me zemërim, por me një lloj qortimi. Pastaj vazhdoi: — Vendi i shqiptarit është në traditat e tij patriotike, ashtu siç kanë luftuar baballarët tanë. Por natyrisht kur të vijë koha, se hëpër-hë kombet e mëdha akoma s'kanë marrë anë. Të shikojmë nga do t'ia mbajë dhe Amerika. Pastaj që të gjithë do të ngrihemi si një njeri i vetëm dhe do t'i biem armikut. — Si e pa që e zgjati shumë dhe asnjëri nuk

po e merrte fjalën, shtoi. — Po thoni dhe ju diçka de!

— Ç'të themi ne, kjo është e qartë! — e përkrahu Markoja.

— E qartë, e qartë, po thuaj, o Marko, me kë je ti, me komunistët, ajo me patriotët?

— Me komunistët! O zot, na ruaj! — ia këtheu Markoja.

Po Xheko Kocaqi, që qe afër Markos, tha:

— Po dhe vend i madh është ai Rusi, a Sefer bej!

Sefer beu nuk iu përgjigj këtyre fjalëve. U kthye nga Sotiri dhe papritur e pyeti:

— Po ti, Sotir, ç'do të thuash?

— Unë do të them, Sefer bej, me këto fjalë që thoni ju sabotoni luftën e popullit shqiptar.

Shokët e Sefer beut ngritën kryet dhe vështruan sikur prisnin ndonjë urdhër. Muço Thekra bëri të ngrihej, por beu e ndërpreu me një të parë.

— Shiko, Sotir, ti je djalë i mësuar dhe ke influencë te njerëzit në Kolonjë, sidomos në radhët e rinisë. Bashkohu me ne patriotët e vërtetë dhe kështu i shmangemi vëllavrasjes.

— Kështu them edhe unë, Sefer bej, ha-
jde me ne të rrëmbejmë pushkët dhe të luftojmë kundër okupatorit dhe të gjithë tradhëtarëve të tjerë, të çdo lloji qofshin. Ja këtë e quaj unë patriotizëm të vërtetë.

Fshatarët po e dëgjonin me vëmendje dhe

me druajtje këtë duel të zjarhtë fjalësh. Dhe çuditëshin ku i gjente djali i Xelit këto fjalë kaq me vend, saqë Sefer beu nuk mund t'i përgjigjej dot.

— Ne jemi komb i vogël dhe nuk duhet të nxitohemi, duhet të presim se ç'do të bëjnë dhe kombet e tjera të mëdha, atëherë do të hidhemi në luftë!

— E di si u thotë populli këtyre fjalëve? «Prit, gomar, të mbijë bar!»

— Dëgjo, Sotir, këto që thua ti, janë fjalët e komunistëve. Unë të dua, pa të them, ja këtu përpara burrave, eja me ne.

Sotiri heshte.

— Unë s'dua të të shtrëngoj të përgjigjesh medoemos tani, por mendohu, mendohu dhe, kur të vendosësh, eja tek unë dhe do të të pres si mik të shtrenjtë! — ia ktheu ai me një buzëqeshje të shtirë.

— Po dhe bujar është ky Sefer beu! — thanë disa fshatarë.

— O bujar, o dinak! — u përgjigjën disa të tjerë.

Beu ishte ngritur bashkë me njerëzit e tij dhe kishte marrë rrugën për në Qafëzez, për të lajmëruar fshatarët edhe atje se ç'kishte ngjarë në botë dhe ç'anë duhej të mbanin.

XXII

— Baba, kam ndër mend të hidhem gjer në Korçë — i tha Sotiri të atit pasi mbaruan punët e rënda të stinës, korrjet e shirjet.

Xeli nuk e pyeti as përse dhe për çfarë donte të vente në qytet, se ai e merrte me mend këtë gjë, por vetëm shtoi.

— Mirë, more djalë, vete që vete, merr dhe ndonjë barrë elb dhe shite. Të kemi ndonjë para në xhep, se, si janë kohët, s'dihet se ç'mund të vijë.

Ndërsa i ati fliste, Sotiri mendonte:

«Kam kaq kohë që s'kam vajtur në Korçë?! Kushedi se ç'bëhet andej. Si venë punët vallë? Kushedi se ç'thonë shokët për mua. U tremb dhe hoqi dorë nga lufta! A do ta takoj dot Vaskën? A është gjallë apo jo?!»

Dhe gjatë udhës këto mendime nuk i shkëputeshin nga mendja.

Nuk u kthye si zakonisht te hani i Sherafit, por bëri drejt pazarit të drithit shkarkoi barrën në një vend, pastaj kalin e shpuri mënjanë, e lidhi në një hekur magazine që ndodhej aty pranë dhe u kthye menjëherë te vendi ku kishte lënë thasët, u hapi grykat dhe u ul pas tyre, përmbi gunën që kishte lëshuar përdhë.

Atëherë zuri të shikonte me kujdes rreth e rrotull. Tregu i drithit ishte plot njerëz. Megjithëse që kohë lufte dhe trazirash, njerëzit kishin zbritur në qytet kush për të shitur, kush për të blerë, se nevojat dhe hallet qenë shtuar edhe më shumë. Sotiri u hodhi një sy fqinjëve që kishte pranë. Më të djathtë një devolli, të cilin e njohu menjëherë nga rrobat e tij, kurse më të majtë kishte zënë vend një shule, nga ata të Prespës.

— Sa shkon elbi sot? — pyeti Sotiri.

— Një gjysmë leku për okë.

— Si lirë më duket, — e ndërpreu Sotiri.

— Kështu shitet në vaktin e lëmit, për dhiamë qeni. Ç'të bësh, halli të shtyn ta she-sësh, halli të shtyn ta blesh, — tha i merakosur devolliu.

Sotiri e ndërpreu fjalën, se para tyre po afrohej patrulla që ruante tregun. Një oficer përpara dhe dy karabinierë vinin me hap ritmik pas tij. Ai zuri t'i shikonte me vërejtje. Oficeri sikur i kujtonte diçka, ecja e tij, qëndrimi i trupit. Iu duk i njohur. Karabinierët me shirita të bardhë supeve dhe me shapka si lundra të gjera në kokë ecnin dhe herë pas here kthenin kryet më të djathtë e më të majtë, sikur donin të trembnin fshatarët.

Sotiri nuk i hiqte sytë nga oficeri. Sa më shumë afrohej, aq më tepër i bëhej e qartë se cili ishte dhe mendime të këqija i kalonin nëpër kokë. Me vete thoshte: «Si s'e mora revolen me vete? Të paktën nuk do t'i bija në dorë kaq lehtë këtij qeni.» Oficeri e ngadalësoi hapin dhe po e shikonte me vërejtje. Patrulla kaloi pranë tyre pa qëndruar.

— Mor, po cili është ky oficer? — pyeti ai devolliun.

— Nuk e njeh ti? Ai është Skënder Çami.

Sotiri nuk foli. Sytë e tij kaluan te ca studentë të Shkollës së Mesme Mbretërore, siç ia kishin kthyer emrin Liceut, veshur me rroba të rinisë fashiste, avanguardistë. Midis tyre një zeshkan, iu duk si më i vjetër dhe i ngjau si Vaskë Teli. Dhe ai tha me vete: «Sa budalla që jam! Po a i vesh Vaska këto lecka!? Sa keq që mendoj dhe unë.» Pastaj shtoi: «Eh, ku katandisi rinia jonë.» Një revole krisi aty pranë e ia preu mendimet. Kur u afrua pranë grumbullit që ishte mbledhur pas qoshes së parë, pa që oficeri, i cili kishte kaluar pak

më parë aq serbes e krenar, po dergjej i vrarë përmbi kalldrëmin e rrugës, nga ata të rinj, që kishin kaluar duke qeshur pas tij.

Pazari u bë rrëmujë. Pas pak pllakosën nga të gjitha anët karabinierë e xhandarë dhe kapnin kë të gjenin përpara.

Sotiri, i cili e kishte lënë kalin pranë, e ngarkoi elbin me ndihmën e devolliut dhe bëri për nga hani i Sherafit, e shkarkoi drithin atje, e la mënjanë, lidhi kalin pas një rrezeje në oborr dhe rendi përpjetë varoshit e mori më të djathtë. Këtu qenë një sërë dyqanesh të vogla, midis të cilave dhe ai i Petro rrobaqepësit.

Sotiri hyri brenda dhe qëndroi përpara ustait, i cili po punonte në një makinë qepëse dhe nuk e kishte ndier fare hapjen e portës.

— Mirëdita, — e përshëndeti Sotiri.

Atëherë ustai ngriti kryet dhe e vështroi. E njohu menjëherë dhe thirri:

— Sotir, po nga dole kështu?

E la punën menjëherë, u ngrit dhe të dy burrat u përqaftuan.

— Haje, ulu ulu!

Dhe ndenjën në dy frona karshi njëri-tjetrit.

— Po ç'u bëre, more Sotir? Ti humbe fare, — vazhdoi rrobaqepësi.

— Humba vërtet, shoku Petro, por ashtu ishte puna! — tha Sotiri si për t'u shfajësuar.

— I di, i di të gjitha dhe s'ka se përse të justifikohesh, më kanë folur për ty dhe për punën që ke bërë dhe po bën.

— Asgjë s'bëjmë ne, ju këtu i luani ferë fashizmit, përpara syve të mi pashë se si vranë sot në pazar Skënder Çamin, — e ndërpreu Sotiri.

— Domethënë mori fund dhe ky aksion!
— shqiptoi si në vetvete Petroja.

— Që andej po vij, nga pazari i drithit. U mbush pazari plot karabinierë e xhandarë,
— vazhdoi Sotiri.

— Duhet të nxitojmë, — e ndërpreu Petroja, — se ata me siguri do të kalojnë edhe këtej. Këtu puna vete mirë. Në Korçë kemi shumë të rinj që kanë dalë në ilegalitet dhe kanë formuar njësite guerile.

— Shoku Petro, — e pyeti atëherë Sotiri, — a ke dëgjuar gjësendi për Vaskë Telin?

— Unë di këtë, që Vaskë Telin është shëndoshë e mirë dhe ka dalë edhe ai ilegal.

— A e di që sikur e njoha midis atyre që shtinë kundër Skënder Çamit?

Petroja puliti sytë në shenjë që edhe ai mund të ishte, por edhe mund të mos ishte.

— Kemi lajme të mira! Bile për së shpejti do të kemi një lajm shumë shumë të gëzuar.

— Do të themelohet Partia, — shtoi Sotiri.

— Kaq mund të të them për tani! Por ju si veni andej nga Kolonja? — pyeti ai.

Sotiri tha me zë të dëshpëruar:

— Pak kemi bërë.

— Si, mor, pak? Ju keni formuar grupet komuniste, keni luftuar me vendosmëri kundër urdhrave të fashistëve, u keni bërë ballë të

gjitha intrigave dhe kërcënimeve të Sefer beut, keni afruar vajzat që është çështje me shumë rëndësi për luftën tonë dhe për çlirimin e gruas në përgjithësi. Kurse ti më thua, pak. Ju keni bërë shumë dhe vazhdoni ashtu: sig keni vepruar deri tani. Udhëzime të reja do të merrni nga ne, por edhe më tepër do t'ju vijjnë pastaj, direkt nga Komiteti Qendror! Zëri i tij do të dëgjohet në tërë Shqipërinë dhe udhëzimet e tij do të zbatohen prej të gjithëve.

Sotiri s'pyeti dot më tepër, se në dyqan hyri një djalë i ri, i cili i tha Petro rrobaqepësit me ngadalë:

— Zoti Petro, po afrohen këtej ca njerëz të dyshimtë!

— Faleminderit, Kole, — iu përgjigj Petroja.

Dhe djali menjëherë doli jashtë.

— Tani, Sotiri, duhet ta mbyll dyqanin. Këtë djalin e kam vënë të ruajë, se i njeh që të gjithë. Hajde, udhën e mbarë dhe për çdo gjë të kesh mund të drejtohesh tek unë, ose dhe te Josofi nga Vodica, që tani është mësues në Rehovë.

— Faleminderit, — mundi të thoshte Sotiri, u përqaftua me mallëngjim dhe doli.

S'kishte bërë mirë as dy hapa, kur tre veta hynë te rrobaqepësi. Sotiri u tulat pas qoshes së rrugës dhe atje priti disa minuta.

Por edhe ata s'qëndruan shumë brenda. Dolën që të tre dhe Petro rrobaqepësi filloi prapë punën.

Sotiri bëri po atë rrugë që kishte bërë pak më parë dhe u kthye te hani i Sherafit. Iu lut hanxhiut t'i blinte elbin, por ai nuk donte. Më në fund Sotiri ia uli çmimin një çerek leku për okë dhe ai e bleu.

Pastaj Sotiri ia hipi kalit dhe menjëherë bëri për në Thikës.

XXIII

Sotiri u kthye në fshat i entuziazmuar. Mblodhi menjëherë grupin dhe u foli për takimin që kishte bërë me Petro rrobaqepësin dhe për lajmin e gëzuar që pritej të shpallej me sot me nesër. U tregoi dhe për vrasjen e Skënder Çamit që e kishin bërë pjesëtarët e njësitit ilegal të Korçës.

— Hë, më u lumtë korçarëve, de. Po ata gjithnjë kanë qenë të parët! — tha Dhosi i Maros.

— Hajde të vrasim dhe ne nënprefektin e Ersekës! — shtoi Vangjeli i Nastës.

— Duhet bërë diçka, duhet bërë! — vazhdoi edhe Minai.

— Ne të vrasim Sefer beun, që na rri si skifter përmbi krye! — tha Llambi.

— Ore, ç'flisni kështu, ne nuk jemi hajdutë që të plaçkitim e të vrasim kë të gjejmë në udhë. Ne duhet të kemi direktiva për këtë. Përndryshe do të na akuzojnë si anarkistë dhe populli do të largohet nga ne. Kini durim dhe pak, pa edhe ajo ditë do të vijë dhe siç duket nuk do të jetë e largme.

Grupi i pranoi fjalët e Sotirit dhe u shpërndanë disi të qetësuar.

Po atë ditë ai nisi edhe Llambin për udhë, me dy pusulla, njërën për Rakipin e Mane Qafëzezit, një shokut të tij, i cili e kishte lënë shkollën se i ati nuk e mbante dot, dhe tjetrën për xha Xhemalin në Helmës. Që të dyve u shkruante për vrasjen e oficerit fashist, që e kishte parë me sytë e tij në pazarin e drithit, kurse Rakipit i jepte edhe disa udhëzime për grupin e tij në Qafëzez.

Sotiri iu vesh me ashk edhe punës me grupin e të rinjve në fshat, sidomos me vajzat që tanimë qenë shtruar dhe vinin rregullisht, fshehur prindërve të tyre. Kështu filloi të vinte edhe Talia.

Një mbrëmje Talia, në vend që të shkonte bashkë me shoqet e saj, bëri si bëri dhe qëndroi më prapa. Edhe Sotiri u nda nga shokët e tij dhe e arriti Talinë në mes të udhës.

Pastaj ata morën një rrugicë të errët e të fshehtë dhe të zënë për dore bënë për nga shtëpitë e tyre, që i kishin në një mëhallë.

Ecnin dhe nuk flisnin. Nuk kishin nevojë për fjalë, se duart e tyre që i kishin pleksur sa u dhembnin, flisnin më tepër se çdo gjë tjetër.

Talia kishte kohë që donte t'i thoshte diçka Sotirit, por druhej dhe nuk gjente rast të vulltshëm.

— Kam ditë që mendohem, Sotir, të të them diçka.

— Fol, Tali, mjaft fola unë gjer tani, thuamë dhe ti gjësendi!

— Unë e di që edhe ti e do atë që do të të them unë, se edhe ti ma ke shfaqur vetë po... — tha e ngeci.

— Mos më mundo, Tali, fol, fol pa druajtje. Ne jemi aq të afërt, sikur jemi njësoj burrë dhe grua.

— Ja, këtë doja të të thosha edhe unë, se ne jemi aq të afërt si burrë dhe grua, — përsëriti ajo dhe shtoi: — Atëherë hajde të mar-tohemi dhe të bëhemi burrë dhe grua me të vërtetë.

Këto fjalë e zunë ngushtë Sotirin. Ai i përgjërohej se e donte gjer në vdekje, kurse tani duhej t'i thoshte se kjo ishte e pamundur. Dhe në vend që t'i përgjigjej, ecte i menduar nga fjalët e urta të Talisë.

— E shikon? Pse nuk përgjigjesh, Sotir? — e pyeti ajo.

Duart e Talisë sikur zunë të shqiteshin nga

pak nga duart e tij. Por Sotiri e shtrëngoi edhe më me forcë.

— Besomë, Tali, për ty jam gati të jap edhe jetën, jo për t'u martuar, që do të jetë gëzimi im më i madh, por tani kohërat janë të trazuara, brenda në shtëpi kemi armikun, ne i jemi përveshur një lufte kaq të madhe, e cila kërkon sakrifica mbinjerëzore. Martesa jonë tani do të jetë pengesë për të gjitha këto.

Talia e dëgjonte dhe e kuptonte, por megjithëkëtë nuk e mbajti dot mallëngjimin e saj.

— Ne do të vazhdojmë luftën së bashku, do të luftojmë të dy krah për krah, ashtu si thua ti.

Talia qeshi hidhur. Sotirit nuk i shpëtoi dhe e pyeti disi i trembur.

— Tali, fol, çfarë ke?

— E shikon, Sotir, që gruaja nuk është barabar me burrin, ja unë të bëra këtë propozim dhe ti ma hodhe poshtë, kurse, po të ma kishe bërë ti, unë kurrë nuk do të guxoja, çfarëdo shkakut të kisha.

— Edhe unë nuk ta hedh poshtë, Tali, ne do të martohemi kur të mbarojë lufta, kur të jemi të lirë, atëherë do ta ndiejmë edhe më tepër lumturinë, edhe më tepër dashurinë tonë, se nuk do të kemi më qiell të vrenjtur, si këtë të sotmin.

Ecën prapë një copë herë pa folur sikur shkelnin mbi mendimet dhe ndjenjat e tyre.

— Më duket sikur nuk do të martohemi kurrë! — e prishi prapë qetësinë Talia.

— Do të martohemi, por tani, si të thashë, është e pamundur, Tali. Më duket se, po të martohemi, ose ti ose unë do t'i shmangemi luftës.

— Ashtu është, Sotir, po ne gratë jemi më të dobëta dhe për këtë të kam zili ty që je kaq i fortë!

Një hije që u duk përpara tyre i bëri të ndaheshin papritur.

— Natën e mirë, Sotir.

— Natën, Tali!

Sotiri priti një copë herë sa u zhduk Talia nëpër errësirë. Pastaj me hap të rëndë e i menduar bëri për nga shtëpia. Por nga mendja nuk i dilnin fjalët e Talisë. Sa e ndërlikuar që i dukej jeta. Ëndrra e tij tani mund të realizohej fare lehtë, se ishte Talia ajo që do të bënte edhe sakrificën më të madhe, të braktiste shtëpinë dhe të lidhte jetën me atë që dashuronte. Kurse ai e kundërshtonte dhe e këshillonte të priste, që të vinin ditë më të mira.

Nga mesi i nëntorit filluan shirat. Koha që ftohur akoma. Fshatarët tani merreshin më tepër me kafshët dhe bagëtinë. Duhej t'i grazhdonin, t'i krihnin, t'i çonin për ujë dhe, kur u mbetej kohë, hidheshin nga dyqani i Markos. Aty loznin letra e bënë muhabet me njëri-tjetrin. Edhe Sotiri bashkohej me ta. Aty shpërndaheshin të rehat e ditës, se si venin luftimet në frontet e ndryshme, sidomos në Bashkimin Sovjetik. U fliste Sotiri dhe disa e

dëgjonin me vëmendje, por Markoja dhe pitropi gjithnjë i vinin kundër.

— Kur të bëhet deti kos, më thërrit dhe mua dhe më jep një lugë që të hamë bashkë, o Sotir.

— Do të bëhet, xha Marko, do ta shikosh, por nuk e di se a do të ketë lugë edhe për ty, se gjer tani ke ngrënë mjaft nga kosi ynë! — dhe që të gjithë qeshnin.

— Kush do ta bëjë, more? Leckamanët — tallej pitropi.

— Do t'i dëgjoni zënë se kush do ta bëjë! — e kundërshtonte Sotiri.

— Ngordhi gomari, o Sotir, dhe s'ngjallet dot më, tani që Rusia bolshevike nuk di se nga t'ia mbajë, Gjermania do ta zaptojë tërë botën, — shtonte Markoja.

— Mor po ç'na intereson neve se kush do ta zaptojë botën, ne do të shikojmë veten tonë, që vjeshta s'ka dalë mirë dhe hamba-rët i kemi trokë. Punë s'ka, katandi s'ka. Na e pinë gjakun qeveria e bejlerët dhe afendikonjtë, — thoshte Dhosi i Maros.

— Rusia është e madhe dhe atë tokë që i ka zaptuar Gjermani është njësoj sikur e ka cimbidhur një çikë për veshi! — vazhdonte fjalën e parë Sotiri.

Dhe muhabeti vazhdonte kështu gjer vonë, por asnjëra anë nuk dorëzohej.

Në shtëpi, kur Sotiri mbetej vetëm, mendja i rrinte te fjalët e Petro rrobaqepësit. Mos kishin dështuar vallë të gjitha përpjekjet që qenë bërë për t'u bashkuar grupet e ndry-

shme komuniste? Apo mos i kishin zbuluar dhe i kishin kapur?

Nuk duroi dhe të mërkurën e parë u nis për në Ersekë të takohej me Sifin dhe me shokët e tjerë, të pyeste dhe ata, së mos dinin gjësendi.

Jošifi ditëve të pazarit gjithnjë zbriste nga Rehova në qytet për t'u takur me shokët. Sotiri e dinte se ku mund ta gjente dhe vajtji drejt e te dyqani i Çome Vodicës. Dhe me të vërtetë ai qe atje.

U përshëndetën të dy shokët dhe, meqë brenda kishte edhe myshterinj të tjerë, dolën jashtë.

Qyteti i vogël ishte plot e përplot me pazarakë. Të mërkurave aty mblihdeshin që të gjithë fshatarët e rrethit dhe këmbenin me njëri-tjetrin prodhimet e tyre.

Ëcnin të dy shokët zënë krah për krah, por nuk fjaloseshin. Secili ushqente mendimet e tij dhe qenë të kënaqur që ishin takuar dhe po shëtisnin së bashku rë mes të njerëzve.

Përkrah tyre kaluan edhe disa patrulla karabinierësh, të cilët, kur i shikonin këta dy burra të veshur allafirënga, në mes të fshatarëve, i vështronin me një lloj dyshimi.

Të dy shokët u kthyen te kafeneja e Taqit dhe zunë vend në një tryezë andej nga fundi, mënjane.

Si u ulën karshi njëri-tjetrit, Sotiri i cili s'kishte durim, e pyeti.

— E, mo Sif, s'kemi ndonjë lajm?

Sifi buzëqeshi dhe me atë zërin e tij të ngrohtë iu përgjigj.

— Do të të them lajmin më të madh që di gjer më sot. Kemi Partinë tonë Komuniste të Shqipërisë!

— Jo, more, qëkur kështu? — vazhdoi i tronditur Sotiri.

— Më tetë të këtij muaji është themeluar në Tiranë.

— Po kush të tha?

— Jo vetëm më thanë, por më kanë dërguar dhe thirrjen e Partisë, që i drejtohet popullit.

— Aman, more Sif, ma jep një çikë ta lexoj!

— Nuk e kam me vete, e kam në fshat, nuk guxova ta marr, jo nga frika, por mos na e zënë dhe pësojmë ndonjë dështim këtu dhe turpërohemi që në fillim.

— Po ç'thonë?

— Shumë gjëra, do ta lexosh dhe do të habitesh!

— S'kam durim, do të vij ta marr në Rehovë.

— Mirë, po jo ta marrësh, po ta kopjosh e ta shumëfishosh e t'ua japësh edhe shokëve të tjerë.

— Atëherë hajde të nisemi? — tha Sotiri.

— Dale, o Sotir, s'ua kam thënë akoma dhe të tjerëve, — ia ktheu Josifi.

Në këtë hop erdhi kamerieri. Sifi se ç'i tha në vesh. Ai buzëqeshi.

— Domethënë dy kafe me pak! — tha ai dhe u largua.

— Është djalë i mirë, anëtar i grupit tonë, ia dhashë lajmin, prandaj qeshi ashtu.

Në kafene hyri Miço Lofata, një burrë i gjatë dhe thatim, që në Ersekë e njihrin që qe bashkëpunëtor i fashizmit.

Sifi e ndërroi muhabetin dhe, që ta dëgjonte Miçoja, tha me zë të lartë:

— Sivjet e kemi programin shumë të ngarkuar. S'na mbetet kohë të zbresim dhe gjer në qytet, por sot më kishte thërritur inspektori dhe i kam lënë nxënësit të lirë.

Si hodhi një vështrim rreth e rrotull, Miçoja doli menjëherë nga kafeneja.

Kamerieri, i cili gjatë kësaj kohe solli kafetë, tha:

— Kërkon rdonjë viktimë, qerratai!

Pas pak hynë në kafene Hasan Selenica me Adem Radovickën. Dukej që edhe ata kërkonin Sifin, se, me ta parë, u drejtuan për nga ai.

— Epo, hajde gëzuar! — thanë ata me të arritur te tryeza e tyre.

— Me ju të gëzuar! — u përgjigjën Sifi e Sotiri dhe që të katër burrat u përqaftuan.

— Hajde, kush do të qerasë tani? — tha me të qeshur Sifi.

— Që të gjithë do të qerasim! — u përgjigjën me një zë të tjerët.

Sifi, serioz, vazhdoi:

— Tani duhet ta bëjmë punën më të organizuar. Neve na bie barra të bashkojmë të gjitha forcat përparimtare dhe t'i hedhim në kryengritje të përgjithshme ashtu siç na bën thirrje Komiteti Qendror i Partisë sonë!

Sipas shenjave dhe në rrethin e tyre do të organizohet për së shpejti komiteti qarkor i partisë dhe atëherë puna do të vihej në vijë, por tani për tani lidhjet do t'i mbanin me ata persona që njihnin si komunistë dhe me grupet e lirisë.

Sifi me Sotirin morën rrugën e Rehovës se Sotiri do të kthehej në Thikës.

Kur e mori në dorë thirrjen e Partisë në fletën e shaptilografuar, Sotirit iu duk sikur kishte rdonjë relikto përpara. E lexoi njëherë, pastaj edhe një herë dhe tundte kryet nga gëzimi.

— E, si të duket, Sotir?

— Zjarr, zjarr! Me këto fjalë s'ka se si të mos e bashkojmë popullin dhe të mos e hedhim në luftë kundër armiqve të jashtëm dhe tradhtarëve të vendit.

Por edhe ai nxitonte, mori penën dhe e kopjoi shpejt e shpejt në një fletë që i dha Josifi.

Pastaj të dy shokët u përqaftuan dhe u ndanë.

Sotiri e kishte fshatin mjaft larg, por ai që mësuar me të ecur dhe e kishte bërë hesap që ndaj të rrgysur të arrinte në shtëpi. Dhe ecte sa ecte dhe prapë e nxirrte thirrjen e Partisë dhe e lexonte.

Kur hodhi lumin, dielli ishte ndaj të përnduar. Rrezet e tij të fundit e kishin skuqur qiellin përmbi Malin e Zi dhe një ngjyrë e kuqërremtë e bakërt shtrihej që nga Qefëzezi dhe gjer sipër mbi Lubonjë.

Sotiri ishte në qejf dhe ia mori një kënge, një këngë trimërishte, që bënte fjalë për komitë, të cilët me pushkë në krahë i dalin zot fukarasë.

Këndonte dhe shikonte malet e Gramozit e i dukej sikur ato po mbusheshin plot me partizanë.

Edhe pak i mbetej për të arritur në shtëpi dhe do t'i futej kopjimit të thirrjes për të shpërndarë nëpër fshatrat e tjera. Te çezma e Suvarit dalloi disa njerëz. Nuk e kuptoi menjëherë se cilët ishin, por, kur u shkoi afër, i njohu që të gjithë. Ishte Sefer beu me njerëzit e tij. Kishin ndenjur rreth e rrotull burimit me dyfeqet përmbi gjunjë dhe po pirin duhan.

Sotirit ia bëri tëk në zemër. Deshi të ikte po Sefer beu e ndaloi vetë.

— Dale, o Sotir, dale pak. Apo s'ë bën kabull të rrish me ne.

Sotiri qëndroi,

— Po nga vjen kështu? Si shumë i gëzuar je? Në kthehemi nga dasma, ti këndon. Si e ke hallin?

— Gjer në Ersekë isha! — ia ktheu shkurt Sotiri.

— Po kështu ergjele! Ç'deshe në Ersekë?

— Kisha ca punë! — iu përgjigj prapë shkurt Sotiri.

— Atje ta kam llafin dhe unë, çfarë pune mund të kishe në pazar pa kalë e pa gomar? — i tha Sefer beu.

Sotirit i ra ndër mend që një javë më parë i kishin thënë se do ta thërrisnin ushtar dhe shtoi:

— Më kishin thirrur në zyrën e rekurtimit për çështjen e ushtrisë.

— Po me ata shokët e tu a u takove andej? — e pyeti pastaj Sefer beu.

— Po unë kam shumë shokë, natyrisht që u takova me disa!

Atëherë Sefer beu i tha Muço Thekrës:

— Ja ngrehu, o Muço, dhe shiko se mës ka sjellë ndonjë fletushkë që ardej. Se këta për këtë venë poshtë e përpjetë dhe jo për gjësendi tjetër.

Sotiri u gjend ngushtë.

Muçoja filloi ta kontrollonte në fillim nga xhepat e xhaketës, pastaj në ata të pantallonave. Plaçkat që gjente i lëshonte përdhe. Shaminë e hundëve, një thikë të vogël, ca sheqerka që i kishte blerë për nënën, një kuti cigare për babanë...

Por siç e kishte zënë, do t'i vinte radha edhe thirrjes, të cilën Sotiri e kishte palosur dhe e kishte futur në portofol.

Atëherë ai përdori një dredhi. E nxori vetë portofolin nga xhepi i brendshëm i palltos dhe i tha Sefer beut:

— Po turp, o Sefer bej, u bëtë si hajdutë

të zakonshëm, po e shikoni që hiçgjë s'kam me vete, na tani dhe portofolin që të jeni të qetë.

Sefer beu u prek në sedër nga fjalët e tij dhe iu përgjigj.

— Dimë ne se ç'bëjmë, po ik qërohu që këtu dhe mos më dil më përpara!

— Sotiri mblodhi plaçkat e me hap të ngadaltë e me nofulla të kyçura bëri për nga fshati. Ishte i kënaqur që i kishte dhënë Sefer beut përsëri një mësim të mirë.

— Po kur kështu? — pyeti Vangjeli, i cili qe më i rrëmbyeri.

— Më tetë të këtij muaji! — u përgjigj Sotiri. — Kam sjellë dhe thirrjen e saj që i drejton gjithë popullit shqiptar. Dua t'jua lexoj, — vazhdoi ai.

Që të gjithë i mbërthyen sytë te Sotiri, i cili nxori nga xhepi i brendshëm i setrës portofolin dhe nga një e ndarë e tij thirrjen që kishte kopjuar.

— Popull shqiptar...

Dhe zëri herë i ngrihej, herë i ulej, sipas fjalëve që zinte në gojë.

Që të gjithë dëgjonin me vëmendje. Edhe Zikja, e cila kishte hyrë dhe donte të hapte dollapin për të marrë kutinë e kafesë, ndenji më këmbë dhe dëgjonte fjalët që thoshte i biri. Shumë prej tyre ajo nuk i merrte vesh fare, por, derisa i thoshte Sotiri, ato me siguri që do të ishin të mira.

Djemve u lëshonin sytë xixa. Pleqtë dëgjonin e kuptonin se qenë të drejta, kurse Dhosi i Maros vazhdonte herë pas here! «Hë, më ju lumtë goja, de! Hë, më ju lumtë goja, de!»

Kur mbaroi së lexuari tërë thirrja, në dhomë ra një heshtje e plotë. Të gjithë qenë të prekur thellë nga fjalët që kishin dëgjuar.

Të nesërmen Sotiri e kopjoi thirrjen dhe e nisi Llambin për në Qafëzez te Rakipi dhe te Xhemali në Helmës, kurse vetë u hodh në Bezhan.

Ecte e ndiente se si i këndonte zemra. Nga larot e Sefer beut e nga italianët s'kishte më frikë se mos e kontrollonin dhe i gjenin Thirrjen e PK të Shqipërisë. Fjalët e saj ai tani i dinte përmendsh. Ecte dhe, për çudi, sërish ndiente se një kohë e re, një ditë e re po lindte jo vetëm për të, një djalë nga fshati, por për të gjithë.

-10 16
6

Kacorri, Th.

Bijtë e shtrengatës, Roman. [Red. .
Dh. Xhuvani. Pikt. I. Çezma]. T., «Na-
im Frashëri», 1989
240 f.

(B. m) dhe

(B. v.); 891-983-31

K. 13

Tirāzhi 6000

Formati 49x78/16

Stazh 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë 1989